

DIALOGU I BRUKSELIT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË

ARRITJET DHE SFIDAT

DIALOGU I BRUKSELIT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË

ARRITJET DHE SFIDAT

Ky raport është mbështetur nga:



Norwegian Embassy

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analizat në këtë raport janë vetëm të Grupit për Ballkan dhe nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve

Autor: Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG)

LISTA E SHKURTESAVE

ADI	Agjencia Doganore e Italisë
ADR	<i>Accord européen relatif au transport international des marchandises Dangereuses par Route</i> (Marrëveshja Evropiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshëm)
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AKKVP	Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronave
AKS	Asociacioni i Komunave Serbe
ATA	<i>Admission Temporaire / Temporary Admission</i> , (Pranim i Përkohshëm. Njihet edhe si <i>Pasaporta e mallrave</i>)
AUE	Asociacioni i Universiteteve Evropiane (shih EUA)
AVUK	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të Republikës së Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimit
CRA	<i>Civil Registration Agency</i> (Agjencia e Regjistrimit Civil)
CPP	<i>Certificate of Pharmaceutical Product</i> (Çertifikata e produkteve farmaceutike)
DRC	<i>Danish Refugee Council</i> (Këshilli Danez për Refugjatë)
ECMI	<i>European Centre for Minority Issues</i> (Qendra evropiane për çështje të pakicave)
EEAS	<i>European External Actions Service</i> (Shërbimi Evropian për Veprime të Jashtme)
EMS	<i>Elektromreža Srbije</i> (Rrjeta elektronike e Serbisë)
ENIC	<i>European Network of Information Centres in the European Region</i> (Rrjeti Evropian i Qendrave të Informacionit në Rajonin Evropian)
ENTSO-E	<i>European Network of Transmission System Operators</i> (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemeve Përçuese)
EUA	<i>European University Association</i>
EULEX	<i>European Union Rule of Law Mission in Kosovo</i> (Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit)
EPS	<i>Elektroprivreda Srbije</i> (Elektroekonomia e Serbisë)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GI	Grup Implementues
GjND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
GP	Grup Punues
GTI	Grupi Trepalësh për Implementim
IBM	<i>Integrated Border Management</i> (Menaxhimi i Integruar i Kufirit)
ICO	<i>International Civilian Office</i> (Zyra Civile Ndërkombëtare)
INTERPOL	<i>International Criminal Police Organization</i> (Organizata Policore për krimin ndërkombëtar)
INTOSAI	<i>International Organization of Supreme Audit Institutions</i> (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit)
KB	Këshilli i Byrosë
KEE	Komiteti i Çertifikimit të Ekspertëve
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike

LVV	Lëvizja Vetëvendosje
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës
MC	Mbrojtja Civile
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit (shih IBM)
MLA	<i>Mutual legal assistance</i> (Ndihmë e ndërsjellë ligjore)
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit
MTS	<i>Mobilna telefonija Srbije</i> (Telefonia Mobile e Serbisë)
MUP	<i>Ministarstvo unutrašnjih poslova</i> (Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë)
NARIC	<i>National Academic Recognition Information Centre</i> (Qendra Informative Kombëtare Akademike për Nostrifikim)
NNJ	Ndihmë e Ndërsjellë Juridike
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PK	Posta e Kosovës
PSBE	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
RCC	<i>Regional Cooperation Council</i> (Këshilli për Bashkëpunim Rajonal)
SEED	<i>System for Exchange of Excise Data</i> (Sistemi për shkëmbimin e të dhënave për akcizat)
SEEIC	<i>South East Europe Investment Committee</i> (Komiteti Investues për Evropën Juglindore)
SEETO	<i>South East Europe Transport Observatory</i> (Observatori i Transportit për Evropën Juglindore)
SEETUF	<i>SEE Trade Union Forum</i> (Forumi i Sindikatave Tregtare të Evropës Juglindore)
SHSS	Shoqata e Siguruesve Serbë
SLS	<i>Samostalna liberalna stranka</i> (Partia e pavarur liberale)
TIR	<i>Transports Internationaux Routiers</i> (Transporti Ndërkombëtar i Rrugëve)
TPL	<i>Third party liability</i> (Autopërgjegjësia për Palët e Treta)
UCTE	<i>Union for the Co-ordination of Transmission of Electricity</i> , (Unioni për Koordinimin e Transmetimit të Energjisë Elektrike)
UMV	<i>University of North Mirovica</i> (Universiteti i Mitrovicës Veriore)
UNESCO	<i>United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization</i> , (Organizata arsimore, shkencore dhe kulturore e Kombeve të Bashkuara)
UNMIK	<i>United Nations Interim Administration Mission in Kosovo</i> , (Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë)
VEF	<i>Vienna Economic Forum</i> (Forumi Ekonomik i Vjenës)
WBIF	<i>Western Balkans Investment Framework</i> (Korniza e investimeve për Ballkanin Perëndimor)
ZDB	Zyra Doganore e Brendshme
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZN	Zyrtar Ndërlidhës
ZPKD	Zona e Pikë-kalimeve Kufitare Doganore; pikë-kalimet doganore në zonën e përbashkët të MIK
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Republikës së Kosovës.

TABELA E PËRMBAJTJES

<i>Dialogu i Brukselit në mes të Serbisë dhe Kosovës</i>	05
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	06
REKOMANDIME	08
HISTORIKU I DIALOGUT	09
HYRJE	11
KRONOLOGJIA E MARRËVESHJEVE	14
ROLI I DIALOGUT TË BRUKSELIT	16
ARRITJET KRYESORE	17
DIALOGU I BRUKSELIT, NË NUMRA	18
MARRËVESHJET E ZBATUARA	22
LIRIA E LËVIZJES	21
REGJISTRI CIVIL	24
VULA DOGANORE	25
PËRFAQËSIMI DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL	27
IBM – MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT	29
MBLEDHJA E TË HYRAVE DOGANORE	31
ZYRTARËT NDËRLIDHËS	33
ZGJEDHJET LOKALE / FUNKSIONALIZIMI I KOMUNAVE NË VERI	36
TELEKOMUNIKACIONI	39
INTEGRIMI I POLICISË	42
DREJTËSIA	46
SHUARJA DHE INTEGRIMI I “MBROJTJES CIVILE”	50
NJOHJA RECIPROKE E POLISAVE TË SIGURIMIT	53
NJOHJA RECIPROKE E CERTIFIKATAVE ADR	55
MARRËVESHJET E PAZBATUARA	57
NJOHJA RECIPROKE E DIPLOMAVE UNIVERSITARE	58
SHËNIMET KADASTRALE	60
ENERGJIA	62
ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE	65
REVITALIZIMI DHE HAPJA PËR LËVIZJE E URËS NË MITROVICË	68
MIRATIMI I MARRËVESHJEVE	70
SFIDAT DHE MUNDËSITË	75
SHTOJCAT	76

**DIALOGU I
BRUKSELIT
NË MES TË
KOSOVËS DHE
SERBISË**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në mars 2011, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian (BE-së), filloi procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, i cili për katër vite rezultoi me 38 marrëveshje. Sidoqoftë, ky numër i marrëveshjeve është po aq i diskutueshëm sa edhe shumë çështje rreth këtij procesi, mbi të cilat ky raport synon të hedhë dritë. Dialogu filloi me tema që u konsideruan si më të lehta për t'u trajtuar, siç ishin liria e lëvizjes dhe regjistrat civil të Kosovës. Kjo ishte e domosdoshme për të vendosur themelet e një procesi të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, por në një farë forme edhe në mes të këtyre dy vendeve me BE-në dhe anasjelltas. Këto tema u cilësuan më shumë si teknike e pikërisht kjo bëri që procesi i filluar të kualifikohej si 'dialog teknik'.

Dialogu synoi përmirësimin e marrëdhënieve dhe zgjidhjen e problemeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, përmes arritjes së marrëveshjeve në fusha të ndryshme. Qenësore ishte inicimi i një komunikimi të vazhdueshëm në mes të dy qeverive. Takimet, ndonëse kishin shumë mangësi, rezultuan me marrëveshje konkrete, një pjesë e të cilave janë implementuar kënaqshëm. Megjithatë, procesit i mungoi transparenca dhe llogaridhënia. Rezultatet e arritura nuk u promovuan sa do të duhej të promovoheshin ndërsa të njëjtat u përdorën për

beteja politike të brendshme dhe kundër njëri tjetrit, ndërkaq në raste të dështimit apo mos-implementimit të marrëveshjeve të caktuara, mungoi llogaridhënia. Pritshmëritë për të dyja palët e dialogut ishin të mëdha, të menjëhershme dhe kundërthënëse.

Në vitin 2012 filloi edhe dialogu politik, që kulmoi me Marrëveshjen e Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, marrëveshje kjo e arritur më 19 prill, 2013. Këtë marrëveshje e ratifikoi Kuvendi i Kosovës pak javë më vonë si marrëveshje ndërkombëtare e cila krijoi epërsi ndaj ligjeve të të vendit. Me fillimin e dialogut politik, ndasitë politike brenda Kosovës u bënë edhe më të mëdha, tensionet me Serbinë u rritën dhe në faza të ndryshme pati edhe plasaritje në raportet me partnerët ndërkombëtarë. Disa nga pikat e kësaj marrëveshje vazhdojnë të mos implementohen. Pika më kontraverse e kësaj marrëveshje është themelimi i Asociacionit/Bashkësisë së Komunave Serbe i cili rezultoi me protesta masive të udhëhequra nga opozita kosovare. Në atë kohe, Gjykata Kushtetuese vendosi që parimet e akorduara ishin në kundërshtim me frymën e Kushtetutës dhe Qeveria e Kosovës ngurron ta zbatojë atë derisa Serbia të paraqesë plane të qarta për tërheqjen e institucioneve paralele që ajo i financon në Kosovë.



Në vitin 2015, u finalizua marrëveshja për krijimin e gjyqësorit të unifikuar për tërë Kosovën duke përfshirë integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga komuniteti serb. Kjo marrëveshje përfshinte një plan për realizimin e saj, i cili është implementuar sukseshëm. Gjatë atij viti u nënshkrua edhe marrëveshja për shpërbërjen e Mbrojtjes Civile e cila për një kohë të gjatë nga Prishtina shihej si kërcënim ndaj sigurisë, por që nga serbët e veriut të Kosovës shihej si mekanizëm punëdhënës dhe mbrojtës. Institucionet e ndryshme kosovare nuk iu kanë ndarë detyra të caktuara për të integruarit dhe ekzistojnë ende shumë persona të cilët nuk lajmërohen rregullisht në punë, gjë që shfaq pengesa në implementimin e plotë të kësaj marrëveshje.

Çështjet të tjera si marrëveshja për energjinë, njohja reciproke e diplomave dhe regjistrat kadastral mbetën mbrapa afateve të planifikuara për zbatim. Që nga arritja e marrëveshjes për energji e cila u nënshkrua në vitin 2013, Serbia ka hezitur që kompaninë energjetike e cila operon në veri t'a regjistroj në Kosovë sipas ligjeve të saj. Zbatimi i marrëveshjes për njohjen reciproke të diplomave e nënshkruar në vitin 2011, ka hasur në shumë pengesa. Kjo ndodhë për arsye se Serbia vazhdon t'a ngadalësoj procesin e nostrifikimit të diplomave të Kosovës ndërsa Kosova e trajton "Universitetin e Prishtinës në Mitrovicë" si institucion të paligjshëm i cili operon në kuadër të sistemit arsimor të Serbisë. Në të njëjtin vit u nënshkrua edhe marrëveshja për kthimin e të gjitha dokumenteve kadastrale para vitit 1999. Të gjitha të dhënat kadastrale u parapanë të skanohen me qëllim që ato të dorëzohen në Kosovë përmes Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (EUSR). Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronave (AKKVP) u krijua së fundmi që të shërbej si një agjenci teknike për krahasimin e dokumenteve të skanuara mirëpo e njëjta ende nuk e ka filluar punën. Poashtu, Gjykata Kushtetuese e Serbisë vendosi se kjo marrëveshje binte ndesh me Kushtetutën e saj.

Fillimi i dialogut për një marrëveshje përfundimtare në vitin 2017 solli edhe më shumë huti dhe tensione. Ky lajm krijoi një përshtypje të përgjithshme se dialogu i mëhershëm kishte dështuar dhe se zgjidhja e vetme ishte një marrëveshje gjithëpërfshirëse. Në kërkim të finales së madhe u hapën edhe opsione të tjera të cilat binin ndesh me dialogun e mëhershëm. Me këtë proces, tensionet në mes të dy palëve dhe ato brenda Kosovës u rritën edhe më shumë. Serbia ashpërsoi fushatën kundër Kosovës dhe kjo e fundit hezitoi të implementoj marrëveshjen e mëhershme lidhur me

Asociacionin e Komunave Serbe, sidomos duke parë se Serbia në vazhdimësi po pengonte anëtarësimin e Kosovës në organizatat relevante ndërkombëtare dhe po lobonte për "ç'njohje" të pavarësisë së saj.

Marrëveshjet të cilat janë implementuar kënaqshëm dhe kanë pasur efekte pozitive në jetën e qytetarëve janë marrëveshja për regjistrat civil, vulat doganore, telekomunikacioni, menaxhimin e integruar të kufirit (IBM-it), integrimi i policisë, gjykatësve, prokurorëve si dhe themelimi i katër komunave në veri të Kosovës. Marrëveshjet e suksesshme dëshmojnë se dialogu në mes të dy vendeve është i mundur, se rezultate mund të arrihen dhe se normalizimi mund të ndodhë në dobi të qytetarëve dhe mbi të gjitha, këto marrëveshje ndihmojnë konsolidimin e shtetësisë së Kosovës. Arritja e Kosovës të marrë kodin e saj shtetëror telefonik ua mundëson qytetarëve të saj ta përdorin vetëm një kod në thirrjet e brendshme dhe ndërkombëtare. Implementimi i marrëveshjes për vulat doganore së bashku me atë për lëvizjen e lirë e kanë lehtësuar qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në mes dy vendeve si dhe në mes të Kosovës dhe shteteve të BE-së.

Fatkeqësisht, transparenca dhe informimi i drejtë i qytetarëve vazhdon të mbetet çështje shqetësuese e cila e ka dëmtuar rëndë këtë proces. Palët pothuajse gjithmonë kishin narrativat dhe interpretimet e tyre diametralisht të kundërta mbi marrëveshjet e arritura. Si rezultat, qytetarët e të dy vendeve mbeten skeptik ndaj procesit të dialogut. Që nga viti 2018, procesi i dialogut ishte pezulluar ndërkaq BE-ja vazhdon të nxis të dy palët për vazhdim të dialogut dhe implementim të marrëveshjeve, si një ndër kërkesat kryesore në rrugën e tyre drejt integritimit në BE. Është më e rëndësishme të krijohet një mënyrë e re e komunikimit në lidhje me dialogun edhe atë që do të vijë për një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila do të rriste sado pak besimin e qytetarëve ndaj këtij procesi.

Ky raport përshkruan në detaje procesin e dialogut, marrëveshjet e arritura, zbatueshmërinë apo moszbatueshmërinë e tyre, si edhe efektin e këtyre marrëveshjeve. Raporti i trajton marrëveshjet teknike dhe ato politike si pjesë të një procesi të vetëm të lehtësuar nga BE-ja. Qeveria dhe institucionet nuk posedojnë informata rreth procesit të dialogut në tërësi dhe përmbajtja e këtij raporti do të shërbejë për të krijuar një sistem më të mirë të memories institucionale në qeveri. Këto të dhëna janë po aq të rëndësishme edhe për fazën e re të dialogut me Serbinë.

REKOMANDIME

Çdo shpjegim për secilën marrëveshje ofron informata të mjaftueshme lidhur me atë se çka duhet bërë për të siguruar impementimin e plotë të tyre. Megjithatë, apriori, qeveria, Zyra e Kryeministrit dhe institucionet relevante duhet të ndërnarrin disa hapa shumë të rëndësishëm sic janë:

1 Të krijohet një *Zyrë e veçantë* në kuadër të Zyrës së Kryeministrit e cila duhet të trajtoj të gjitha informatat rreth procesit të dialogut. Kjo zyrë duhet të krijojë një të ashtuquajtur memorie institucionale dhe të shërbejë si mekanizëm dhe autoritet shtytës për koordinim të veprimeve dhe implementim;

2 Të përmirësohet informimi i qytetarëve mbi dialogun teknik Beograd-Prishtinë dhe procesin në vijim, përfitimet që rrjedhin prej tij, duke ofruar informata të sakta për çdo hap të dialogut, përfshirë këtu agjendat, temat, pjesëmarrjen (përkatësinë gjnore), shpenzimet etj.;

3 Institucionet apo agjencitë relevante duhet t'i japin prioritet implementimit të marrëveshjeve, sidomos atyre që kanë të bëjnë me fuqizimin e institucioneve në veri dhe rritjen e shërbimeve të institucioneve të Kosovës për qytetarët;

4 Të përdoren marrëveshjet për avancimin e pozicionit të Kosovës me qëllim të sigurimit të anëtarësimit të mëtejshëm në organizatat dhe iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare;

5 Në kuadër të dialogut të tanishëm me Serbinë, të insistohet në krijimin e një mekanizmi të fuqishëm dhe të pa kontestuar për monitorim të implementimit të marrëveshjeve dhe për llogaridhënie;

6 Të ngritet përfshirja e grave në procesin e dialogut, proceset e tjera të implementimit të marrëveshjeve, konsultimit dhe vendimarrjes;

7 Grupet punuese dhe ato implementuese të konsolidohen me ekspertë të fushës.

HISTORIKU I DIALOGUT



Që nga viti 1999, marrëdhëniet në mes Kosovës dhe Serbisë kanë qenë vazhdimisht të tensionuara. Prezenca e fuqishme ndërkombëtare dhe procesi i dialogut për statusin final të Kosovës kishin arritur t'i qetësojnë ato sa do pak. Para këtij dialogu, Kosova dhe Serbia nuk kishin bashkëpunim në mes vete. Qarkullimi i njerëzve dhe mallrave ishte shumë i mangët dhe i vështirë. Në pjesën veriore të Kosovës funksiononin vetëm institucionet paralele të shtetit të Serbisë, përmes administratës së saj komunale, prezencës policore, paramilitare, si dhe institucioneve të drejtësisë, arsimit e shëndetësisë.¹ Edhe targarat e veturave, mbishkrimet publike, valutat, taksat, faturimi i energjisë, e të gjitha rregullimet tjera ishin sipas sistemit të Serbisë.² Institucionet e Kosovës nuk kishin qasje në atë pjesë, aq më pak mundësi për shtrirje të sovranitetit. Ato i shihnin serbët e Kosovës të instrumentalizuar skajshëm për nevoja të politikës ditore në Beograd, dhe nuk bënin përpjekje për integrimin e tyre në jetën demokratike të Kosovës.

Marrëdhëniet u keqësuan sidomos në vitin 2008, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kur Serbia doli me qëndrimin se nuk e njej pavarësiëdhe institucionet e saj. Serbia kishte qenë pjesë e negociatave të Vjenës për statusin final të Kosovës por në fund refuzoi t'a

pranoj planin e Ahtisaarit. Beogradi insistonte se njej vetëm autoritetin e UNMIK-ut në Kosovë.³ Në planin ndërkombëtar, Kosova angazhohej për njohje globale të shtetësisë së saj, derisa Qeveria e Serbisë zhvillonte fushata kundërshtuese. Edhe pas pavarësisë, Kosova përfaqësohej vetëm në tri organizata rajonale, dhe atë si "UNMIK/Kosovo", meqë kjo administratë ishte nënshkruese në emër të Kosovës dhe përfaqësuese e saj, qysh para shpalljes së pavarësisë.⁴ Gjashtë muaj pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008, Serbia kërkoi mendim këshillëdhënës pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, nëse ky veprim ishte në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Sipas mendimit këshillues të Gjykatës, shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare, përfshirë këtu Rezolutën 1244, pra as kornizën kushtetuese të UNMIK-ut.⁵ Qeveria e Kosovës, përkrahur nga një subjekt politik që përfaqësonte serbët e Kosovës, *Samostalna Liberalna Stranka (SLS)*, arriti t'a zbatojë Planin e Ahtisaarit, duke themeluar komuna të reja me shumicë serbe në pjesët tjera të Kosovës, por jo edhe në veri.⁶ Atje, vetëm dy ditë pas shpalljes së pavarësisë, një grup i mirë-organizuar, përfshirë edhe personelin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP) të pajisur me armë dhe eksplozivë plastik, u transportuan me autobusë e automjete tjera për të sulmuar

¹ Grupit Ndërkombëtar i Krizave, *Serbia dhe Kosova: Rruga drejt Normalizimit*, 19 shkurt 2013 në <https://www.crisisgroup.org/sq/europe-central-asia/balkans/serbia/serbia-and-kosovo-path-normalisation>

² Ibid.

³ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, *Kosova dhe Serbia pas mendimit të GJND-së*, 26 gusht 2010, fq. 21.

⁴ "Qeveria e Kosovës ka pranuar një kompromis ku thuhet se Kosova është një zonë e veçantë e tregtisë dhe është pajtuar me hyrjen e Kosovës në CEFTA si "UNMIK-Kosovo" Ibid., fq. 21.

⁵ Ibid.

⁶ Ibid. Në nëntor të vitit 2009, serbët dolën në zgjedhje lokale dhe u formuan katër komuna të reja me shumicë serbe (Ranillugu, Parteshi, Kllokoti, Graçanica), njëra është zgjeruar (Novobërda) ndërsa njëra ka zgjedhur përfaqësuesit legjitimë (Shtërpca). SLS (*Samostalna Liberalna Stranka*), Partia e Pavarur Liberale, e formuar më 27 janar 2006, në Graçanicë, udhëhequr nga Slobodan Petroviq, fq. 17.



pikat doganore të Bërnjakut dhe Jarinjës në veri të Kosovës. Edhe Kryetari i Komunës së Zubin Potokut dhe Nënkrjetari i asaj të Leposaviqit i shoqëruan sulmuesit.⁷ Punonjësit serbë në institucionet e Kosovës u udhëzuan të japin dorëheqje.⁸

UNMIK-u, misioni i OKB-së i vendosur pas përfundimit të luftës si administrues i Kosovës sipas Rezolutës 1244, nuk arriti të krijoj infrastrukturën administrative në të gjithë territorin e Kosovës, duke lejuar kështu vazhdimin apo rivendosjen e strukturave paralele të Serbisë në disa pjesë të Kosovës, në veçanti në komunat veriore përtej lumit Ibër.⁹ Përkundër prezencës së EULEX-it, e më vonë edhe të Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO), shtrirja e institucioneve të Serbisë në veri të Kosovës u zgjerua, dhe ndarja përgjatë lumit Ibër po thellohej gjithnjë e më shumë.¹⁰ Përtej lumit nuk kishte rend e ligj dhe dhjetëra eksplozime bombash e sulme me armë ndodhnin brenda muajit.¹¹ Sulmoheshin shqipëtarët e serbët që shprehnin gatishmëri të punonin me Prishtinën, por edhe ndërkombëtarët.¹²

Në vitin 2011, kontrolli i Beogradit mbi pjesën veriore të Kosovës arriti kulmin. Prandaj, fillimi i një procesi të

dialogut që do të fokusohet në gjetjen e zgjidhjeve për çështjet që i rëndonin marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe parandalimi i një konflikti edhe më të madh në veri ishte i domosdoshëm.¹³ Me kërkesë të BE-së, më 9 shtator 2010, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një rezolutë përmes së cilës pranoi mendimin këshillues të GjND-së dhe mirëpriti gatishmërinë e BE-së për të lehtësuar dialogun midis dy vendeve, Kosovës dhe Serbisë. Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian me mandat të Kombeve të Bashkuara, zyrtarisht filloi më 8 mars, 2011. Dy ditë më vonë, Kuvendi i Kosovës miratoi rezolutën që i jepte mandat Qeverisë së Kosovës të marrë pjesë në dialogun teknik në Bruksel.¹⁴ Kjo bëri që këto dy shtete për herë të parë të mbajnë takime të nivelit të lartë. Procesi u fokusua në gjetjen e zgjidhjeve funksionale dhe të pranueshme apo siç ishte deklaruar ish-ndërmjetësuesja e BE-së, Catherine Ashton “*palëve nuk u kërkohej të kalonin linjat e tyre të kuqe*” dhe se “*qëllimi ishte të përpiqeshim të paktën të afrojmë përfaqësuesit e të dy palëve në të njëjtën dhomë, në të njëjtën tryezë*”.¹⁵ Qeveria e Kosovës e vlerësoi dialogun si një faktor të paqes, si dhe nxitës të bashkëpunimit dhe përparimit drejt Bashkimit Evropian për të dyja vendet.¹⁶

⁷ Grupit Ndërkombëtar i Krizave, *Kosovo's First Month*, [“Muaji i Parë i Kosovës”], 8 mars 2008, fq. 8.

⁸ Në veri, serbët nuk e lëshuan shërbimin, por e ndërprejnë komunikimin me zinxhirin komandues. 300 serbë të Policisë së Kosovës refuzuan të jenë nën hierarkinë komanduese të Policisë së Kosovës. Ata kërkuar të mos jenë më nën komandën e Policisë së Kosovës, por të Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë. Për këtë arsye ata u suspenduan nga puna, ndërsa pagat i merrnin edhe më tutje. Brenda Policisë Kufitare u kthyen 48 nga 50 zyrtarë të suspenduar të Policisë. Edhe në Mitrovicë u kthye një polic i suspenduar në shërbim të Policisë së Kosovës. Shih Raportin e Grupit Ndërkombëtar të Krizave, *Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavarur*, fq. 6, 19 maj 2010, dhe studimin shkencor nga Enver Sopjani dhe Naser Sopjani, *Roli i enklavave dhe strukturave ilegale serbe në Kosovë*, gusht 2012, fq. 20.

⁹ Rezoluta 1244 (1999). Në veri të Ibrit sfidimi serb ishte rritur edhe më shumë duke qenë se gjykatat dhe postet kufitare dhe të doganave të Kosovës nuk funksionojnë, gjersa serbët e Kosovës vazhdojnë të refuzojnë bashkëpunimin me institucionet e Kosovës apo BE-në. Raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave, *Tranzicioni i brishtë në Kosovë*, 25 shtator 2008, fq. i.

¹⁰ Raport nga GLPS dhe DPC, *EULEX-towards an integrated exit strategy - Strengthening the rule of law through EU-integration*, [“EULEX-i drejt një strategjie të integruar të daljes – Përforsimi i sundimit të ligjit përmes integrimit në BE”], prill 2014.

¹¹ Grupit Ndërkombëtar i Krizave, *Kosova dhe Serbia pas mendimit të GjND-së*, 26 gusht 2010

¹² Disa sulme ndaj serbëve që bashkëpunonin me Prishtinën dhe vrasja e doganierit të EULEX-it. Shih “EU police officer killed in Kosovo” [“Polic i BE-së u vra në Kosovë”], BBC News, 19 shtator 2013, në <https://www.bbc.com/news/world-europe-24158153>

¹³ Grupit Ndërkombëtar i Krizave, *Kosova dhe Serbia pas mendimit të GjND-së*, 26 gusht 2010

¹⁴ Shih Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Nr. 04-R-001. Prishtinë, 10 mars, 2011.

¹⁵ Fjalim i Catherine Ashton në panelin “Zgjidhje të qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor” në hapjes së Forumit të Sigurisë në Beograd, 17 tetor 2019, i qasshëm në <https://www.youtube.com/watch?v=c0cOXK57i80>

¹⁶ Shih “Strategji për Arritjen e Njohjes së Plotë Ndërkombëtare të Republikës së Kosovës”, qershor 2011, në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Arritjen_e_Njohjes_se_Plote_Nderkombetare_te_Republikes_se_Kosoves_SHQ.pdf

HYRJE

Në korrik të vitit 2011, dialogu filloi me diskutimin e regjistrave civilë dhe kadastralë të Kosovës, të cilët ndodheshin në Serbi dhe si të tilla pamundësonin qasjen e qytetarëve të Kosovës në këto dokumente, uke krijuar probleme të shumta. UNMIK-u kishte përpiluar një regjistër, por me mungesa të theksuara sepse nuk kishte qasje në dokumentat arkivore.¹⁷ Edhe më problematike ishte mungesa e dosjeve origjinale kadastrale që dëshmonin titullarët e saktë të pronave të shumta, sidomos të atyre shoqërore, për të cilat dyshimet se janë tjetërsuar pas luftës janë të mëdha.¹⁸ Shumë tema të tjera pasuan e shumë marrëveshje u arritën, të cilat edhe u shfrytëzuan për të vendosur parimet dhe kornizat e negociatave të ardhshme. U arrit edhe marrëveshja për lirinë e lëvizjes së qytetarëve mes dy vendeve me anë të kartave të identitetit, në vend të pasaportave.¹⁹ Po atëherë u nënshkruan edhe marrëveshjet si ajo për njohjen e diplomave universitare, për të hyrat doganore, për menaxhimin e integruar të kufirit (IBM-it) si dhe marrëveshja për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal.²⁰

Më 19 prill, 2013 u nënshkrua *Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve* ndërmjet dy grupeve të dialogut. Qëllimi kryesor ishte shpërbërja e sistemit paralel serb në Kosovë, integrimi i pjesëtarëve dhe punonjësve të tyre në institucionet e Kosovës dhe ofrimi i një niveli të vet-administrimit për serbët dhe komunat ku shumica e tyre jetojnë. Në vitin 2015, u arrit një marrëveshje për katër çështje që po e bllokoni procesin për një kohë të gjatë siç janë:

Asociacioni/Bashkësia e Komunave me shumicë serbe, telekomunikacioni, energjia, dhe liria e lëvizjes mbi Urën e Mitrovicës.²¹

Varësisht zbatueshmërisë së tyre, këto marrëveshje ndikuan në kornizën ligjore, meqë implementimi i tyre në shumicën e rasteve kërkonte ndryshime të caktuara ligjore. Kosova e miratoi Ligjin për Ratifikimin e *Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë*.²² Serbia e praktikoi miratimin e marrëveshjeve të Brukselit përmes dekreteve qeveritare, për t'u zbatuar nga institucionet e ndryshme shtetërore.²³ Përpos zgjidhjes së problemeve të brendshme, dhe atyre me Serbinë, përmes këtij procesi të Dialogut – përkatësisht si rezultat i marrëveshjes për bashkëpunim dhe përfaqësim rajonal – Kosova arriti të bëhet edhe anëtare e një sërë organizatash të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare.²⁴ Por, Kosova nuk arriti të anëtarësohet në UNESCO, NATO, Interpol e as në OSBE, si dhe asnjëherë nuk aplikoi për praninë në Këshill të Evropës apo në OKB.²⁵

Procesi nuk ishte fare transparent dhe dështoi të marrë përkrahjen e publikut si në Kosovë ashtu edhe në Serbi. Të dy palët e arsyetuan këtë me ndjeshmërinë e procesit dhe me kujdesin e domosdoshëm politik ndaj tij, por të tjerët e kritikuan ashpër këtë qasje, duke argumentuar se një qasje e tillë krijon hapësirë edhe për dyshime dhe kundërshti të panevojshme.²⁶ Procesi vazhdoi të jetë gjithnjë e më i mbyllur, dhe të dy qeveritë në masë të madhe dështuan të sigurojnë pronësi publike mbi procesin dhe marrëveshjet,

¹⁷ Madje, me letërnjoftime të UNMIK dhe përmes dy dëshmitarëve, mund të pajisesh me dokumentin e shtetësisë, edhe nëse nuk arrije të provoje me asnjë dokument shtetësinë paraprake. Prandaj ky regjistër i trashëguar nga UNMIK-u nuk është se ishte shumë i besueshëm, e krijimi i një regjistri të plotë dhe të saktë ishte edhe kërkesë e BE-së për Kosovën, në procesin e saj të liberalizimit të vizave.

¹⁸ Grupi Ndërkombëtar i Kriazve, *Setting Kosovo Free: Remaining challenges* ["Kosova pa mbikëqyrje: sfidat e mbetura"], 10 shtator 2012, fq. 20, në <https://d2071andvip0wj.cloudfront.net/218-setting-kosovo-free-remaining-challenges.pdf>

¹⁹ Shih Konkluzat mbi Lirinë e Lëvizjes dhe Licencime Doganore, 16 shtator 2014

²⁰ Grupit për Ballkan, *Integrimi i Serbëve në Kosovë pas Marrëveshjes së Brukselit*, 15 mars 2015.

²¹ Shih "Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve", 19 prill 2013

²² Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8892>

²³ Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Serbisë, "The Government accepts Brussels agreement" ["Qeveria pranon marrëveshjen e Brukselit", 22 prill 2013], në <http://www.mfa.gov.rs/en/component/content/article/11929-the-government-accepts-brussels-agreement>

²⁴ Për listën e plotë të organizatave rajonale dhe ndërkombëtare në të cilat Kosova është anëtarësuar shih Shtojcën 2 të këtij raporti.

²⁵ Kosova aplikoi për anëtarësim në UNESCO në 2015 dhe INTERPOL 2018, duke dështuar të merrte votat e nevojshme në të dy rastet. Duke marrë parasysh dështimin e Kosovës për t'u bërë anëtar në INTERPOL në 39 2018 MPJ dhe Qeveria vendosën të mos riaplikojnë, përpos nëse kishin garancion se kishin votat e nevojshme. Edhe pse anëtarësimi në Këshillin e Evropës ishte pjesë e Programit të Qeverisë, Kosova vendosi të mos aplikonte në vitin 2019. Shih raportin nga PIPS, *Vjetari i Politikës së Jashtme Kosovare*, shkurt 2020, fq. 34.

²⁶ Intervistë e Grupit për Ballkan me zyrtarë të Qeverisë së Kosovës, Prishtinë, shkurt 2020



shpesh duke e akuzuar njëra-tjetrën, por edhe BE-në, si dhe duke mos i promovuar në mënyrë të duhur rezultatet konkrete e të dobishme që ky proces po sillte për qytetarët.²⁷

Procesi i dialogut u përcoll edhe me veprime të palëve kundër njëra-tjetrës. Si rezultat i shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Serbia nuk i pranoi vulat doganore të Kosovës duke bllokuar eksportet e Kosovës në Serbi dhe duke penguar tranzitin e mallrave të Kosovës për eksport në BE.²⁸ Qysh në vitin e parë të dialogut, në korrik të vitit 2011, Qeveria e Kosovës zbatoi një masë reciprociteti ndaj Serbisë, e cila bllokoi importet nga Serbia e Bosnja dhe Hercegovina por vendimi u zbatua vetëm për 50 ditë, dhe më pas u shfuqizua.²⁹ Në të njëjtin muaj që palët nënshkruan marrëveshjen për lëvizjen e lirë, policia e Kosovës u përpoq të merrte nën kontroll dy pikat kufitare (Bërnjak dhe Jarinjë). Serbët në Kosovë u përgjigjën duke vendosur dhjetëra barrikada në rrugë, duke e detyruar edhe KFOR-in të ndërhyjë për të stabilizuar situatën. Zbatimi në praktikë i këtyre marrëveshjeve edhe më tutje po hasë në vështirësi, ndërsa vet procesit i është ngadalësuar ritmi që nga viti 2015, kur marrëveshja për krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe u kontestua masivisht nga partitë

opozitare në Kosovë dhe disa organizata jo qeveritare në Prishtinë. Gjatë viteve Serbia ka ndërmarrë veprime të tjera ndaj Kosovës në formë të barrierave jo-tarifore duke rritur kostot e kalimit të kufirit serb në aspektin financiar dhe kohës së humbur.³⁰ Në të njëjtën kohë, Kosova ka vendosur tarifa shtesë ndaj disa produkteve dhe industrive serbe.³¹

Dialogu u pezullua për një kohë kur në janar të vitit 2017, ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, u arrestua në Francë në bazë të një fletë-arresti të lëshuar nga Serbia.³² Kuvendi i Kosovës aprovoi një rezolutë që e pezullonte dialogun deri në lirimin e tij.³³ Pas lirimimit të z. Haradinaj në prill të atij viti, takimet në kuadër të procesit të dialogut vazhduan.³⁴ Nga nëntori i vitit 2018, procesi i dialogut u pezullua përsëri, pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për vendosjen e tarifës doganore prej 100% ndaj mallrave të importuara nga Serbia e Bosnja dhe Hercegovina si kundërpergjigje ndaj fushatës së Serbisë për tërheqjen e njohjeve të pavarësisë së Kosovës dhe kundër antarësimit të saj në Interpol.³⁵ Pas zgjedhjeve të 6 tetorit, 2019, vazhdimi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë përsëri mori fokusin. Kancelarja gjermane Merkel bashkë me presidentin francez Macron, insistojnë

²⁷ Radio Evropa e Lirë, "Kosova dhe Serbia me akuzat të ndërsjella për moszbatim të marrëveshjeve", 18 nëntor 2018, në <https://www.evropa-elire.org/a/kosova-serbia-me-akuzat-per-moszbatim-te-marreveshjeve/29607079.html>

Komisioni Evropian, *Serbia 2019 Report* ["Raportin për Serbinë 2019"] Bruksel, 29 maj 2019, fq. 13 dhe 30, në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-serbia-report.pdf>

²⁸ Komisioni Evropian, *Serbia 2010 Progress Report* ["Raporti i Progresit Serbia 2010"] Bruksel, 9 nëntor 2010, fq. 19 në http://europa.rs/upload/documents/key_documents/2010/Rapport%20SR%20TO%20PRESS%20CONF%2008.11.pdf

²⁹ Koha, "Dialog dhe reciprocitet me rezoluta", 10 shkurt 2020, në <https://www.koha.net/arberi/207887/dialog-dhe-reciprocitet-me-rezoluta/>

³⁰ "Dokumenti mbi Politikat #1 NTB-të në kontekst të CEFTA-së: Rasti i Serbisë kundër Kosovës, maj 2015, fq. 8, në <https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/B30D19DE-F849-4DEC-A966-27E24100B8D9.pdf>

³¹ Vendim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për importin e miellit nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës Prishtinë, 19 tetor 2017 në <https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/79E03DDF-CB54-4B11-85F9-F2009590B94A.pdf>

³² Shih "Arrestohet Ramush Haradinaj", Zëri, 4 janar 2017, në <https://zeri.info/aktuale/124456/arrestohet-ramush-haradinaj/>

³³ Rezolutë lidhur me ndalimin e ish-kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, në Francë, 9 mars 2017, në http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/2017_03_09_Rezoluta_nr_011_per_lirim_in_e_Ramush_Haradinaj.pdf

³⁴ Shih "Lirohet Ramush Haradinaj", kallxo.com 27 prill 2017, në <https://kallxo.com/shkurt/lirohet-ramush-haradinaj-2/>

³⁵ Kosovo 2.0, "Anëtarësimi i Kosovës në Interpol, larg për t'u siguruar", 18 gusht 2017, në <https://kosovotwopointzero.com/kosovos-interpol-membership-far-assured/>

për një rol më të madh të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.³⁶ Marrëveshjet e fundit, të arritura me ndërmjetësim të të dërguarit të SHBA-së, Richard Grenell, ajo për linjën ajorore Prishtinë – Beograd dhe për lidhjen hekurudhore mes Kosovës e Serbisë, tema këto të cilat ishin në diskutim edhe përbrenda dialogut të Brukselit, i dhanë energji të re procesit.³⁷

Së fundmi, Kosova ka demonstruar një lloj miratimi të nënkuptuar me marrëveshjet e arritura, duke zgjatur afatin për zëvendësimin e lejeve të vozitjes të lëshuara nga institucionet e Republikës së Serbisë, deri më 15 shtator, 2020.³⁸ Poashtu, më 20 mars, 2020, Qeveria e Kosovës mori vendim për heqjen e taksës 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës, fillimisht në lëndën e parë, e nga 1 prilli 2020, edhe në mallrat tjera, duke vendosur masa graduale reciproke –vetëm në raport me Serbinë.³⁹ Këto hapa shënuan rifillimin e mundshëm të dialogut. Me rënien e qeverisë së Albin Kurtit, një qeveri e re e koalicionit, LDK, AAK, NISMA dhe komunitetet, e udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti u votua më 3 qershor 2020. Hoti ka paraqitur disa parime për dialogun dhe ka premtuar një grup të ekspertëve dhe kordinator për dialogun.⁴⁰ Me 27 qershor, 2020, ishte planifikuar të zhvillohen bisedime midis Prishtinës dhe Beogradit në SHBA vetëm për t'u anuluar pas njoftimit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë se synon të paraqesë akuzë ndaj Presidentit të Kosovës Hashim Thaçi për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.⁴¹ Me nismën e presidentit francez Macron dhe kancelares gjermane Merkel, më 10 korrik, u zhvillua një video konferencë mes kryeministrit të Kosovës dhe atij të Serbisë, ku temë kryesore ishte dialogu Kosovë-Serbi. Dialogu rifilloi me 12 korrik, 2020, me pjesëmarrjen e Përfaqësuesit Special të BE-së për Dialogun Beograd-Prishtinë, emëruar së fundi, Miroslav Lajčák. Kurse më 16 korrik, në Bruksel, për herë të parë pas më shumë se

20 muajsh u mbajt takimi i parë i drejtëpërdrejtë i përfaqësuesëve të Kosovës dhe Serbisë në kuadër të dialogut të Brukselit. Bisedimet u fokusuan në çështjen e personave të pagjetur dhe të zhvendosur si dhe zhvillimin ekonomik.⁴² Dialogu i ri-filluar në korrik 2020, mes dy qeverive, po promovohet si proces për një marrëveshje gjithëpërfshirëse mes Kosovës e Serbisë. Megjithatë, elemente nga marrëveshjet e kaluara domosdo do të përbëjnë një pjesë të marrëveshjeve të cilat potencialisht do të arrihen në Bruksel apo SHBA.

Dialogu mbetet një proces sa i ndjeshëm, aq edhe fluid, sa i përket gjetjes së formulave më të mira të bashkëpunimit. Edhe pse përmes tij u synua normalizimi i marrëdhënieve, kundërshtimet dhe pengesat që e përcollën ishin të mëdha. Këto kundërshtime janë kryesisht rezultat i interpretimeve kundërthënëse që iu bëheshin marrëveshjeve, por edhe nga polarizimi përbrenda klasës politike, sidomos në Kosovë. Pajtimi mes dy shteteve për një çështje të caktuar nganjëherë ishte marrëveshje dhe temë e re, nganjëherë ishte konfirmim i ndonjë marrëveshje paraprake, e nganjëherë zberthim në detaje i ndonjëres prej tyre. Si pasojë, nuk ka pajtueshmëri as për numrin e saktë të marrëveshjeve të arritura.

Në mungesë të vullnetit të qeverive të njëpasnjëshme për të zhvilluar dhe ruajtur të dhëna të detajuara e të sakta për procesin e dialogut me Serbinë, ky raport do të ndihmojë në krijimin e nje memorie për procesin mjaft delikat të këtij dialogu.

Ky raport poashtu synon të iu ndihmojë institucioneve akademike, hulumtuesve e studentëve - të cilët vazhdimisht kërkojnë informata për dialogun nga Grupi për Ballkan, për të gjetur të dhëna më të sakta dhe të artikuluar për këtë proces i cili do të zgjasë edhe shumë vite.

³⁶ Radio Evropa e Lirë, "Asociacioni, çështje e ngrirë deri në vazhdimin e dialogut", 20 qershor 2019, në <https://www.evropaelire.org/a/asociacioni-dialogu-kosova-serbia-bruksel/30009089.html>

³⁷ DELO, "Balkanski spektakel v Beli hiši, ["Spektakli i Ballkanit në Shtëpinë e Bardhë"]", 04 nëntor 2019, në <https://www.delo.si/mnenja/komentarji/balkanski-spektakel-v-beli-hisi-245752.html>

³⁸ KoSSev, "Produžen rok za zamenu srpskih vozačkih dozvola, ["Zgjatet afati për ndërrimin e lejeve serbe të vozitjes"]", 4 shkurt 2020, në <https://kossev.info/produzen-rok-za-zamenu-srpskih-vozačkih-dozvola/>

³⁹ Shih artikullin "Kosovo: Crisis Uninterrupted" ["Kosova: Krizë e pandërprerë"] nga Naim Rashiti, 11 maj 2020

⁴⁰ Skender Hyseni u emërua kordinator me 21 korrik 2020. Platforma e Kryeministrit Hoti përfshinë tri parime: integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i panegociueshëm, organizimi kushtetues dhe shtetëror i Kosovës është i panegociueshëm; dhe marrëveshja duhet të jetë në përputhje me frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Për më shume lexo në <https://kryeministri-ks.net/kryeministri-hoti-prezantoi-sot-ne-akademine-e-shkencave-dhe-te-arteve-te-kosoves-kornizen-e-qeverise-se-kosoves-per-dialogun/>

⁴¹ Radio Evropa e Lirë, "Grenell paralajmëron takim të ri pas anulimit të udhëtimit të Hotit", 25 qershor 2020, në <https://www.evropaelire.org/a/30689591.html>

⁴² Shërbimi Evropian për Veprime të Jashtme, "Kosovo/Serbia: Resumption of the EU-facilitated Dialogue on Sunday" ["Kosova / Serbia: Rifillimi i Dialogut të lehtësuar nga BE të Dielën"], 7 korrik 2020, në https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/82170/kosovoserbia-resumption-eu-facilitated-dialogue-sunday_en

KRONOLOGJIA E MARRËVESHJEVE

MARRËVESHJA		DATA	
1	MARRËVESHJA PËR LËVIZJEN E LIRË	2 KORRIK 2011	
	1.1	Konkluzionet përfundimtare operative	29 nëntor 2011
	1.2	Hapja e pikave të reja të tranzitit në Serbi	14 shtator 2014
	1.3	Njohja reciproke e polisave të sigurimit	10 gusht 2015
	1.4	Heqja e barrikadës mbi urën Ibër	25 gusht 2015
	1.5	Njohja reciproke e certifikatave ADR	19 prill 2016
	1.6	Plani i BE-së për Implementimin e Marrëveshjes për Urën në Mitrovicë	5 gusht 2016
	1.7	Aranzhimet lidhur me finalizimin e zbatimit të marrëveshjes për lëvizjen e lirë të vitit 2011	14 shtator 2016
	1.8	Hapja e linjës direkte ajrore Prishtinë – Beograd dhe anasjelltas	20 janar 2020
	1.9	Vendosja e një korridori hekurudhor mes Prishtinës dhe Beogradit	14 shkurt 2020
2	REGJISTRI CIVIL	2 KORRIK 2011	
	2.1	<i>Hapja e zyrave të Agjencisë së Regjistrave Civil në komunat veriore</i>	14 shtator 2016
3	SHËNIMET KADASTRALE	2 KORRIK 2011	
4	NJOHJA RECIPROKE E DIPLOMAVE UNIVERSITARE	2 KORRIK 2011	
	4.1	Njohja reciproke e diplomave në të gjitha nivelet	19 janar 2016
	4.2	Konkluzionet operationale të grupit punues për diplomat	21 mars 2016
	4.3	Udhëzuesi i BE-së për njohjen reciproke të diplomave	4 Prill 2016
5	VULAT DOGANORE	2 SHTATOR 2011	
	5.1	Mbledhja e të hyrave doganore	17 janar 2013
	5.2	Licensimi i kompanive në veri	17 janar 2013
	5.3	Fondi i zhvillimor i mirëbesimit	17 janar 2013
	5.4	Konkluzionet per licencime doganore të importeve	16 dhjetor 2014
	5.5	Çertifikata e CPP-së	5 maj 2015

	MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT, IBM		2 DHJETOR 2011
6	6.1	Protokolli teknik	24 shkurt 2012
	6.2	Plani final i veprimit	4 janar 2013
	6.3	Ndihma e ndërsjellë juridike, MLA	9 janar 2013
	6.4	SEED - <i>Sistemi për shkëmbim të të dhënave për akcizat</i>	24 janar 2013
	6.5	Çertifikata Fitosanitare	5 shtator 2013
	6.6	Dizajni i pikëkalimeve të përhershme të IBM-it	4 shtator 2014
	6.7	Hapja e dy pikave të reja kufitare (Kapia, Izvor)	22 maj 2015
7	PËRFAQËSIMI DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL		24 SHKURT 2012
<i>Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve</i>			27 QERSHOR 2013
8	ZGJEDHJET LOKALE (FUNKSIONIMI I KATËR KOMUNAVE NË VERI)		19 PRILL 2013
	INTEGRIMI I POLICISË		31 DHJETOR 2013
9	9.1	Ligji për Amnistinë	17 shtator 2013
	9.2	Vendosja e policisë së Kosovës në veri	31 janar 2014
10	MARRËVESHJA PËR SHPËRBËRJEN E “MBROJTJES CIVILE”		26 MARS 2015
	10.1	Themelimi i institucioneve qendrore në veri	28 dhjetor 2016
11	MARRËVESHJA PËR DREJTËSI		9 SHKURT 2015
	11.1	Plani i veprimit për drejtësi	30 nëntor 2016
12	KRIJIMI I ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË KOSOVË - PARIMET E PËRGJITHSHME/ELEMENTET KRYESORE		25 GUSHT 2015
13	MARRËVESHJA PËR ZYRTARËT NDËRLIDHËS		31 MAJ 2013
	13.1	Administrimi i vizitave zyrtare	14 nëntor 2014
14	MARRËVESHJA PËR ENERGJI		8 SHTATOR 2013
	14.1	Plani i implementimit për marrëveshjen e energjisë	18 shtator 2014
	14.2	Konkluzionet e lehtësuesit të BE-së mbi implementimin e marrëveshjes për Energji	25 gusht 2015
15	MARRËVESHJA PËR TELEKOMUNIKACION		15 DHJETOR 2016
	15.1	Plani i veprimit i telekomunikacionit	25 gusht 2015
	15.2	Konkluzionet e lehtësuesit të BE-së mbi implementimin e marrëveshjes për Telekom	13 nëntor 2016

ROLI I DIALOGUT TË BRUKSELIT

Dialogu i Brukselit ka për qëllim normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë duke kontribuar njëkohësisht në uljen e tensioneve në mes të dy vendeve. Dialogu synon që palët të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe obligative me ligj, që adreson të gjitha çështjet e pazgjidhura në mënyrë që Kosova dhe Serbia të përparojnë në rrugët e tyre evropiane, të krijojnë mundësi të reja dhe të përmirësojnë jetën e qytetarëve. Një marrëveshje midis palëve është e dobishme edhe për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e të gjithë rajonit.⁴³

Një tjetër rol po aq i rëndësishëm i dialogut mbetet edhe krijimi i një ure lidhëse mes Prishtinës dhe veriut të Kosovës dhe lejimi i kësaj të fundit të ketë ndikim ekonomik dhe politik në atë zonë. Përmes këtyre bisedimeve është menduar të parandalohet ndarja e veriut duke i integruar kufijtë e saj me Serbinë në rendin e vet ligjor si dhe të gjitha strukturat paralele serbe në institucionet shtetërore të saj.⁴⁴

Dialogu poashtu shtron rrugën institucionale, të Kosovës edhe të Serbisë, drejt integritit në Bashkimin Evropian, duke kontribuar njëkohësisht në uljen e tensioneve në mes të dy vendeve. Sipas BE-së, mendohej se zgjidhja e problemeve teknike në fillim të dialogut do të krijonte parakushte të nevojshme për të gjetur zgjidhje për sfidat politike dhe për vendosjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore.

Përmirësimi i raporteve ndër-fqinjësore është një nga kriteret e domosdoshme të përcaktuara nga Komisioni i BE-së për të dy vendet.⁴⁵ Kjo është e përcaktuar edhe me kriteret e Kopenhagës dhe në strategjinë për një *perspektivë të besueshme të zgjerimit dhe për angazhim të shtuar të BE-së me Ballkanin Perëndimor*.⁴⁶ Serbia e ka të gjithë procesin e anëtarësimit pothuajse të ndërlidhur me progresin e dialogut me Kosovën.⁴⁷ Edhe Kosova e ka pranuar kushtëzimin në *Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit* (MSA) me BE-në, ku Neni 5 i saj e specifikon qartazi se Kosova zotohet për angazhim të vazhdueshëm drejt përmirësimit të dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve me Serbinë.⁴⁸

Përveç përmbushjes së kushteve për vlerësimin e progresit të dy vendeve drejt BE-së, dialogu mbi të gjitha ka për qëllim lehtësimin dhe përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve, në Kosovë dhe në Serbi. Prandaj, takimet e rregullta, informimi dhe konsultimi me qytetarët nuk duhet të mungojnë, në mënyrë që qytetarët të njihen me procesin i cili vazhdon të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre.

⁴³ Shërbimi Evropian për Veprime të Jashtme, "Dialogue between Belgrade and Pristina" ["Dialogu mes Beogradit dhe Prishtinës"], 15 korrik 2020, në https://eeas.europa.eu/diplomatic-network/eu-facilitated-dialogue-belgrade-pristina-relations/349/dialogue-between-belgrade-and-pristina_en

⁴⁴ Grupit Ndërkombëtar i Krizave, *Serbia dhe Kosova: Rruga drejt Normalizimit*, 19 shkurt 2013

⁴⁵ Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës* në njëërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike në anën tjetër, fq. 12, në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo-EU_SAA_Final_1.pdf

⁴⁶ Komisioni Evropian, Accession Criteria, ["Kriteret e anëtarësimit"], në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/glossary/terms/accession-criteria_en Kriteri i fqinjësisë së mirë është monitoruar në vazhdimësi në Raportet e Progresit të BE-së, si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë, ku në raportin e fundit (2019) theksohet ngecja momentale në këtë proces, në https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/COUNTRY_19_2776

⁴⁷ Kjo është e sanksionuar qartësisht me kapitullin 35 të negociatave me BE-në, si dhe më kapitujt tjerë që kanë të bëjnë me popullsinë, territorin dhe aspektet tjera; p.sh. kapitujt 23 dhe 24 vëjnë theksin në segmente kryesore: në gjyqësor, luftën kundër korrupsionit, të drejtat themelore dhe përshtatjen me rregullat e Schengenit, kontrollin e kufirit dhe vizat, migracionin, azilin, si edhe bashkëpunimin juridik në çështje të drejtësisë dhe ato kriminale. Serbia duhet të garantojë implementimin e legjislatimit të BE-së në shtrirjen e saj gjeografike që nuk e përfshinë Kosovën.

⁴⁸ Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës* në njëërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike në anën tjetër. Neni 13 i MSA-së saktëson se Kosova duhet t'i zbatojë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog me Serbinë. Ajo duhet të respektojë plotësisht parimet e bashkëpunimit gjithëpërfshirës rajonal, t'i trajtojë çështjet e tjera të pazgjidhura përmes dialogut dhe frymës së kompromisit, në bazë të zgjidhjeve praktike dhe të qëndrueshme, si edhe të bashkëpunojë për çështjet e nevojshme teknike dhe ligjore me Serbinë, në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo-EU_SAA_Final_1.pdf

ARRITJET KRYESORE

Në tetor të vitit 2015, Kosova arriti të nënshkruajë Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian, dhe në këtë mënyrë të definoj rrugëtimin e vet institucional drejt integritit në BE, dhe strukturat përcjellëse të saj

Pasi që pesë vende anëtare të BE-së ende nuk e njohin Kosovën, nënshkrimi i MSA-së nën emrin kushtetues ka qenë i pamundur. Kjo pengesë është tejkaluar përmes modaliteteve të dakorduara në *marrëveshjen për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal*, e cila poashtu i mundësoi Kosovës të bëhet pjesë e Procesit të Berlinit (WB6).⁴⁹

Dialogu me Serbinë ka shkaktuar shumë kontradikta në Kosovë, dhe i tërë procesi ka marrë konotacion negativ sa i përket përfitimeve për vendin, qytetarët e saj dhe rajonin. Megjithatë siç përshkruhet në raport, ky proces ka sjellur përfitime.

Arritje të tjera nga procesi i dialogut janë edhe:

- **Lëvizja e lirë e qytetarëve mes dy vendeve vetëm me letërnjoftime.**
 - Njohja reciproke e polisave të sigurimit.
- **Vendosja e rendit në pikat e kalimit kufitar; instalimi i pikave të IBM-it në gjashtë pikat kufitare me Serbinë.**
 - Arritja e bashkëpunimit në kuadër të projektit SEED (*Sistemi për shkëmbimin e të dhënave për akcizat*)
 - Harmonizimi i çertifikatave veterinare.
- **Rritja e shkëmbimeve tregtare, sidomos i Kosovës me vendet e BE-së.**
 - Mbledhja e të hyrave doganore nga dy pikat doganore Jarinjë dhe Bërnjak.
 - Themelimi i Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit për katër komunat veriore.
- **Regjistri i kompletuar Civil i Kosovës;**
 - Hapja e Agjencisë së Regjistrimit Civil në katër komunat veriore.
- **Përfaqësimi i Kosovës në organizata rajonale (dhe në disa ndërkombëtare, sidomos ato të sportit) ku tani Kosova përfaqësohet e barabartë me vendet e tjera.**
- **Ngritja e marrëdhënive të Kosovës me BE-në, sidomos në programet dhe iniciativat e veçanta si: Procesi i Berlinit, Western Balkans Investment Framework (WBIF), Erasmus+, Competitiveness of Enterprises and Small and Medium-sized Enterprises (COSME), Europe for Citizens, Creative Europe, Horizon 2020, etj.**
- **Ulja e tensioneve në veri të Kosovës, krijimi i kushteve për integrimin e qytetarëve serbë, shtrirja e institucioneve të Kosovës.**
 - Themelimi i katër komunave me shumicë serbe në veri, Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi.
 - Mbajtja e zgjedhjeve të rregullta në atë pjesë dhe përfaqësimi i serbëve në institucione shtetërore.
 - Integrimi i policisë dhe administratës civile të saj në institucionet e Kosovës.
 - Vendosja e një sistemi unitar të drejtësisë në tërë territorin e Kosovës dhe integrimi i gjykatësve, prokurorëve dhe punonjësve administrativ të komunitetit serb në institucionet e drejtësisë.
 - Shuarja e mbrojtjes civile dhe integrimi i ish pjesëtarëve të saj në institucionet e Kosovës.
- **Kodi telefonik për Kosovën.**
 - Nënshkrimi i marrëveshjes për uljen e tarifave të shërbimit të romingut me vendet e Ballkanit Perëndimor.
- **Anëtarësimi i KOSTT-it në ENTSO-E.**

Këto të arritura janë të paraqitura përgjatë këtij raporti, të ndara sipas kriterit të zbatueshmërisë së tyre, duke i analizuar ato për përfitimet që kanë sjellë dhe sfidat që i përcollën ato marrëveshje.

⁴⁹ Shih Marrëveshjet në Lidhje me Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal, në http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/agreement_0210_representation.pdf

DIALOGU I BRUKSELIT, NË NUMRA

Të dhënat e paraqitura në grafikonet e mëposhtme janë gjeneruar në mënyrë manuale nga monitorimi i mbi 240 komunikatave për media në raport me procesin e dialogut të publikuara në uebfaqen e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Monitorimi dhe analizimi i këtyre komunikatave mbulon periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2017. Raportimet e palës kosovare nuk janë gjithëpërfshirëse dhe koherente. Në shumë raste mungon edhe informacioni i plotë i të dhënave. Për këtë arsye është bërë një analizë sasiore e teksteve të artikujve apo komunikatave duke nxjerrë në përfundim të dhënat në grafikonet e mëposhtëm. Pasi që është bërë kjo analizë sasiore, janë nxjerrë në pah këto veçori: tema e diskutimit; niveli i diskutimit (politik ose teknik) përfshirja

e delegacionet të Kosovës, etj. Qeveria shpesh ka dhënë informata të mangëta e nganjëherë të pasakta. Këto informacione janë plotësuar me raporte dhe hulumtime që janë bërë rreth secilit takim portë cilat jo domosdoshmërisht janë krejtësisht të sakta. Megjithatë, këto informata janë shumë të përafërta dhe janë plotësuar për të kompenzuar mungesën e vullnetit të institucioneve për të qenë transparente dhe informuese për qytetarët.

Sipas raportimeve, deklaratave dhe të dhënave të Qeverisë së Kosovës, Zyrës së Kryeministrit dhe institucioneve tjera, dialogu deri më tani përbëhet prej:




2 DHJETOR 2011 – 25 GUSHT 2015


ME GJITHËSEJ



NATYRA E BISEDIMEVE



Sipas raporteve të institucioneve, nga temat e biseduara, IBM-i është biseduar më së shumti, në 30 takime, deri sa temat që më së paku janë biseduar janë *Trashëgimia Kulturore* dhe *Transparenca Financiare*, secila prej tyre vetëm nga një herë.



Së pari, kjo tabelë paraqet pasaktësinë e informatave të qeverisë, sepse tabelat e regjistrimit të veturave janë biseduar më shpesh se siç është raportuar. Në një formë, tabela flet edhe për ndjeshmërinë e temave dhe interesimin e grupeve biseduese, por jo domosdo tregon edhe suksesin e marrëveshjeve. Për shembull, tema e *Çertifikatave ADR*, që është diskutuar vetëm 2 herë, llogaritet si një prej marrëveshjeve më të suksesshme.

MARRËVESHJET E ZBATUARA

Disa nga marrëveshjet e dialogut filluan të zbatohen qysh me nënshkrimin e tyre, ndërsa të tjerat mbetën vetëm në letër. Edhe ato që u zbatuan kanë nivele të ndryshme të zbatueshmërisë, ndërsa vlerësimi lidhur me zbatueshmërinë e tyre, nga të dyja vendet, më shumë ka karakter politik, se sa kuantitativ.

Ky kapitull liston dymbëdhjetë marrëveshje, të cilat, bazuar në indikatorët e prekshëm nga hisedarët përkatës dhe nga vlerësimi i individëve përbrenda ekipeve negociatore, mund të konsiderohen si të suksesshme.

LIRIA E LËVIZJES

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES	Sistem i kalimit të kufirit me letërnjoftime
	Për tranzit, letërnjoftimet shoqërohen me dokumentin me shkrim “hyrje-dalje”
	Palët i mundësojnë qytetarëve të palës tjetër blerjen e polisave të sigurimit kufitar
	Mundësohet lëvizja në territorin e palës tjetër me patent-shoferë nga autoritetet e veta.
	Kosova vazhdon vlefshmërinë e targave KS për 5 vite, pastaj rishikohet
	Beogradi do t’ia mundësojë targave KS të qarkullojnë lirshëm në dhe përmes territorit të saj.
	Në dispozicion do të ketë targa të përkohshme, në pikëkalimet kufitare

Marrëveshja për lirinë e lëvizjes u arrit me 2 korrik 2011, ndërsa zbatimi i saj në praktikë filloi më 26 shtator 2011.⁵⁰ Qëllim ishte normalizimi i lëvizjes së lirë në mes të Kosovës dhe Serbisë duke përdorur dokumentet zyrtare të njëra-tjetrës, përfshirë këtu edhe njohjen e patentë shoferëve dhe tabelave të veturave.



Marrëveshja përfshinë edhe shuarjen e strukturave paralele dhe integrimin e pjesëtarëve të tyre në institucionet e Kosovës, eliminimin e dokumenteve jo-zyrtare, bashkë me tabelat ilegale të regjistrimit të automjeteve dhe hapjen e zyrave të gjendjes civile në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok.⁵¹

Përmes kësaj marrëveshje u synua edhe normalizimi i lëvizjes së lirë brenda territorit të Kosovës, në veçanti mes pjesës veriore e jugore.⁵²

Pikë me rëndësi e kësaj marrëveshje ishte edhe njohja reciproke e patentë shoferëve. Megjithatë, patentë shoferët e lëshuara për serbët e Kosovës nga ana e Serbisë nuk njihen në Kosovë.⁵³ Kjo marrëveshje mundësoi lehtësim të madh edhe për diasporën e Kosovës, e cila filloi t’ia përdori territorin e Serbisë për të udhëtuar drejt Kosovës dhe anasjelltas, duke shkurtuar kështu dukshëm kohën e udhëtimit. Megjithatë, dokumenti i “hyrje-daljes”, i paraparë me këtë marrëveshje dhe i aplikuar nga ana e Serbisë, shkakton ende vonesa.



⁵⁰ Konkluzat mbi Lirinë e Lëvizjes dhe Licencime Doganore, Bruksel, shtator 2014

⁵¹ Zyra e Kryeministrit, “Progres në konsolidimin e institucioneve qendrore në veri të vendit”, 20 korrik 2016, në <https://kryeministri-ks.net/progres-ne-konsolidimin-e-institucioneve-qendrore-ne-veri-te-vendit/>

⁵² Shih “Kjo lëvizje e vazhdueshme”, editorial i shkruar nga Besfort Kosova për KSPAG, 9 shtator 2019, në <http://k-s-pag.org/blog/post/articles/constant-move>

⁵³ KSPAG, *Pikëpamjet mbi Marrëveshjet e Dialogut Teknik në mes të Kosovës dhe Serbisë*, shkurt 2020.

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë, lëvizja e lirë e qytetarëve të saj ka qenë e sfiduar, pasi që Serbia nuk i njihnte dokumentet e udhëtimit, si dhe dokumentet e tjera të lëshuara nga UNMIK-u. Drejt apo përmes territorit të Serbisë mund të udhëtonin vetëm qytetarët që kishin dokumente valide nga periudha e administrimit të ish-Jugosllavisë apo ata që më vonë ishin pajisur me letërnjoftime e pasaporta nga strukturat paralele të Serbisë. Këto struktura paralele paguanin paga për sektorë të ndryshëm dhe pensione për qytetarët që paraqiteshin para këtyre zyrave, e njëkohësisht edhe vjelnin nga të njejtat taksa administrative e doganore. Në kundërshtim me Rezolutën 1244, ato lëshonin dokumente të Serbisë, përfshirë këtu pasaporta, dokumente personale, targa të veturave e polisa të sigurimeve, me të cilat pajiseshin serbët e Kosovës, por dhe një pjesë e shqiptarëve.⁵⁴

territorit të saj, ndërsa automjeteve me tabela 'RKS' iu vunë në dispozicion targa të përkohshme, në pikëkalimet kufitare. Që nga hyrja e saj në fuqi, kjo marrëveshje është zbatuar në nivel të kënaqshëm, ku është mundësuar kalimi me letërnjoftime të të dy shteteve përkatëse pa pasur nevojë të përdoren pasaportat. Vlenë të përmendet se përafërsisht 88% e banorëve në komunat me shumicë serbe janë pajisur me dokumente të Kosovës.⁵⁵

Me konkluzionet e reja të datës 29 nëntor 2011, qytetarët e Kosovës, me dokumente të Kosovës mund të udhëtojnë në vendet e treta përmes gjashtë pikave të tranzitit dhe dy aeroporteve në Serbi.⁵⁶ Në vitin 2011 u hapën dy kalime kufitare transit, njëra ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë (Horgosh-Roshë) dhe tjetra ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë (Batrovci-Bajakovo).



Në fillim të implementimit të marrëveshjes, polisat e sigurimit bleheshin në kufi për të udhëtuar në territorin e shtetit tjetër. Patent shoferët e njërës palë dhe palës tjetër u pranuan dhe Kosova vendosi t'a vazhdojë vlefshmërinë e targave 'KS' për një periudhë prej 5 vitesh, me mundësi zgjatjeje. Autoritetet e Beogradit do të ju mundësonin automjeteve me targa 'KS' të qarkullojnë lirshëm në dhe përmes

Në vitin 2014, u zgjerua marrëveshja e lëvizjes së lirë me hapjen e gjashtë pikave të tranzitit nga Serbia në vendet e treta, dy në tranzit ajror, e katër në atë tokësor.⁵⁷ Aeroporti Nikola Tesla i Beogradit filloi me zbatimin e marrëveshjes më 22 shtator 2014, Aeroporti i Nishit më 15 nëntor 2014, ndërsa katër pika transiti shtesë u hapën më 15 nëntor 2014.⁵⁸

⁵⁴ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, *Tranzicioni i brishtë në Kosovë*, 25 shtator 2008, fq. 7.

⁵⁵ OJQ Aktiv, *Analiza e Trendit 2019: Qëndrimet e Komunitetit Serb në Kosovë*, nëntor 2019, në <http://ngoaktiv.org/uploads/files/Analiza%20e%20Trendit%202019.pdf>

⁵⁶ Konkluzionet përfundimtare operative, grupi implementues për lirinë e lëvizjes, nëntor 2011


⁵⁷ Konkluzat mbi Lirinë e Lëvizjes dhe Licencime Doganore, shtator 2014

⁵⁸ Pikat kufitare në Sid-Tovarnik (pikëkalimi midis Serbisë e Kroacisë), Kelebia-Tompa (mes Serbisë e Hungarisë), Presheva-Tabanovce (mes Serbisë e Maqedonisë) dhe Gradina-Kalotina (mes Serbisë e Bullgarisë)

Në shtator 2016, grupet punuese u pajtuan për arranzhime të reja që e avancuan tutje marrëveshjen e lirisë së lëvizjes (*Konkluzionet e lirisë së lëvizjes, letër-ngjitëset*). Thelbi i saj ishte një reciprocitet në tabelat e automjeteve mes Kosovës dhe Serbisë, që parashihte aplikimin e letrës ngjitëse mbi simbolet shtetërore të vendeve përkatëse. Kjo marrëveshje asnjëherë nuk u zbatua nga ana e Kosovës, fillimisht për shkak të vonesave administrative (prokurimi), më pas për shkak të rënies së Qeverisë së Kosovës (10 maj 2017), por as edhe nga ana e Serbisë.⁵⁹

Pika të tjera të rëndësishme nga kjo nën-marrëveshje janë edhe largimi nga qarkullimi i tabelave të regjistrimit, të cilat Serbia i lëshonte më parë për qytetarët e Kosovës. Poashtu Kosova zgjati vlefshmërinë e tabelave KS dhe u arrit pajtimi që të hapen zyrat e Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe gjendjes civile në komunat veriore. Ishte paraparë që kryesisht në këto zyra të integrohen ish-zyrtarë nga personeli civil i MUP-it.⁶⁰

Me këtë marrëveshje u rrit edhe qarkullimi i qytetarëve nga Kosova në Serbi dhe anasjelltas.⁶¹ Poashtu është lehtësuar kalimi i automjeteve, janë ulur shpenzimet e udhëtimit dhe pritjet në vendkalime.



Megjithatë ka pengesa të herë-pas-herëshme në kalimet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Qytetarët e vendeve të treta që kanë hyrë në Kosovë përmes pikëkalimeve të Kosovës me vendet tjera apo përmes aeroportit të Prishtinës, kur dëshirojnë të vazhdojnë udhëtimin për në Serbi, në pikëkalimet Kosovë-Serbi, shpesh detyrohen nga Policia Kufitare serbe që të hyjnë në Serbi përmes pikëkalimeve fillimisht me shtetet tjera. Zakonisht ata udhëzohen që të shkojnë dhe të kalojnë kufirin Serbi-Maqedoni Veriore, me arsyetimin se kufijtë e jashtëm të Kosovës nuk i konsiderojnë kufi ndërkombëtar. Heqja e kësaj pengese nga ana e Serbisë është vendosur edhe në kapitullin 35 të negociimit për anëtarësim të Serbisë në BE.⁶² Poashtu ka raste, kur, udhëtarëve të huaj, të cilët në pasaportat e tyre kanë vula me mbishkrimet “Poashtu ka raste kur udhëtarëve të huaj, të cilët në pasaportat e tyre kanë vula me mbishkrimet “Republika e Kosovës”, autoritetet serbe ua vendosin përmbi vulat me mbishkrimin ‘Ponishteno’, që do të thotë anulohet.

Министарство унутрашњих послова
(издавање овог документа не прејудује статус)

Документ
о уласку и изласку

Име: _____
Презиме: _____
Датум и место рођења: _____
Адреса становања _____
Лични број: _____

Контрола 1 _____ Контрола 2 _____
Датум и место: М.П. Датум и место: М.П.
21.09.2018 MERDARE _____

Категорија за управљање моторним возилом: _____
Ограничења за управљање моторним возилом: _____
Регистарски број таблице: _____

НАПОМЕНА

Ималац ове потврде дужан је да исту чува и да је на захтев овлашћеног лица да на увид или преда.
Губитак потврде потребно је одмах пријавити најближој полицијској станици.

Важи до: _____ Редни број: _____
20.11.2018 М.П. 4006004

⁵⁹ Radio Evropa e Lirë, “Votohet mocioni, bie qeveria dhe shpërndahet Kuvendi”, 10 maj 2017, në <https://www.evropaelire.org/a/28477582.html>

⁶⁰ Ministria e Dialogut të Kosovës, *Raport mbi Gjendjen në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit: 16 qershor – 25 nëntor 2016*, 25 nëntor 2016, në https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Raport_mbi_gjendjen_në_zbatimin_e_Marreveshjeve_të_Brukselit_16_qershor_-_25_nentor_2016__251116.pdf

⁶¹ Bazuar në një raport të publikuar nga Qendra për Rajonalizëm në vitin 2013, numri mesatar i personave që udhëtojnë nga Kosova në drejtim të Serbisë në ditë është 4.811, ndërsa në baza vjetore, ai kishte arritur në 144.319 persona. Nga Serbia në Kosovë, 4.740 persona udhëtuan në ditë ndërsa në vit udhëtuan 142.209 persona në këtë drejtim.

⁶² Dokumenti i Anëtarësimit. Tema: Qëndrimi i përbashkët i Bashkimit Evropian. Kapitulli 35: Çështje të tjera, Pika 1: Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Nën-pika për lirinë e lëvizjes: “Serbia lejon shtetasit e shteteve të treta të hyjnë në Serbi nga Kosova.”

REGJISTRI CIVIL

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Të krijohet një regjistër civil plotësisht i besueshëm në Kosovë.

Komiteti trepalësh (ekspertët e palëve dhe EULEX si kryesues), të identifikojnë zbrastësitë në librat amzë të para vitit 1999.

Çështja e kthimit të regjistrave civil ishte një ndër temat e para të diskutuara gjatë bisedimeve Kosovë – Serbi e cila u arrit si marrëveshje me 2 korrik 2011.⁶³ Kjo marrëveshje parashihte dorëzimin e kopjeve të origjinaleve të librave amzë, përmes EULEX-it si ndërmjetësues. Marrëveshja kërkoi edhe mbylljen e zyrave paralele në Serbi të cilat vazhdonin të lëshonin dokumente për qytetarët serbë (dhe të tjerë) të Kosovës.

Kjo marrëveshje është zbatuar plotësisht. Serbia i ka dorëzuar Kosovës 12,036 kopje të skanuara të librave të regjistrimit civil, të certifikuar nga EULEX e të cilat Serbia i kishte marrë gjatë kohës së luftës në 1999.⁶⁴ Librat, që përmbajnë të dhëna për lindjet, martesat dhe vdekjet e qytetarëve të Kosovës janë skanuar, certifikuar dhe janë kthyer në Kosovë nën *Procesin e Përpunimit të të Dhënave të Regjistrave të Gjendjes Civile*.⁶⁵ Procesi i skanimit dhe verifikimit është kryer nga grupi trepalësh i ekspertëve me lehtësimin e EULEX-it, në Nish të Serbisë, e pas certifikimit nga organet e EULEX-it, ato gradualisht i janë dorëzuar autoriteteve të Kosovës.

Nga viti 1999, me largimin e administratës së ish-Jugosllavisë nga Kosova, autoritetet Serbe kishin marrë me vete pjesën dërmuese të librave të gjendjes civile të qytetarëve të Kosovës. Në mungesë të tyre dhe për faktin se Serbia refuzonte të bashkëpunonte, Administrata e UNMIK-ut kishte ndërtuar regjistrin civil të Kosovës nga e para. Megjithatë, ky regjistër kishte mangësi dhe duhej plotësuar, që të bëhej tërësisht i besueshëm për mekanizmat ndërkombëtarë. Kosova në vazhdimësi e ka ngritur

shqetësimin e mungesës së regjistrave civilë andaj edhe njëra nga temat e para të dialogut ishte pikërisht kjo çështje. Pala serbe ka pranuar që ta bëjë kthimin e kopjeve të tyre, por jo edhe të librave origjinal. Sipas marrëveshjes, kopjet e shtypura dhe elektronike të tyre, të certifikuar nga një palë e tretë, që në këtë rast ishte EULEX-i, iu dorëzuan Kosovës.

Procesi i verifikimit dhe dorëzimit u realizua brenda dy vitesh, që sipas planit do të duhej të realizohej për 9 muaj. Kjo do të mundësojë që përmbajtja e tyre të jetë e qasshme në nivelin qendror dhe atë komunal përmes sistemit ekzistues të regjistrimit të gjendjes civile, një sistem elektronik i krijuar si rezultat i shkrirjes së bazave të të dhënave të pavarura të gjendjes civile.⁶⁶



Mungesa e njoftimit adekuat të qytetarëve, sidomos të atyre serbë të Kosovës, ka rezultuar me probleme shtesë për të njejtë. Qytetarët të cilët kanë regjistruar martesat e tyre në institucionet paralele kanë hasur në vështirësi për të siguruar nënshtetësinë e Kosovës

⁶³ Konkluzat e dakorduara mbi Librat Amzë, korrik 2011

⁶⁴ Totali i 12,391 librave të regjistrimit civil i përkiste këtyre komunave: Lipjan (848), Obiliq (264), Fushë Kosovë (219), Drenas/Glllogoc/(430) Prishtinë (1013), Podujevë (1066), Gjilan (935), Kamenicë (824), Viti (726), Novobërdë (67), Ferizaj (741), Shtërpe (243), Kaçanik (167), Sh-titme (270), Pejë (687), Istog (642), Mitrovicë (735), Zveçan (249), Zubin Potok (409), Leposaviq (383), Vushtrri (919) dhe Skënderaj (554). Për më shumë shih Raportin mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit: janar – shtator 2014”, nga Ministria e Dialogut e Kosovës në BE, 10 tetor 2014, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RAPORT_MBI_GJENDJEN_NË_ZBATIMIN_E_MARREVESHJEVE_TE_BRUKSELIT_Janar_-Shtator_2014-signed.pdf

⁶⁵ Ibid.

⁶⁶ Me financimin e BE-së, *Këshilli Danez për Refugjatë (DRC)* në Kosovë ka bërë digitalizimin e tyre në mbështetje të *Agjencisë së Regjistrimit Civil të Kosovës (CRA)*.

siç është rasti i personave që janë martuar me qytetarë të Kosovës pas vitit 1999, por që martesën e kanë regjistruar në institucionet serbe paralele në Kosovë. Këta persona nuk mund të plotësojnë një prej kriterëve për përfitimin e shtetësisë së Kosovës sepse martesa e tyre nuk mund të vërtetohet në qarqet zyrtare të Kosovës.⁶⁷

Menaxhimi i sigurt i regjistrimit civil ishte edhe një nga kriteret që kërkohej nga dialogu për liberalizimin e vizave me BE-në.⁶⁸ Në praktikë, kjo marrëveshje ka pasur shumë sukses, mirëpo ka pasur raste kur edhe është përdorur për sulme banale, duke shkelur privatësinë dhe të drejtat fundamentale të njeriut. Rasti konkret është kur Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë nxorri çertifikatën e lindjes së Ambasadores së Kosovës në SHBA, Vlora Çitakut,



në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Ky gjest i vetëm dëshmon se kjo marrëveshje nuk ka ndihmuar në aspektin e normalizimit të marrëdhënieve.⁶⁹

VULA DOGANORE

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Qarkullim i lirë i mallrave në përputhje me CEFTA

Vulat doganore të Kosovës do të pranohen

Më 2 shtator 2011, u arrit *marrëveshja për vulat doganore* me të cilën Serbia pranoi t'i njohë vulat me mbishkrimin “Dogana e Kosovës” me kusht që edhe dokumentacioni përcjellës i tyre të reflektonte të njejtën gjuhë, në përputhje me marrëveshjen e CEFTA-s.

Kjo ishte një marrëveshje shumë e rëndësishme për Kosovën sepse mundësoi lëvizjen e mallrave të Kosovës. Zbatimi i saj filloi në shtator 2011.⁷⁰ Qëllim ishte mundësimi i shkëmbimit normal të mallrave në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Zbatimi i marrëveshjes ka shkuar mjaft mirë, deri në fillimin e aplikimit të taksës prej 100% të Kosovës ndaj mallrave të Serbisë dhe atyre që vijnë nga Bosnia dhe Hercegovina.⁷¹

Sidoqoftë, herë pas here janë identifikuar shkelje të marrëveshjes edhe nga ana e Serbisë, me përdorimin e vulave ilegale të ish-strukturave paralele, pa përmendur faktin që “Dogana e Prishtinës” vazhdon të figurojë në strukturën organizative të Doganave të Serbisë.⁷²

⁶⁷ Ky kriter përcakton se martesë duhet të jetë regjistruar së paku tri vite më parë me qytetarë të Kosovës, edhe në rastin kur partneri bashkëshort posedon dokumente kosovare. Link Kosovo, “Kako do kosovskih dokumenata – pitanje na koje mnogi ne mogu da odgovore” [“Si deri te dokumentet Kosovare – pyetje në të cilën shumë nuk kanë përgjigje”], 17 nëntor 2018, në <https://linkkosovo.org/kako-do-kosovskih-dokumenata-pitanje-na-koje-mnogi-ne-mogu-da-odgovore/>

⁶⁸ Ministria e Integritimit Evropian të Kosovës, “Ministri Beqaj: U vlerësuan pozitivisht hapat e deritashëm”, 29 maj 2010, në <http://www.mei-ks.net/sr/lajmet-mei/ministri-beqaj-u-vleresuan-pozitivisht-hapat-e-deritashem>

⁶⁹ Balkan Insight “Serbian Minister Confronts Kosovo Ambassador at UN”, [“Ministri Serb e konfronton Ambasadorin e Kosovës në OKB”], 1 nëntor 2019, në <https://balkaninsight.com/2019/11/01/serbian-minister-confronts-kosovo-ambassador-at-un/>

⁷⁰ Konkluzat e dakorduara. Vula Doganore, shtator 2011

⁷¹ Radio Evropa e Lirë “Kosova rrit taksën doganore për Serbinë dhe Bosnjën në 100 për qind”, 21 nëntor 2018, në <https://www.evropaelire.org/a/rritet-taksa-per-produktet-serbe-/29613129.html>

⁷² Independent Balkan News Agency, “Functioning of Serb parallel structures in Kosovo continues”, [“Funksionimi i strukturave paralele serbe në Kosovë vazhdon”], 8 korrik 2016, në <https://balkan.eu.com/functioning-serb-parallel-structures-kosovo-continues/>




Para shpalljes së pavarësisë, Kosova përdorte vula me mbishkrimin “Dogana UNMIK” me të cilat mund të eksportohej në Serbi apo të përdorej territori i saj për tranzit. Para arritjes së marrëveshjes, Serbia eksportonte mallra drejt Kosovës, ndërsa mallrat e Kosovës nuk mund të hynin në Serbi, përveç në rastet kur kompanitë e Kosovës përdornin automjete me targa të shteteve tjera, dokumente udhëtimi të Serbisë ose të shteteve tjera, apo kur ato pajiseshin me vula të origjinës nga strukturat paralele.

Kur Kosova ndërroi vulën nga “Doganat UNMIK” në “Dogana e Kosovës”, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina vendosën që mos t'i njohin ato vula dhe ndaluan kalimin e mallrave të Kosovës në territoret e tyre, duke pretenduar se *kjo do të ishte pranim i shpalljes së njëanshme të pavarësisë së*

*Kosovës në shkurt 2008.*⁷³ Pas ngritjes së tensioneve dhe dështimit të zgjidhjes së këtij problemi përmes CEFTA-s, në korrik të 2011, Kosova vendosi masa reciprociteti dhe bllokoj importet nga këto dy vende.⁷⁴ Qeveria e Kosovës poashtu dërgoi njësitë speciale të policisë për marrjen në kontroll të të dy pikëkalimeve në veri, Bërnjak e Jarinjë. Serbët e veriut reagues duke vendosur barrikada dhe duke bllokuar rrugët me ç’rast tensionet u rritën edhe më shumë. Situata e re kërkoi intervenimin e KFOR-it. Si përgjigje ndaj këtyre zhvillimeve, BE-ja insistoi më fuqishëm që krahas dialogut për pikat kufitare të hartojë edhe marrëveshjen për vulat doganore.

Vendosja e kontrollit në pikat doganore në veri dhe marrëveshja për vulat rregulloi edhe hyrjen e mallrave përmes pikave doganore Jarinjë dhe Bërnjak. Si rezultat, Dogana e Kosovës fillojë mbledhjen e të hyrave nga këto pika, të cilat u rritën nga viti në vit. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, kjo marrëveshje ka prodhuar efekte pozitive ekonomike gjithashtu për faktin që prodhuesit e Kosovës e përdorin Serbinë si rrugë më të shkurtë tranziti për eksporte drejt tregjeve evropiane. Nga viti 2013 e tutje, vlera e mallrave që kanë kaluar si tranzit nëpër territorin e Serbisë e destinuar për tregun evropian është rritur vazhdimisht gjë që shihet edhe në tabelën e mëposhtme.

VLERA E MALLRAVE TË KOSOVËS ME DESTINACION VENDET EVROPIANE, QË KALUAN NËPËR SERBI




⁷³ Ekrem Krasniqi dhe Anes Alic, “Trade: The New Balkan War”, [“Tregtia: Lufta e Re Ballkanike], Qendra për Studime të Sigurisë, ETH Zurich, në <https://css.ethz.ch/content/specialinterest/gess/cis/center-for-securities-studies/en/services/digital-library/articles/article.html/102549>

⁷⁴ Vendim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës për parimin e reciprocitetit në marrëdhëniet tregtare, Prishtinë, mars 2011, në <https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/4A154821-BACC-4163-BDBC-3E531B5BD7F3.pdf>

Marrëveshja mundësoi edhe rritjen graduale të eksporteve të Kosovës drejt Serbisë, siç edhe shihet në tabelën e mëposhtme. Situata e re stabilizoi qarkullimin e mallrave në mes të dy vendeve. Eksporti i rregullt me Serbinë në vitin 2012 në total ishte 10,6 milionë euro, e menjëherë në vitin 2013 kjo shifër arriti në mbi 19,5 milionë euro.

Importet nga Serbia në vazhdimësi kanë shënuar rritje. Megjithatë marrëveshja për vulat doganore së bashku me IBM-in dhe marrëveshjet e tjera kanë ulur ndjeshëm kontrabandën në veri të Kosovës.⁷⁵ Tabela me të dhëna të detajuara është përpiluar nga Dogana e Kosovës me kërkesë të Grupit për Ballkan.

SHKËMBIMET TREGTARE MES KOSOVËS DHE SERBISË - 2008-2019-MILION EUR



PËRFAQËSIMI DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Kosova* - emërtimi që do të përdoret në bashkëpunim rajonal.

Kosova merr pjesë në interes të saj dhe flet për veten e saj në të gjitha takimet rajonale.*

BE-ja do t'i informojë organizatat rajonale dhe do të monitorojë zbatimin e arranzhimeve.

“Organizata rajonale” janë ato ekzistueset dhe të rejtat që do të themelohen.

“Takimet rajonale” përfshijnë edhe takimet me BE-në sipas agjendës Evropiane.

Arranzhimet janë aprovuar në baza të përkohshme.

⁷⁵ Intervistë e Grupit për Ballkan me anëtarë të institucioneve, Prishtinë, Mitrovicë e Veriut, 2018-2019

Marrëveshja për bashkëpunim dhe pjesëmarrje rajonale u arrit me 24 shkurt 2012. Kosova dhe Serbia përmes saj ishin pajtuar për mënyrën e pjesëmarrjes së Kosovës në nisma dhe organizata rajonale. Deri në vitin 2011, Kosova kishte arritur të përfaqësohej në pak organizata ndërkombëtare si në Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, ndërsa në organizatat rajonale përfaqësohej vetëm përmes UNMIK-ut, dhe atë në tri të tilla: CEFTA, Komunitetin e Energjisë dhe në Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit.



Vështirësitë e pranimit të Kosovës në organizatat rajonale vinin sidomos nga Serbia e Bosnja dhe Hercegovina.⁷⁶ Në raport me BE-në, pesë anëtarë (Spanja, Greqia, Qipro, Rumania dhe Sllovakia) nuk e kishin njohur pavarësinë e Kosovës dhe kjo situatë e pengonte vendosjen e marrëdhënieve bilaterale me BE-në.⁷⁷ Përmes arritjes së një marrëveshje me Serbinë për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen rajonale të Kosovës, synohej të hiqeshin barrierat që pengonin Kosovën të bëhej pjesë e organizatave të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare, duke ndërprerë përfaqësimin e Kosovës përmes UNMIK-ut.

Me këtë marrëveshje përcaktohet përfaqësimi i Kosovës në iniciativa dhe organizata rajonale duke e vendosur fusnotën përkrah emrit të saj ("Kosovo*") me tekstin shpjegues: *Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi shpalljen e*

*pavarësisë së Kosovës.*⁷⁸ Për këtë arsye, shumëkush në Kosovë, këtë marrëveshje e quan edhe si *marrëveshja e fusnotës*.

Marrëveshja qartëson se Kosova merr pjesë vet dhe flet për veten e saj në të gjitha takimet rajonale. Me rastin e përafritimit dhe/ose nënshkrimit të marrëveshjeve të reja, përfaqësuesi i Kosovës do të nënshkruajë në përputhje me këtë dakordim. Falë kësaj marrëveshjeje, Kosova arriti të nënshkruante Marrëveshjen për Stabilizim- Asocim (MSA) me BE-në, me 27 tetor 2015. MSA-ja shënon marrëveshjen e parë bilaterale të Kosovës me BE-në.⁷⁹ Si rrjedhojë, Kosovës iu mundësua edhe pjesëmarrja në Procesin e Berlinit, krahas 5 shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor, një iniciativë kjo e BE-së lidhur me zgjerimin e saj në të ardhmen.⁸⁰

Një tjetër qështje që e rregulloi marrëveshja ishte përdorimi i simboleve shtetërore (flamujve), ku u precizua se nikoqirët e takimeve do të inkurajohen të shmangin shfaqjen e simboleve nacionale të vendeve pjesëmarrëse, përveç atyre të vet nikoqirit dhe të BE-së, varësisht statutit të organizatës përkatëse. Kjo nënkuptonte se, nëse vendosen flamujt e të gjitha shteteve pjesëmarrëse, atëherë duhet të vendoset edhe flamuri i Kosovës, siç edhe ndodhi, në takimet e *Procesit të Berlinit*, por edhe në raste të tjera.



Marrëveshja shfuqizoi rolin e UNMIK-ut në këto takime, i cili para kësaj marrëveshje e përfaqësonte Kosovën. Sipas marrëveshjes, UNMIK-u mund të jetë prezent vetëm në takime ku është nënshkruar,

⁷⁶ Kosovo 2.0, "Anëtarësimi i Kosovës në Interpol, larg për t'u siguruar", 18 gusht 2017, në <https://kosovotwopointzero.com/kosovos-interpol-membership-far-assured/>

⁷⁷ Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA) & Grupi për Hulumtim të Politikave në Ballkan (BPRG), *Skenarët e 'Finales së Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë*, prill 2018.

⁷⁸ Këshilli i Evropës, "EU facilitated dialogue: Agreement on Regional Cooperation and IBM technical protocol" ["Dialogu i lehtësuar nga BE: Marrëveshja për bashkëpunimin rajonal dhe protokoll teknik të MIK"], shkurt 2012, në https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/EN/foraff/128138.pdf

⁷⁹ Shih Ministria e Integritimit Evropian, "Marrëveshja e Stabilizim Asociimit", në <https://www.mei-ks.net/sq/procesi-i-stabilizim-asociimit-78>

⁸⁰ Raport i Grupit për Ballkan, *Procesi i Berlinit në Ballkanin Perëndimor: Përfitimet dhe Sfidat për Kosovën*, janar 2018

dhe atë si vëzhgues, pa rolin e përfaqësuesit. Marrëveshja i mbulon organizatat ose aranzhimet ekzistuese dhe ato ndër-qeveritare në të ardhmen, qëllimi i të cilave është promovimi i bashkëpunimit dhe integritit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Takimet rajonale përfshijnë takimet e këtyre organizatave dhe poashtu takimet jo-formale me qëllime të ngjashme, si dhe takimet me institucionet e BE-së në kontekst të agjendës evropiane.

Vlenë të përmendet se edhe pse marrëveshja nuk kishte të bënte me organizatat sportive ndërkombëtare, Federata e Futbollit të Kosovës kishte



arritur që t'i përdorte aranzhimet e kësaj marrëveshje për pranimin e Federatës së Futbollit të Kosovës në UEFA dhe FIFA. Ndeshjet e para zyrtare përfaqësuesja e Kosovës i kishte zhvilluar duke vendosur fusnotën (*) në fanellat sportive.⁸¹ Me pranimin e Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, një nga sportistet më të shquara në botë, Majlinda Kelmendi, e cila në lojërat olimprike në Londër në vitin 2012 e përfaqësoi Shqipërinë, arriti që katër vite më vonë, më 2016, në Rio të Brazilit (një shtet që nuk e ka njohur Kosovën) – t'a fitojë edhe medaljen e parë të artë për shtetin e saj në këto lojëra.

Nga arritja e kësaj marrëveshje e deri më sot, Kosova është bërë anëtare e një numri të madh të organizatave rajonale por jo vetëm, përfshirë këtu Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (RCC); Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), Shkollën Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), Organizatën rajonale për migracion, menaxhim të kufijve dhe zbatim të ligjit (MARRI), Qendrën për Bashkëpunim në Siguri (RACVIAC), Qendrën e Evropës Juglindore për zbatim të ligjit (SELEC), Drejtorinë Evropiane për Cilësinë e Mjekësisë dhe Kujdesit Shëndetësor e të tjera.⁸²

IBM – MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Instalimi i objekteve të përbashkëta të vendkalimeve të IBM-it sipas praktikave evropiane.

Harmonizimi i legjislacionit sipas konceptit të IBM-it të BE-së.

Integrimi i objekteve brenda një zone të përbashkët.

Prani e balancuar e shërbimeve përkatëse nga të dy palët, në gjashtë pikat kufitare mes Kosovës dhe Serbisë.

Formimi i një grupi trepalësh implementues, kryesuar nga BE-ja.

Shkëmbimi elektronik i të dhënave doganore.

⁸¹ FIFA, "Friendly games with teams of the Football Federation of Kosovo", ["Lojëra miqësore me epike të Federatës së Futbollit të Kosovës"], 6 shkurt 2013, në <https://www.fifa.com/mm/document/affederation/administration/02/01/19/65/circularno.1342-friendlygameswithteamsofthefootballfederationofkosovo.pdf>

⁸² Për listën e plotë të organizatave rajonale e ndërkombëtare ku Kosova është anëtarësuar, shih Shtojcën 2 të këtij raporti.



Marrëveshja për menaxhimin e pikave kufitare, e quajtur IBM (*Integrated Border Management*, Menaxhimi i Integruar i Kufirit), konsiderohet si njëra nga marrëveshjet më të rëndësishme që është arritur në mes Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja u arrit më 2 dhjetor 2011 dhe me qëllim të zbatimit të saj, tre muaj më vonë, më 24 shkurt 2012, ishte miratuar *Protokolli Teknik për zbatimin e Konkluzave të Dakorduara të Dialogut IBM-it të 2 dhjetorit 2011*.⁸³

Marrëveshja, në një farë forme ka bërë që Kosova dhe Serbia ta pranojnë juridiksionin e njëra-tjetrës dhe të vendosin një bashkëpunim ndërkufitar, përfshirë pikëkalimet e përbashkëta, komunikimin dhe bashkëpunimin në mes të autoriteteve policore, doganore dhe agjencive tjera që kryejnë kontrolle kufitare. Para marrëveshjes, gjendja në terren ka qenë tejet e tensionuar; pikëkalimet në veri ishin djegur dhe nuk ekzistonte asnjë lloj bashkëpunimi në mes të institucioneve të Kosovës dhe atyre të Serbisë.

Në praktikë, kjo marrëveshje ka mundësuar rindërtimin e pikëkalimeve të djegura pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, në pjesën veriore (Jarinjë dhe Bërnjak), dhe zbatimin e konceptit të IBM-it në të gjashtë pikëkalimet kufitare në mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në lehtësimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe mallrave, por edhe në rritjen e sigurisë së kontrollit kufitar bazuar në standardet dhe praktikatat më të mira evropiane.⁸⁴

Autoritetet policore doganore dhe agjencitë e tjera të të dy shteteve që kryejnë kontrolle kufitare kanë vendosur instrumente të bashkëpunimit dhe mbajnë takime mes vete në intervale të rregullta, në nivel lokal në pikëkalimet kufitare. Sipas marrëveshjes, mekanizmat e kordinimit ishin paraprë edhe në nivel qendror në mes të udhëheqësve të institucioneve që do të mbaheshin në Prishtinë dhe Beograd. Në praktikë, këta mekanizma funksionojnë me vështirësi dhe pala serbe shpesh herë refuzon të bashkëpunojë, ndonëse këto komunikime lehtësohen nga Bashkimi Evropian, përmes EULEX-it dhe zyrave përkatëse të BE-së në të dy vendet.

Rezultat tjetër i rëndësishëm i kësaj marrëveshje është edhe nënshkrimi i bashkëpunimit në kuadër të projektit SEED (*Sistemi për shkëmbimin e të dhënave për akcizat*), që mundësoi shkëmbimin e informatave të doganave në kohë reale.⁸⁵ Tutje, bashkëpunimi ndërmjet Odës Ekonomike të Serbisë dhe Odës Ekonomike të Kosovës që filloi në mesin e vitit 2013, duke diskutuar tema që kishin të bënin me qarkullimin e lirë të mallrave dhe shërbimeve, arriti që t'i bëjë operative certifikatat e harmonizuara veterinarë qysh nga 1 marsi 2016.⁸⁶

Duke qenë se kjo marrëveshje ishte zbatuar në nivele të kënaqshme, në shtator të vitit 2014, BE-ja vendosi që me fondet e IPA-së për Kosovën të ndërtojë pikat e përhershme kufitare. Ngjajshëm, nga fondet e IPA-së për Serbinë, BE-ja alokoi 12 milion euro për ndërtimin e tri pikave tjera kufitare (Jarinjë, Dheu

⁸³ Konkluzionet e dakorduara të IBM-it, dhjetor 2011, Protokolli Teknik për zbatimin e Konkluzave të Dakorduara të Dialogut IBM-it të 2 dhjetorit 2011

⁸⁴ Lexo "Vijat ndarëse, dhe pikat ndërlidhëse në to (IBM)", 6 gusht 2019, në <http://k-s-pag.org/vijat-ndarëse-dhe-pikat-nderlidhëse-ne-to-ibm/>

⁸⁵ Për më shumë për Systematic Electronic Exchange of Data [Sistemi për shkëmbimin e të dhënave], lexo në <http://www.eu-seed.net>

⁸⁶ Forum for Ethnic Relations & Heinrich Boell Stiftung, "Overcoming barriers to business and normalization", ["Tejkalimi i barrierave për biznes dhe normalizim"], qershor 2017, në https://rs.boell.org/sites/default/files/overcoming_barriers_to_business_and_normalization.pdf

i Bardhë dhe Muçibabë).⁸⁷ Pikëkalimet në Merdare dhe Mutivodë kanë përfunduar ndërsa të tjerat ende nuk kanë filluar. Mungesa e dialogut teknik në dy vitet e fundit ka bërë që të ngecë edhe zbatimi i plotë i kësaj marrëveshje. Si pasojë, autoritetet serbe ende nuk janë zhvendosur në pikëkalimet e sapo-ndërtuara në Merdare dhe Mutivodë, e poashtu është ndalur rrjedha e takimeve dhe kontakteve të rregullta të autoriteteve në mes të dy vendeve.

Kërkohej një angazhim më i madh nga ana e BE-së dhe e të dy qeverive në mënyrë që kjo marrëveshje të implementohet plotësisht. Kjo marrëveshje pati rëndësi të madhe në vendosjen e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Serbisë në luftën kundër kimit të organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe narkotikëve. Poashtu, me përjashtim të periudhave të caktuara, koha e pritjes për të kaluar kufirin është zvogëluar dukshëm.⁸⁸



MBLEDHJA E TË HYRAVE DOGANORE

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

A. GRUMBULLIMI I DETYRIMEVE

Të gjitha mallrat mund të hyjnë në Kosovë* përmes Pikave të Kalimit Doganor (PKD), të Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK) në Jarinjë dhe Bërnjak, dhe lirohen nga detyrimet në Terminalin e Mitrovicës jugore.

B. FONDI ZHVILLIMOR I MIRËBESIMIT

Promovon zhvillimin socio-ekonomik në katër komunat veriore.

Të hyrat e grumbulluara në Jarinjë dhe Bërnjak do të transferohen në llogarinë e Fondit në një bankë komerciale në Prishtinë të caktuar nga BE-ja.

⁸⁷ Nga fondet e IPA-së për Kosovën 12 mil euro u parapanë për ndërtimin e objekteve të përhershme kufitare në Merdare, Mutivodë dhe Bërnjak. Për më shumë lexoni “IPA II: Over €11 billion to support reform efforts in enlargement countries”, [“IPA II: Mbi 11 miliardë euro për të mbështetur përpjekjet e reformave në vendet e zgjerimit”], në https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_14_1043 dhe Komisioni Evropian, “Strategic / Interim Evaluation of EU IPA Preaccession Assistance to Kosovo (under UNSCR 1244/99)”, [“Vlerësimi strategjik / i përkohshëm i ndihmës së BE-së para-pranimit të IPA-së në Kosovë (nën Rezolutën 1244/99)”], 2013, në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/financial_assistance/phare/evaluation/2013/evaluation_report_kosovo_ares_836741.pdf dhe “Funding to main migration-related activities in the Western Balkans and Turkey”, [“Financimi i aktiviteteve të mëdha të lidhura me migracionin në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”], tetor 2015 në https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/MEMO_15_5535

⁸⁸ Shih Raportin Vjetor të Doganës së Kosovës për vitin 2014, fq. 23, në <https://dogana.rks-gov.net/wp-content/uploads/2016/11/DOGANA.E.KOSOVES.2014.shqip.831898.pdf>

Marrëveshja për mbledhjen e të hyrave doganore në pikat kufitare veriore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë – në Jarinjë dhe Bërnjak – e arritur me 17 janar 2013, ka parashikuar që të hyrat e grumbulluara nga zhdoganimi i mallrave që kanë për destinacion territorin e katër komunave veriore, të kalojnë në *Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit*.⁸⁹

Vendosja e pikave doganore dhe krijimi i fondit zhvillimor kanë zvogëluar hyrjen e pakontrolluar të mallrave përmes veriut e që shumë prej tyre kishin destinacion tërë territorin e Kosovës. Para vendosjes së pikave dhe fillimit të grumbullimit të të hyrave doganore, veriu ishte bërë burim i kontrabandës dhe kriminalitetit e që kishte involvuar jo vetëm qytetarë të veriut por edhe qytetarë dhe grupe kriminale nga pjesët tjera të Kosovës.⁹⁰ Kjo ndodhëte për arsye se bizneset serbe që vepronin në pjesën veriore, refuzonin të paguanin të hyrat doganore të Kosovës.


Andaj, fondi u pa si një zgjidhje me përfitime për institucionet e Kosovës dhe qytetarët e veriut, me që synon nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik për katër komunitat veriore: Leposaviqit, Mitrovicës Veriore, Zubin Potokut dhe Zveçanit. Fondi menaxhohet

nga një Bord Drejtues i përbërë nga Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Ministri i Financave të Kosovës dhe një përfaqësues në emër të komunitetit serb nga pjesa veriore e Kosovës. Projektet e financuara nga ky fond aprovohen nga bordi menaxhues dhe bëhen publike nga Zyra e BE-së në Kosovë.⁹¹ Pas marrëveshjes, edhe kontrabanda është zvogëluar siç evidentohet edhe në raportin vjetor të Doganës së Kosovës për vitin 2014.⁹²

Me 25 korrik 2013, Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, ku pjesë e pakos ligjore u bë edhe Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit.⁹³ Në shtator 2013, ligji hyri në fuqi, pas një vlerësimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese i cili ishte inicuar nga një grup deputetësh.⁹⁴

Të hyrat nga të dy pikat e kalimit kufitar, Jarinjë dhe Bërnjak, transferohen nga Minsitria e Financave e Kosovës në një llogari të krijuar në një bankë tregtare në Prishtinë, e cila menaxhohet nga Zyra e BE-së në Kosovë. Deri më 31 dhjetor 2018, Fondi ka mbledhur më shumë se 15.5 milion euro.

TË HYRAT DOGANORE (EUR) NGA MALLRAT QË HYJNË NË JARINJË DHE BËRNJAK E TË CILAT ZHDOGANOHEN NË TERMINALIN DOGANOR MITROVICË 2008 - 2009



⁸⁹ Konkluzione e BE-së për zbatimin e Marrëveshjes për Grumbullimin e të Ardhurave Doganore, janar 2013

⁹⁰ Deri në 85 përqind të importeve përmes Veriut janë të destinuara për Kosovën në jug të lumit Ibër. Disa importues paguanin doganë në terminalin e Mitrovicës së Jugut, siç udhëzohenin nga zyrtarët e EULEX në kufi, por shtatë nga dhjetë nuk e bënë atë. Shih Raportin e Grupit Ndërkombëtar të Krizave, North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice, ["Veriu i Kosovës: Sovraniteti i Dyfishtë në Praktikë", 14 mars 2011, fq. 15, në <https://d2071andvip0wj.cloudfront.net/211-north-kosovo-dual-sovereignty-in-practice.pdf>]

⁹¹ Development Fund. List of funded projects by Municipality, [Fondi i Zhvillimit. Lista e projekteve të financuara nga Komunitat], dhjetor 2018 në https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/df_projects_as_at_5_december_2018.pdf

⁹² Shih Raportin Vjetor të Doganës së Kosovës për vitin 2014, fq. 23, në <https://dogana.rks-gov.net/wp-content/uploads/2016/11/DOGA-NA.E.KOSOVES.2014.shqip.831898.pdf>

⁹³ Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2860>

⁹⁴ Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-201 nga Gjykata Kushtetuese për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, në http://gjkk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ko_118_13_shq.pdf



Burimi: Zyra e BE në Kosovë⁹⁵

Deri më tani, Bordi Menaxhues ka aprovuar 30 projekte të ndryshme në vlerë prej 11 milion euro. Këto projekte tani janë në fazën e tyre të zbatimit. Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës e bën auditimin e mjeteve të shpenzuara nga ana e këtij fondi.⁹⁶ Në mars të vitit 2020, Zyra Kombëtare e Auditimit konkludoi se komunat në veri nuk ishin mjaft efikase në menaxhimin e projekteve të financuara nga Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit gjatë viteve 2017-2019, e në disa raste nuk ishin

efektive. Fondi synon t'i jap përparësi projekteve të investimeve publike, të cilat do të kenë ndikim në zhvillimet socio-ekonomike në komunat në veri. Në mënyrë të veçantë, projektet që propozohen duhet të synojnë përmirësimin e jetës së popullatës lokale, të jenë financiarisht të qëndrueshme, me kosto efektive, përgjegjëse ndaj mjedisit dhe të qëndrueshme.⁹⁷ Fondi do të mund të bashkëfinancojë edhe projekte tjera të financuara nga BE-ja, ose edhe donatorë të tjerë, me të cilët Qeveria e Kosovës ka marrëveshje bashkëpunimi.

ZYRTARËT NDËRLIDHËS

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Zyra Ndërlidhëse, dokumentet dhe stafi i saj gëzojnë paprekshmëri dhe mbrojtje personale

Zyrtari Ndërlidhës, stafi i tij dhe anëtarët e familjeve të tyre pajisen me letërnjoftime të veçanta

Palët mbajnë kanale të hapura të drejtpërdrejta të komunikimit me Zyrtarin e vet Ndërlidhës

Automjeti i Zyrtarit Ndërlidhës pajiset me targa të barasvlerëshme me ato që iu jipen Zyrës së BE-së.

Lejohet hyrja e granteve dhe lirimi nga detyrimet për:

- a) artikujt për përdorim zyrtar të Zyres Ndërlidhëse
- b) artikujt për përdorim personal të Zyrtarit Ndërlidhës, stafit ose anëtarëve të familjes së tij.

⁹⁵ Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, “Kosovo* and the EU”, [“Kosova* dhe BE-ja”], maj 2016, në https://eas.europa.eu/delegations/kosovo_en/1387/Kosovo%20and%20the%20EU

⁹⁶ Shih Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2017, në http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/08/RVA-2017_Shqip.pdf

⁹⁷ Këto projekte mund të lidhen me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike, përfshirë rrugët, spitalet, furnizimin me ujë, trajtimin e ujërave të ndotura dhe menaxhimin e mbeturinave; pastaj mbështetje për biznesin, fermat dhe shoqëritë civile; promovimi i të drejtave të njeriut, arsimit, qasja në kujdesin shëndetësor dhe transportin. Development Fund. List of funded projects by Municipality, [Fondi i Zhvillimit. Lista e projekteve të financuara nga Komunitat], dhjetor 2018, në https://eas.europa.eu/sites/eas/files/df_projects_as_at_5_december_2018.pdf

Në takimet që u mbajtën më datat 28-29 janar, 5 shkurt, 14 shkurt, 5-6 mars, 11 mars, 9 maj dhe 30 maj të vitit 2013, Kosova dhe Serbia u pajtuan për shkëmbimin e zyrtarëve ndërlidhës. Kjo kishte për qëllim vendosjen e raporteve në mes të dy vendeve dhe lehtësimin e komunikimit në mes të dy qeverive. Me theks në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit dhe administrimin e vizitave zyrtare, Kosova dhe Serbia ishin pajtuar që të emërojnë nga një zyrtar ndërlidhës me qëllim që të monitorojnë dhe të përfshihen në çdo çështje që ka të bëjë me normalizimin e marrëdhënieve. Ata u parapanë të kenë zyra funksionale brenda objekteve të delegacioneve të BE-së në të dy vendet.⁹⁸ Hapi i parë drejt implementimit të kësaj marrëveshjeje u bë me 17 qershor 2013 kur u shkëmbyen zyrtarët ndërlidhës dhe kur grupet e dialogut ranë dakord për dispozitat që do të zbatohen për zyrtarin ndërlidhës dhe stafin e tij.⁹⁹

Të dyja vendet kanë shkëmbyer përfaqësues zyrtarë për herë të parë. Ish ambasadori i Kosovës në Suedi, Lulzim Peci u emërua si Zyrtar Ndërlidhës i Kosovës në Beograd dhe Dejan Pavićević si Zyrtar Ndërlidhës i Serbisë në Prishtinë.¹⁰⁰

Marrëveshja parasheh që zyrtari të ketë edhe një ndihmës, dhe ata sikurse edhe rezidencat e tyre, dokumentet që përdorin, përfshirë korrespondencën zyrtare, të gëzojnë mbrojtje ngjashëm me atë diplomatike. Palët nuk janë pajtuar për elementet e tjera të cilat do t'a zbatonin marrëveshjen plotësisht, si dukja e e vulave zyrtare përkatëse të ndërlidhjes dhe vendosja e zyrave. Zyrtarët operojnë pa vula dhe Serbia refuzon me çdo kusht vendosjen e zyrave jashtë zyrave të BE-së.

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Palët përkatëse do të njoftojnë palën tjetër rreth vizitave të zyrtarëve të tyre.

Vizitat nga presidenti, kryeministri, zëvendëskryeministrat, kryetari i kuvendit dhe ministrat e punëve të brendshme, punëve të jashtme dhe të mbrojtjes duhet njoftuar 72 orë përpara. Ndërsa vizitat nga të gjithë ministrat e tjerë, drejtorët e zyrave qeveritare, kryetarët e gjykatave kushtetuese dhe supreme, prokurori i shtetit si dhe të gjithë personat tjerë duhet njoftuar 48 orë përpara.

Në rast emergjence që kërkon udhëtim të menjëhershëm, të dy ZN-të mund të bien dakordohen në mënyre ad-hoc.

Të gjitha ndryshimet e mundshme në programet e vizitave duhet të bëhen të paktën 24 orë para vizitës.

Zbatimi i pikave të lartpërmendura do të vlerësohet dhe nëse është e nevojshme do të rishikohet pas 3 muajsh me kërkesën e njëres apo dy palëve.

⁹⁸ Konkluzionet e Kryesuesit, Marrëveshjet Ndërlidhëse, maj 2013.

⁹⁹ Ibid.

¹⁰⁰ Sidoqoftë, vetëm dy ditë pasi filloi misionin e tij si zyrtarë ndërlidhës i Kosovës në Beograd, Lulzim Peci i ofroi dorëheqjen e tij Presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga. Shkaqet kryesore ishin kritikën e ish-Kryeministrit të Kosovës pas deklaratës së tij se normalizimi i marrëdhënieve do të arrihet vetëm kur Serbia dhe Kosova të njohin reciprokisht njëra-tjetrën si shtete sovranë. Nga ana tjetër, zyrtari ndërlidhës i Serbisë në Kosovë, deklaroi në Prishtinë se Serbia kurrë nuk do ta njohë Kosovën dhe se pozicioni i tij nuk është diplomatik, por përkundrazi vetëm për të lehtësuar komunikimin midis Prishtinës dhe Beogradit. Shih Radio Evropa e Lirë, "Jep dorëheqje Lulzim Peci", 19 qershor 2013 në <https://www.evropaelire.org/a/25022069.html> dhe B92, "Kosovo talks: Liaison offices to issue visit permits", [Flet Kosova: Zyrtarët ndërlidhës të lëshojnë leje të vizitave], 18 nëntor 2014, në https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2014&mm=11&dd=18&nav_id=92279

Një nën-marrëveshje është arritur edhe më 14 nëntor 2014, ku delegacionet u pajtuan mbi rregullat dhe modalitetet specifike për vizita zyrtare të zyrtarëve të Kosovës në Serbi dhe anasjelltas.¹⁰¹ Me këtë marrëveshje të dy zyrat ndërlidhëse janë ngarkuar për të administruar vizitat zyrtare të zyrtarëve të qeverive përkatëse.

Zbatimi i kësaj marrëveshje ishte i kënaqshëm deri në momentin kur zyrtari serb Marko Gjuriq në vitin 2018 hyri pa leje paraprake në Kosovë me ç'rast edhe u arrestua.¹⁰² Kjo bëri që shumë marrëveshje që ishin në zbatim e sipër të pezullohen, siç janë takimet e rregullta për IBM-in, kalimi i zyrtarëve Serb në godinën e re kufitare në Merdare, etj. Me një fjalë, pasoi një suspendim i padakorduar i zbatimit dhe avancimit të mëtejshëm të marrëveshjeve.

Mund të thuhet se roli i zyrtarëve ndërlidhës është minimizuar tej mase dhe ata nuk kanë arritur të zgjerojnë bashkëpunimin mes dy vendeve apo të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve me të cilat përballen qytetarët nga të dy anët. Një aspekt i mirë i prezencës së zyrtarit ndërlidhës të Kosovës në Serbi është komunikimi më i mirë dhe i drejtëpërdrejtë me ambasadat e huaja në Beograd.

Megjithatë pas largimit të Valdet Sadikut, Kosova nuk ka arritur ende t'a dërgojë një zyrtar ndërlidhës të profilit të lartë. Momentalisht, Kosova është e përfaqësuar nga një i ngarkuar me këtë punë, dhe Serbia përfaqësohet nga ish-negociatori i Serbisë në Dialogun Teknik të Brukselit, por i cili kalon shumë pak kohë në Kosovë.¹⁰³

Zyrat merren me çështje që ndërlidhen me komunikimin në mes të dy qeverive, koordinojnë vizitat e zyrtarëve të lartë publik dhe angazhohen për zgjidhjen e problemeve në aspektin e lirisë së lëvizjes, tregtisë, etj., me të cilat ballafaqohen institucionet, bizneset dhe qytetarët e të dy vendeve.

Këtë vit është shquar roli i përfaqësuesit të Serbisë në Kosovë, në bartjen e fletëvotimeve të serbëve të Kosovës që jetojnë në Serbi, të cilët për shkak të mungesës së bashkëpunimit në mes të Postës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, nuk kanë mundur që votat e tyre t'i dërgojnë me postë. Mirëpo këtë e kanë bërë përmes zyrtarit të tyre ndërlidhës, i cili më pas i ka sjellë ato në Kosovë dhe i ka dorëzuar në zyrën postare.¹⁰⁴

Ky veprim doli të jetë mjaft kontravers, meqenëse arritja e votave nga Serbia shkaktoi ndërprerjen e procesit të verifikimit të votave në Qendrën e Verifikimit, pasi që të njejtat lëshonin aromë dhe disa prej verifikuesve u ankuan për alergji pasi kishin prekur ato kovert.¹⁰⁵ Edhe pse ato fletëvotime u numëruan nga KQZ-ja, ato u shpallën të pavlefshme nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia me arsyetim se mënyra e dorëzimit të tyre nga persona të paautorizuar më shumë i ngjason votimit kolektiv i cili çënon dhe minon integritetin e procesit zgjedhor dhe është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Gjykata Supreme ka pranuar 7 ankesa të deputetëve nga subjekte të ndryshme politike sa i përket vendimit të PZAP-sës mirëpo ato ankesa u refuzuan dhe si rezultat këto vota u shpallën të pavlefshme.¹⁰⁶

¹⁰¹ Marrëveshja për Vizitat Zyrtare, nëntor 2014

¹⁰² Klan Kosova, "Lajmi i fundit: arrestohet Marko Gjuriq", 26 mars 2018, në <https://klankosova.tv/lajmi-i-fundit-arrestohet-marko-gjuriq/>

¹⁰³ Koha "Kosovari u varros në Novi Sad, askush nuk u paraqit për të marrë trupin e tij", 30 gusht 2019, në <https://www.koha.net/arberi/181757/kosovari-u-varros-ne-novi-sad-askush-nuk-u-paraqit-per-te-marre-trupin-e-tij/>

¹⁰⁴ Insajderi "Këta janë dy personat që dyshohet se sollën zarfet helmuese nga Serbia", tetor 2019, në <https://insajderi.com/keta-jane-dy-personat-qe-dyshohet-se-sollen-zarfet-helmuese-nga-serbia/>

¹⁰⁵ Radio Evropa e Lirë, "KQZ pret rezultatet e hetimeve për zarfet nga Serbia", 13 tetor 2019, në <https://www.evropaelire.org/a/kqz-zarfe-serbi-/30214237.html>

¹⁰⁶ Telegrafi, "Gjykata Supreme refuzon ankesat e kandidatëve për deputetë për votat nga Serbia", 14 nëntor 2019, në <https://telegrafi.com/gjykata-supreme-refuzon-ankesat-e-kandidateve-per-deputete/>

ZGJEDHJET LOKALE / FUNKSIONALIZIMI I KOMUNAVE NË VERI

NGA PARIMET PËR NORMALIZIM

11. Zgjedhjet lokale në komunat e veriut do të organizohen në vitin 2013, me ndërmjetësimin e OSBE-së, në përputhje me ligjin e Kosovës, dhe me standardet ndërkombëtare

Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, në pikën 11 kishte paraparë mbajtjen e zgjedhjeve lokale në komunat e veriore të Kosovës në vitin 2013, me lehtësimin e OSBE-së, në përputhje me ligjin e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare.¹⁰⁷

Komunat	Zgjedhjet Lokale	Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune
Mitrovica e Veriut	2013, 2017	2014, 2019
Leposaviq	2013, 2017	2019
Zubin Potok	2013, 2017	2019
Zvečan	2013, 2017	2019

Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Qëllimi ishte që për herë të parë pas pavarësisë së Kosovës, të mbahen zgjedhjet legjitime në këto komuna dhe të ndërtohen institucionet lokale pothuajse nga e para dhe të njejtat të integrohen në juridiksionin e Kosovës. Nga pikëpamja e Beogradit në anën tjetër, mbajtja e zgjedhjeve në veri do të krijonte kushte për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe, e cila ishte pjesë e po të njejtës marrëveshje.¹⁰⁸

Siç edhe ishte paraparë me marrëveshjen për normalizimin, zgjedhjet lokale në komunat veriore u mbajtën për herë të parë në nëntor 2013.¹⁰⁹ Që nga atëherë, përkundër vështirësive, qytetarët kanë marrë pjesë kënaqshëm në zgjedhjet lokale dhe qendrore të Kosovës. Në 2014 janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar komune në Komunën e Mitrovicës së Veriut. Në 2017, janë mbajtur zgjedhjet lokale në katër komunat veriore të Kosovës, ndërsa në 2019 u mbajtën përsëri zgjedhje të jashtëzakonshme lokale në këto komuna.¹¹⁰



¹⁰⁷ Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, prill 2013

¹⁰⁸ Zgjedhjet do të mbaheshin dhe do të zyrtarizonin krijimin e komunës së Mitrovicës së Veriut, krahas tri komunave tjera, sipas planit të Ahtisarit që tashmë ishin bërë ligje të Kosovës.

¹⁰⁹ Gjatë zgjedhjeve lokale në katër komunat e veriut në Maj të 2019, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dalja e votuesve ishte më e lartë se 42 për qind. Shih Radio Evropa e Lirë, "Rezultatet preliminare: Lista Serbe fitoi në katër komunat veriore", 19 maj 2019, në <https://www.evropaelire.org/a/komunat-veriore-ne-zgjedhje-te-jashtezakonshme/29949941.html>

¹¹⁰ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në <http://www.kqz-ks.org/per-kryetar-te-komunave/>

Por, këto komuna janë sfiduar vazhdimisht nga strukturat paralele dhe nga mungesa e përkrahjes për konsolidimin e plotë të tyre në planin ligjor dhe demokratik.¹¹¹ Marrëveshja kishte paraparë integrimin e komunave paralele në ato të Kosovës të krijuara pas zgjedhjeve dhe shuarjen e strukturave komunale serbe. Kjo nuk ka ndodhur dhe komunat e reja janë krijuar me personel të ri, me ç'rast, një

numër i tyre janë të punësuar në të dy sistemet, duke bërë që komunat paralele të vazhdojnë të funksionojnë. Në Shërbimin Civil në Administratën Lokale të Komunës së Mitrovicës së Veriut janë të punësuar 150 qytetarë.¹¹² Tabela e mëposhtme paraqet numrin e shërbyesëve civil të katër komunave të veriut të ndarë sipas departamenteve sipas ndarjes buxhetore për vitin 2020.

INSTITUCIONI	Mitrovicë e V.	Leposaviq	Z. Potok	Zveçan
Zyra e Kryetarit	6	9	14	20
Administrata dhe Personeli	33	72	40	27
Inspektimet	6		9	
Prokurimi	3			
Zyra e Kuvendit Komunal				
Buxhet dhe Financa	8	10	9	13
Shërbime Publike Mbrojtja Civile Emergjencia	39	19	13	13
Zyra Komunale për Komunitet	3	7	7	4
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	2	5	7	8
Zhvillimi Ekonomik	2	5	6	6
Kadastra dhe Gjeodezia	8	5	11	4
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	6	5	10	9
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	93	84	70	76
Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale	14	10	12	12
Shëndetësia Sekondare	225			
Kultura, Rinia dhe Sportet	5	6	8	5
Arsimi dhe Shkenca	404	332	205	171
Totali	857	569	421	368

Burimi: Ligji Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

¹¹¹ Raport i Grupit Ndërkombëtar të Krizave, *Will the Real Serbia Please Stand Up?*, [“A do ngrihet në këmbë Serbia e vërtetë?”] 23 prill 2008

¹¹² Intervistë e Grupit për Ballkan, me zyrtarë të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL), Prishtinë, janar 2020.

Komunat e reja ende operojnë pa logo zyrtare dhe ato e respektojnë vendosjen e simboleve të Kosovës vetëm në komunikim me institucionet e Kosovës. Kryetarët e tyre në vazhdimësi përdoren politikisht nga Beogradi, si në rastin e detyrimit për të dhënë dorëheqje nga postet e tyre (nëntor 2018), si pasojë e aplikimit të tarifës nga ana e Kosovës.¹¹³

Gjithësesi, themelimi i këtyre komunave në veri dhe vazhdimësia e pjesëmarrjes së qytetarëve të tyre në zgjedhjet lokale të Kosovës mund të shihet si një arritje mjaft pozitive. Poashtu, qytetarët kanë rritur interesin e tyre për shërbimet komunale, regjistrat civilë dhe dokumentacionet e tjera. Duke qenë se komunat e reja të Kosovës në veri ende nuk funksionojnë plotësisht sipas ligjit, ato nuk arrijnë të marrin mjaftueshëm fonde të mjaftueshme për të realizuar projekte të ndryshme zhvillimore dhe infrastrukturore. Poashtu, për shkak të problemeve politike, kanë dështuar edhe procese të tjera të rëndësishme, siç është regjistrimi i popullsisë.¹¹⁴

Megjithatë, standardet minimale të funksionimit të tyre sipas ligjeve të Kosovës janë përmbushur dhe komunikimi i tyre me Ministrinë përgjegjëse për Administrimin e Pushtetit Lokal (MAPL) është i rregullt. Në raport me institucionet e Kosovës, këto komuna lëshojnë dokumente valide sipas ligjeve të Kosovës por në raport me qytetarët dhe Serbinë përdorin logo dhe vula të Serbisë. Duhet theksuar edhe një herë se sfida kryesore e funksionimit ligjor të tyre lidhet me prezencën e strukturave administrative paralele në këtë pjesë, si edhe me aplikimin e ligjeve të Serbisë në disa sektorë lokal.

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit 2019 në këto katër komuna, OSBE-ja ka pasur vetëm një rol këshillues teknik ndaj Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve.¹¹⁵ Ndërsa për zgjedhjet e vitit 2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka lëshuar udhëzimin sipas të cilit, votim i vlefshëm në zgjedhjet e ardhshme të 6 tetorit, konsiderohet vetëm ai që realizohet përmes dokumenteve identifikuese të lëshuara nga institucionet e Republikës së Kosovës.¹¹⁶

Kjo është bërë e mundur për faktin se shumica e qytetarëve serb të pjesës veriore, tanimë rreth 35 mijë, janë të pajisur me dokumente personale të Kosovës.¹¹⁷ Subjektet politike që përfaqësojnë serbët e Kosovës patën reaguar ndaj këtij vendimi.



 Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Qeveria-Vlada-Government Opština Leposaviq Komuna e Leposaviq Municipality of Leposaviq	
DATE/A	11.12.2017
REFERENC-Ë:	
PER/ZA/TO:	Doganën e Kosovës/ Carinu Kosova
CC:	
PERMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Dragan Jablanovic Kryetar i komunës e Leposaviq/Gradonacelnik Opštine Leposaviq
TËMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Konfirmim/Potrvida

Të nderuar/ Poštovani

Konfirmojmë se importi është raportuar dhe vërtetuar si grant, financuar nga Unioni Evropian dhe menaxhuar nga ARDA.

Te bashkangjitur gjeni: kontraten e grantit, kontraten e shitblerjes së mallit, profutura nr 066/17, urdherpagesat nga banka si dhe dokumentacioni i regjistrimit të biznesit i perfituesit të grantit- "DARKO VUKAŠINOVIĆ I.B."

Potvrdujemo da je uvoz prijavljen i proveren kao grant, finansiran od Evropske Unije i upravlan od ARDA.

U prilogu nadjite: Ugovor granta, ugovor o kupoprodaji robe, predracun br. 066/17, naloge za placanje od banke kao i dokumentaciju registracije biznisna korisnika granta- "DARKO VUKAŠINOVIĆ I.B."

Me respect / S poštovanjem

Dragan Jablanovic

¹¹³ DW, "Japin dorëheqje katër kryetarët serbë të komunave në veri të Kosovës", 27 nëntor 2018, në <https://www.dw.com/sq/japin-dor%C3%ABheqje-kat%C3%ABr-kryetar%C3%ABt-serb%C3%AB-t%C3%AB-komunave-n%C3%AB-veri-t%C3%AB-kosov%C3%ABs/a-46470410>

¹¹⁴ Radio Evropa e Lirë, "Qeveria insiston për regjistrimin e popullsisë në veri", 8 qershor 2016, në <https://www.evropaelire.org/a/27786862.html>

¹¹⁵ Radio Evropa e Lirë "Daka: Zgjedhjet e parakohshme janë sfiduese për shkak të afateve kohore", 4 shtator 2019, në <https://www.evropaelire.org/a/valdete-daka-zgjedhjet-6-tetor-/30146142.html>

¹¹⁶ Radio Evropa e Lirë "Në zgjedhjet e 6 tetorit votohet vetëm me dokumente të Kosovës", 13 shtator 2019, në <https://www.evropaelire.org/a/zgjedhjet-votimi-kqz/30162255.html>

¹¹⁷ Intervistë e Grupit për Ballkan, ekspert në dialogun Kosovë-Serbi, 1 gusht 2020.

TELEKOMUNIKACIONI

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Kosovës do të i ndahet kodi telefonik 3-shifror nga ITU.


Operatorët e të dy palëve do të reduktojnë kostot e thirrjeve lokale në përputhje me praktikat e BE-së.

Rregullatorët e të dy palëve do të pajtohen për marrëveshje teknike për Sistemin Global për Komunikime Mobile (GSM) dhe sinjale televizive, procesin e interkoneksionit dhe roaming-un, si edhe harmonizim të frekuencave dixhitale.

Një licencë për shërbime të telefonisë fikse do i lëshohet një kompanie të re, degë e një kompanie serbe, regjistruar në përputhje me kornizën rregullatore të Kosovës.

Telefoni mobil - Kosova do i lëshon një kompanie të re autorizim të përkohshëm, sipas kornizës së vet rregullatore. Autorizimi skadon kur Kosova lëshon licencë të re të plotë, përmes një tenderi.

Më vonë do të diskutohen edhe shërbimet postare.



telekomunikimit për qytetarët brenda territorit të Kosovës dhe në raport me Serbinë, si dhe sigurimin e kodit ndërkombëtar për Kosovën. Më konkretisht, marrëveshja përcakton vetëm një kod telefonik për thirrjet e brendshme dhe ndërkombëtare si dhe redukton kostot e thirrjeve lokale për qytetarët, duke i larguar të gjithë operatorët ilegalë nga Kosova.¹¹⁸

Telekomunikacioni ishte njëra nga temat e diskutuara gjatë gjithë kohës së dialogut teknik dhe marrëveshja finale u arrit tek më 25 gusht 2015, me nënshkrimin e *Planit të Veprimit* për implementimin e marrëveshjes së telekomunikacionit.¹¹⁹ Marrëveshja e kësaj fushe parashihej të ndikojë tutje në normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë përmes përcaktimit të kufirit të telekomunikimeve mes tyre.

Që nga viti 1999, operatorët telefonik serbë kishin funksionuar në një pjesë të territorit të Kosovës dhe vetëm pas shumë vitesh, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës (ARKEP), kishte arritur t'i largonte disa nga stacionet e tyre, përveç atyre në komunat veriore

Marrëveshja për telekomunikacionin ishte arritur më 8 shtator 2013, por bisedimet për zbatimin e saj filluan në janar 2014. Qëllimi i kësaj marrëveshje është normalizimi i marrëdhënieve në fushën e

¹¹⁸ Plani i veprimit i telekomunikacionit, gusht 2015, në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani_i_perbashket_i_veprimit_per_Telekomin_FINAL_-_25_Gusht_-_2015_-_perkthimi_zyrtar_Shqip.pdf

¹¹⁹ Ministria e Dialogut të Kosovës, *Raport mbi Gjendjen në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit: mars – shtator 2015*, 6 tetor 2015, në https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/RAPORT_MBI_GJENDJEN_NE_ZBATIMIN_E_MARREVESHJEVE_TE_BRUKSELIT_061015-signed.pdf

dhe në ndonjë zonë të ndjeshme për të shmangur tensionet, siç është zona ku gjendet Kisha Ortodokse Serbe në Graçanicë, etj.¹²⁰

Marrëveshja u mundësua edhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, e sidomos Austrisë, e cila në emër të Kosovës e paraqiti kërkesën pranë ITU-së (*International Telecommunication Union*), në bazë të së cilës, një kod 3-shifror iu nda Kosovës.¹²¹ Procesi varej nga pëlqimi i Serbisë sepse anëtarët e ITU-së janë vetëm vendet anëtare të OKB-së.

Më 15 dhjetor 2016, ITU njoftoi se Kosova është pajisur me kodin e saj telefonik +383 duke ia mundësuar asaj të jetë prezente në regjistrat e telekomunikacionit online. Kodi filloi të funksionojë më 2 shkurt 2018.¹²²



Plani i Veprimet e njeh të drejtën që Kosova të administrojë kodin e saj shtetëror sikurse vendet e tjera dhe ARKEP-i obligohet të bashkëpunojë me

ITU-në për zbatimin e kodit të ri. Sa i përket planit të zbatimit, disa kundërshtime u shfaqën ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në lidhje me formulimet që do të përdoren për t'iu referuar kodit. Megjithëse, Kosova kërkoi të përfshijë pjesën që Kosova të jetë mbajtëse e "kodit telefonik shtetëror", zgjidhja reciproke erdhi si: "kodi (et) ndërkombëtar (e) për Kosovën".¹²³ Tri çështjet më problematike në këtë proces ishin transferimi i pasurisë, shpërndarja e frekuencave dhe vendndodhjet e stacionit bazë.¹²⁴

MTS u licencua si një operator i përkohshëm i cili ofron shërbime të telefonisë fikse dhe asaj mobile në zona të caktuara, sipas marrëveshjes dhe licencës së lëshuar nga ARKEP. Lidhur me transferimin e asetëve të saj, u vendos që kompania e re (MTS d.o.o.), e regjistruar më 13 tetor 2015, do e merr pronësinë mbi pasuritë e përdorura nga Telekom Srbija SH.A në Kosovë dhe punonjësit e saj.¹²⁵ Po në atë datë, licencat hynë zyrtarisht në fuqi dhe ARKEP ia lëshoi MTS-së 60,000 numra celularë dhe 74,000 numra fiks. Në janar 2017, është vënë në përdorim sinjali i telefonisë celulare i MTS-së për klientët në Brezovicë dhe Shtërpçë. Ndërsa në maj 2017, MTS riaktivizoi sinjalin e telefonisë fikse në të gjitha zonat ku jetojnë komunitetet serbe në Kosovën qendrore.¹²⁶ Marrëveshja ka vendosur përfundimisht rregull në këtë fushë të telekomunikimeve, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.¹²⁷

¹²⁰ "Operatorët telefonik serbë kanë qenë në Kosovë para konfliktit të vitit 1999 dhe kanë mbetur kryesisht të paprekur deri vonë. Operatori shtetëror, Mobilna Telefonija Srbije (MTS), ka zhvilluar dhe freskuar rrjetin e tij në Kosovë dhe deri më 2010 sinjali i tij ka mbuluar shumicën e territorit... Mobitel, prona e një magnati serb të Kosovës, Bogoljub Kariç, para se të konfiskohej nga Beogradi dhe ti shitej operatorit norvegjez Telenor, ka bashkëpunuar mirë me afaristë shqiptarë por kurrë nuk është regjistruar zyrtarisht në Kosovë. Në prill të vitit 2010, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) ka ndërprerë pa paralajmërim punën e disa antenave të MTS-së duke e zbritur dramatikisht kapacitetin e rrjetit, por nuk është në gjendje të fikë dhjetë antenat e tjera në Veri." Shih Raportin e Grupit Ndërkombëtar të Krizave, *Kosova dhe Serbia pas mendimit të GJND-së*, 26 gusht 2010, fq. 22.

¹²¹ KFOS, *Darkness and Silence after the Bruxelles Agreement: Analysis of the Agreement on the Energy and Communication*, ["Errësirë dhe Heshtje pas Marrëveshjes së Brukselit: Analiza e Marrëveshjes për Energji dhe Komunikim"], 2018, në <http://crnobelisvet.com/wp-content/uploads/2018/02/DARKNESS-AND-SILENCE-AFTER-THE-BRUXELLES-AGREEMENT.pdf>

¹²² Buletini Operacional Nr. 1114 (15 dhjetor 2016) dhe Lista e Aneksit: Lista e Rekomandimeve ITU-T E.164 kodet e vendit të caktuar, ITU, në <https://www.itu.int/pub/T-SP-OB.1114-2016>

¹²³ Zyra për Kosovë dhe Metohi, *Progress Report on the Dialogue between Belgrade and Pristina*, ["Raporti i progresit për dialogun teknik mes Kosovës dhe Serbisë"], prill 2015, në <http://kim.gov.rs/doc/Finalni%20Izvestaj%20KKiM%20april%202015%20engl.pdf>

¹²⁴ Zyra për Kosovë dhe Metohi, *Progress Report on the Dialogue between Belgrade and Pristina: April - October 2016*, ["Raporti i progresit për dialogun teknik mes Kosovës dhe Serbisë: Prill - Tetor 2016"], tetor 2016, në <http://kim.gov.rs/doc/2.1%20Izvestaj%20april-oktobar%202016%2018102016%20eng.pdf> Për tabelën e vendndodhjeve të stacioneve bazë shih aneksin I të Vendimit nr. 905 (nr. prot. 056/B/16) për përdorimin e spektrit nga 'mts' d.o.o. gjatë autorizimit të përkohshëm për ofrimin e shërbimeve të tel. mobile nën infrastrukturën e kufizuar, në <http://www.arkep-rks.org/repository/docs/Individual%20Authorization%20on%20spectrum%20usage%20by%20mts%20D%20O%20O%20-%20905.pdf>

¹²⁵ Vendimet nga AKREP, në http://arkep-rks.org/?cid=1%2C26&fbclid=IwAR2JguRgqHruf45kMqwcnc_2C2fc7Y6Y3jI6ERbv-97mKfMUNrzCZwa-3tac. Raportohet se kompania MTS d.o.o. ka paguar mbi 300,000 euro taksa në ATK për vitin 2017-2018. Ndërsa mbi 500,000 euro për vitin 2019. në vitet 2017-2018 kompania ka paguar mbi 300,000 euro ndaj administratëstaksa në ATK tatimore Ataksa buxhetit të Kosovës, ndërsa në vitin 2019, mbi 500,000 euro. Intervistë e Grupit për Ballkan, Prishtinë, shkurt 2020.

¹²⁶ KFOS, *Darkness and Silence after the Bruxelles Agreement: Analysis of the Agreement on the Energy and Communication*, ["Errësirë dhe Heshtje pas Marrëveshjes së Brukselit: Analiza e Marrëveshjes për Energji dhe Komunikim"], 2018.

¹²⁷ Prezantimi i planit kombëtar të numrave ITU-T E.164 për kodin e vendit: 383, në https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/oth/02/02/T02020000FD0001PDFE.pdf

Qytetarët që përdorin shërbimet e kompanisë së re në Kosovë mund të telefonojnë në Serbi pa e përdorur kodin tre shifror ndërkombëtarë (pa kosto shtesë roamingu) dhe anasjelltas. Sipas marrëveshjes, stacionet bazë të kompanisë do të vendosen në 30 lokacione. Gjatë dialogut Serbia kishte kërkuar t'i mbante 72 stacionet aktive të telekomit të Serbisë ndërsa Kosova insistonte në vendosjen e tyre në vetëm 22 lokacione.¹²⁸

Marrëveshja e telekomit do të rrisë sigurinë në fushën e telekomunikimeve, duke kontrolluar trafikun e telefonisë fikse dhe mobile nga ana e Kosovës. Poashtu, shtohen edhe të hyrat në buxhetin e Kosovës, ngaqë nuk ka më përdorim të kodeve të tri shteteve tjera. Siç dihet, që nga themelimi në vitin 2000, operatori mobil Vala për shfrytëzimin e prefiksit të Monakos (+377), i ka paguar Monaco Telecom-it rreth 200 milionë euro, në total.¹²⁹ Me kodin e vet telefonik, Kosova është në gjendje të ofrojë shërbime më të mira të telefonisë me kosto më të favorshme për qytetarët e saj, duke pasur parasysh që serveri menaxhues i këtij kodi do të jetë në Prishtinë.

Një prej qëllimeve të marrëveshjes për telekomunikacion, ka qenë edhe krijimi i parakushteve për marrëveshje komerciale mes operatorëve të dy vendeve për roaming-un dhe lehtësimi i procesit të interkoneksionit. Arritja e këtyre marrëveshjeve synon të ndikoj drejtpërsëdrejtë në uljen e tarifave dhe rrjedhimisht kostove të komunikimeve për qytetarët e të dy vendeve pa dallim përkatësie etnike.¹³⁰ Sipas Qeverisë së Kosovës, është bërë përparim i kufizuar në marrëveshjet e roming-ut midis operatorëve, me qëllim të uljes së tarifave të përdoruesve.

Operatorët individual të Kosovës dhe Serbisë nuk kanë arritur ta avancojnë marrëveshjen për çështjen e roamingut.¹³¹ Një iniciativë e mëhershme e RCC-së për t'a rregulluar çështjen e roamingut në frymën e rregullimit të saj në kuadër të BE-së u avancua edhe më tej gjatë viteve të fundit. Marrëveshja e Parë Rajonale për Roming (RRA), u nënshkrua në shtator 2014, por ajo nuk e përfshinte Kosovën dhe Shqipërinë por vetëm Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë Veriore dhe Serbinë.¹³² Kjo ndodhi meqenëse Kosova nuk e kishte kodin e vet shtetëror.

Në Samitin e Dytë Dixhital të mbajtur në Beograd në prill të vitit 2019, në kuadër të Procesit të Berlinit dhe Planit të Veprimit shumëvjeçar në Zonën Ekonomike Rajonale (MAP REA) për Ballkanin Perëndimor, u nënshkrua marrëveshja për uljen e tarifave të shërbimit të romingut nga ministrat e të gjitha vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor.¹³³ Kosova gjithashtu është pjesë e kësaj marrëveshje.¹³⁴ Tarifa e roming-ut nënkupton telekomunikimin dhe shërbimin që qytetarët e një shteti përdorin në një shtet tjetër. Këto tarifa ishin shumë më të larta. Kjo marrëveshje është incicuar nga Bashkimi Evropian si formë lehtësimi për komunikimin ndërmjet qytetarëve. Marrëveshja e roming-ut pritet të zbatohet në tërësi që nga korriku i vitit 2021, kurse ulja e tarifave tashmë vetëm po zbatohet.¹³⁵

¹²⁸ ARKEP, "Vendim Nr. 905 për Autorizim Individual", Shtojca I në <http://www.arkep-rks.org/repository/docs/Individual%20Authorization%20on%20spectrum%20usage%20by%20mts%20D%20O%20O%20-%200905.pdf>

¹²⁹ KSPAG, "Alo Kosova", 26 gusht 2019, në <http://k-s-pag.org/alo-kosova/>

¹³⁰ Shih Marrëveshjen për Telekomunikacion

¹³¹ Ministria e Dialogut e Kosovës, *Raport mbi Gjendjen në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit*, 18 qershor 2018, në [http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbiarritjetdhesfidatnezbatimineMarrëveshjeveBrukselit_18qershor2018_GAc6YnWvKU\(1\)_hx-wNkAUHPK.pdf](http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbiarritjetdhesfidatnezbatimineMarrëveshjeveBrukselit_18qershor2018_GAc6YnWvKU(1)_hx-wNkAUHPK.pdf)

¹³² Puna e platformës u zgjerua për të mbështetur zbatimin e veprimeve nën MAP REA dhe Agjendën Dixhitale për Ballkanin Perëndimor. Platforma përbëhet nga përfaqësuesit e ministrisë së TIK-ut dhe agjencitë rregullatore për komunikimet elektronike në Ballkanin Perëndimor. Ajo gjithashtu ka qenë përgjegjëse për të përpunuar analizën e parë të konsoliduar rajonale të kornizës institucionale, ligjore dhe rregullatore të rëndësishme për politikën e roaming, si dhe ka shërbyer si një përmbledhje e sistematizuar rajonale e të dhënave për ndikimin në treg të RRA-së. Këshilli Rajonal për Roaming, në https://www.rcc.int/working_groups/18/regional-roaming-platform

¹³³ Marrëveshja për uljen e çmimit të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimit mobil në rajonin e Ballkanit perëndimor, në <https://www.rcc.int/docs/476/regional-roaming-agreement-for-the-western-balkans>

¹³⁴ E nënshkruar nga Ministri i atëhershëm i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës

¹³⁵ Komisioni Evropian, "Entry into force of the new Western Balkans regional roaming agreement: clear drop in roaming charges", ["Hyrja në fuqi e marrëveshjes së re për roaming rajonal të Ballkanit Perëndimor: rënie e qartë e tarifave të roaming"], 1 korrik 2019, në <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/entry-force-new-western-balkans-regional-roaming-agreement-clear-drop-roaming-charges>

	Koha	Thirrje dalës	Thirrje hyrëse	SMS	Transferi të dhënash MB
Shqipëria	Çmimet deri në 30 qershor 2019	1,72	1,40	0,52	2,92
	% e pagesa	-87% deri -97%	-97%	-86% deri -95%	-93% to -99%
Bosnje dhe Herzegovina	Çmimi maksimal nga 1 korriku 2019	0.14	N/A	0.05	0.13
	% e ndryshimit	WB4 (-25% deri -27%)	WB4 (-13% deri -20%)	WB4 (-6% deri -17%)	WB4 (-27% deri -31%)
	Shqipëri & Kosovë*	(-85% deri -92%)	(-87% deri -97%)	(-71% deri -88%)	(-94% deri -99%)
Kosova	Çmimet deri në 30 qershor 2019	1.75	0.50	0.30	2.00
	Çmimi maksimal nga 1 korriku 2019	0.15	0.047	0.04	0.04
	% e ndryshimit	-91%	-90%	-85%	-98%
Mali i Zi	Çmimet deri në 30 qershor 2019	0.23	0.06	0.07	0.24
	Çmimi maksimal nga 1 korriku 2019	0.09	0.04	0.04	0.03
	% e ndryshimit	-57%	-74%	-42%	-87%
Maqedonia e Veriut	Çmimet deri në 30 qershor 2019	1.22	0.49	0.26	4.19
	Çmimi maksimal nga 1 korriku 2019	0.08	0.05	0.04	0.03
	% e ndryshimit	-93%	-90%	-84%	-99%
Serbia	Çmimet deri në 30 qershor 2019	0.23	0.05	0.07	0.25
	Çmimi maksimal nga 1 korriku 2019	0.09	0.05	0.03	0.03
	% e ndryshimit	-62%	-20%	-50%	-87%

Burimi: Regional Cooperation Council

INTEGRIMI I POLICISË

NGA PARIMET PËR NORMALIZIM

7. E gjithë policia në veri të integrohen brenda kornizës së Policisë së Kosovës.

8. Pjesëtarëve të strukturave serbe të sigurisë do t'u ofrohet vend në strukturat ekuivalente të Kosovës.

9. Një Komandant Regjional i Policisë do emërohet për katër komunat në veri, nominuar nga MPB nga lista e ofruar nga kryetarët e katër komunave në veri

Me Marrëveshjen e Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve është paraparë integrimi i pjesëtarëve të policisë së MUP-it, duke ju ofruar vend në strukturat ekuivalente të Kosovës. Gjithashtu, Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës (MPB) emëron Komandantin Rajonal për territorin e katër komunave veriore, nga lista e ofruar nga kryetarët e katër komunave, në emër të Asociacionit dhe i cili duhet të vijë nga komuniteti serb.¹³⁶

Para arritjes së marrëveshjes, në pjesën veriore të Kosovës ka operuar ilegalisht policia e Serbisë (MUP). Kjo strukturë ka funksionuar sipas ligjeve dhe në kuadër të komandës së Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Përveç policëve të uniformuar, pjesë e kësaj strukture ishin edhe administrata civile e MUP-it, të cilët lëshonin dokumente të gjendjes civile të Serbisë dhe kryenin funksione tjera administrative.¹³⁷

¹³⁶ Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, në http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/First_agreement_of_principles_governing_the_normalization_of_relations_April_19,_2013_Brussels_en.pdf

¹³⁷ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, *North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice*, ["Veriu i Kosovës: Sovraniteti i dyfishtë në praktikë"], 14 mars 2011, në <https://d2071andvip0wj.cloudfront.net/211-north-kosovo-dual-sovereignty-in-practice.pdf>



Gjatë bisedimeve në Bruksel pala serbe ia dorëzoi autoriteteve të Prishtinës një listë prej 337 pjesëtarëve të policisë të cilët duhej të integroheshin. Prej tyre, 285 u ftuan t'i bashkëngjiten procesit të integrimit, ndërsa 52 u hoqën nga lista.¹³⁸ Nga 71 pjesëtarë të sekretariatit të policisë serbe, 45 prej tyre hasën në sfida në procesin e integrimit në zyrat e gjendjes civile në katër komunat veriore.¹³⁹ Nga 668 pjesëtarë sa mendohet të kenë shërbyer për MUP-in serb, numri i të integruarve në Policinë e Kosovës, përkatësisht në Drejtorinë Rajonale Mitrovicë-Veriu në fund ishte 287.¹⁴⁰

Në praktikë, kjo ishte më e komplikuar, sepse numri i pjesëtarëve serbë ishte shumë më i madh se sa numri që parashihej të integrohet në policinë e Kosovës sipas standardeve të aplikuara në Kosovë dhe BE – bazuar në numrin e policëve sipas numrit të banorëve dhe përqindjes së minoriteteve të përfshira.¹⁴¹ Sipas këtij standardi, me më pak se dy milionë banorë, Kosova do të duhej të ketë rreth 6,000 policë, por numri aktual i pjesëtarëve të policisë së Kosovës tashmë arrin në mbi 8,000.¹⁴² Megjithatë, Policia e Kosovës planifikonte t'i pranonte edhe 300 pjesëtarë nga radhët e komunitetit serb, nga katër komunat veriore.

Përafërsisht kaq ishte edhe numri i atyre që kishin punuar deri në vitin 2008 në kuadër të policisë së Kosovës, dhe shumica prej tyre ishin kthyer në kuadër të MUP-it pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Këto komuna kanë shtrirje të madhe territoriale, por numri i banorëve vlerësohet të jetë më i vogël se pesëdhjetëmijë, edhe pse nuk ka pasur regjistrim të popullsisë që t'a dëshmojë numrin e saktë të banorëve atje.¹⁴³

Prej atyre që nuk u integruan kishte persona që nuk e kaluan me sukses procesin e verifikimit të kaluarës kriminale nga institucionet e Kosovës. Një pjesë i ishte afruar moshës së pensionimit ndërsa një numër i vogël refuzuan të integrohen apo ta nënshkruajnë “Deklaratën e lojalitetit”, dokument ky që i obligonte të integruarit të deklarohen zyrtarisht se do të respektojnë vetëm ligjet e Kosovës, nuk do të marrin pagë tjetër përveç nga Policia e Kosovës dhe se të njejtit do t'i nënshtrohen urdhërave të zinxhirit komandues të Policisë së Kosovës. Pjesa e administratës së MUP-it mbeti e paintegruar dhe për ta u arrit pajtimi që të gjithë 45 personat të bëhen pjesë e Agjencisë për Regjistrim Civil e cila i punësoi pas një periudhe.

¹³⁸ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë, *Integrimi i policisë në Kosovën Veriore: Progresi dhe sfidat e mbetura në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit*, 2014

¹³⁹ Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan

¹⁴⁰ Ministria e Dialogut e Kosovës, *Raport mbi Gjendjen në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit*, 18 qershor 2018.

¹⁴¹ Në përgjithësi, 318 policë për 100,000 banorë në Evropë, 2016, në <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/DDN-20190104-1>

¹⁴² Kosova ka mes 327 dhe 398 policë për 100,000 banorë, krahasuar me 427 në Kroaci, 476 në Maqedoni dhe 540 në Itali. Shih Grupi Ndërkombëtar i Krizave, *Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavarur*, 19 maj 2010, fq. 7.

¹⁴³ “Vlerësim: Popullsia e Kosovës 2019” nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në <http://ask.rks-gov.net/media/2127/vlersim-popullsia-e-kosoves-2011.pdf>

Pasi që dialogu u ndërpre, këta persona, edhe pse i kaluan trajnimet dhe u përgatitën për të filluar lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile në komunat veriore, ende jo të gjithë kanë filluar punën. Si rrjedhojë, vetëm 39 persona u integruan.¹⁴⁴ Të gjitha lokacionet ku ka shërbyer MUP-i i Serbisë në veri janë mbyllur, përfshirë depot. Uniformat, armët dhe pajisjet janë kthyer në Serbi përmes një procesi të bashkërenduar nga EULEX-i.

Gjithashtu në fund të vitit 2013, Serbia ka marrë vendim për ndërprerjen e kontratave të punës dhe pagave duke dërguar të gjithë zyrtarët e MUP-it që vepron në Kosovë në pension të detyruar.¹⁴⁵

Përbërja e PK-së, sipas marrëveshjes duhet të reflektojë përbërjen etnike të popullatës që jeton në katër komunat veriore. Përveç Komandantit Rajonal të Policisë për katër komunat veriore me shumicë serbe, u krijua edhe një strukturë rajonale për katër komunat tjera në jug të lumit Ibër, Mitrovicën e Jugut, Skënderajt dhe Vushtrrisë. Implementimi i kësaj marrëveshje kërkoi rishikimin e Strukturës Organizative të Policisë së Kosovës, përfshirë krijimin e Drejtorisë Rajonale të Veriut dhe procedurat e emërimit të Drejtorit Rajonal.¹⁴⁶

Edhe pse nuk ishte nodnjë arranzhim i veçantë, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës ka arritur të funksionalizojë edhe Inspektoratin Policor në veri. Inspektorati Policor i Kosovës është një ndër institucionet e rralla të Republikës së Kosovës që funksionon në Mitrovicën e Veriut

Ky institucion ka për qëllim hetimin e shkeljeve brenda strukturës së Policisë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës. Pra, është mekanizëm që funksionon nën autoritetin e MPB-së, megjithatë si strukturë është e ndarë nga PK-ja dhe vepron në mënyrë të pavarur prej saj.¹⁴⁷ Kjo zyrë u hap më 30 dhjetor 2015, në mënyrë që banorët e katër komunave të Mitrovicës së Veriut të kenë një vend në të cilin do të mund t'i drejtojnë ankesat e tyre.¹⁴⁸ Në këtë zyrë punojnë dy hetues, një qytetarë i komunitetit serb dhe një shqiptarë. Mund të thuhet se IPK-ja nuk është edhe aq transparente në raport me mediat dhe shoqërinë civile kur bëhet fjalë për ofrimin e informacionit meqë zakonisht ofrojnë informacione të mangëta për punën që bëjnë, posaçërisht në komunat e Mitrovicës së Veriut.

Duke u bazuar në raportet vjetore të IPK-së, në vitin 2017, janë pranuar gjithsej 57 ankesa nga banorët dhe janë hetuar 7 punonjës policorë.¹⁴⁹ Në vitin 2018, përsëri janë pranuar 57 ankesa nga banorët dhe janë hetuar 14 punonjës policorë.¹⁵⁰ Ndërsa në vitin 2019, janë pranuar 55 ankesa dhe janë hetuar 14 punonjës policorë.¹⁵¹ Në vitin 2017, në regjionin e Mitrovicës së Veriut, janë shënuar gjithësej 80 vepra penale dhe në vitin 2018, janë shënuar 61 vepra penale.¹⁵²

¹⁴⁴ Kjo është konfirmuar nga përfaqësues të sindikatës të personelit administrativ të ish-punonjësve të MUP-it, se tre (3) persona kanë dalë në pension dhe tre (3) persona kanë refuzuar të integrohen në institucionet e Kosovës. Ministria e Dialogut e Kosovës, *Raport mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit: 16 qershor – 25 nëntor 2016*, 25 nëntor 2016.

¹⁴⁵ “Uredba o uslovima za ostvarivanje prava na posebnu penziju zaposlenih u Ministarstvu unutrašnjih poslova na teritoriji AP Kosovo i Metohija: 115/2013-23, 42/2014-9” [“Dekret për kushtet e ushtrimit të së drejtës për pension të veçantë për punonjësit e Ministrisë së Brendshme në territorin e Provincës Autonome të Kosovës dhe Metohisë: 115 / 2013-23, 42 / 2014-9”], në <https://www.pravno-informacioni-sistem.rs/SlGlasnikPortal/reg/viewAct/4642dec9-6337-451d-8ac9-2442d0ea8f9b>

¹⁴⁶ Udhëzim Administrativ Nr. 12/ 2013 nga Ministria e Punëve të Brendshme për zgjedhjen e Drejtorit Rajonal të Policisë për rajonin Mitrovicë-Veri, në https://mpb.rks-gov.net/Documents/UDHEZIMI_ADMINISTRATIV_Nr._12-2013_-_MPB_PER_ZGJEDHJEN_E_DREJTORIT_RAJONAL_TE_POLICISE_PER_RAJONIN_MITROVICE-VERI.pdf

¹⁴⁷ Për më shumë rreth misionit të Inspektoriatit Policor të Kosovës lexo <https://ipk.rks-gov.net/rreth-nesh/misioni-dhe-vizioni/>

¹⁴⁸ Shih Komunikatën për Media nga IPK “Fillon punën zyra e IPK-së në Mitrovicën e Veriut”, 30 dhjetor 2015, në <https://ipk.rks-gov.net/fillon-punen-zyra-e-ipk-se-ne-mitrovicen-e-veriut/>

¹⁴⁹ Shih Raportin vjetor të IPK-së për vitin 2017, në <https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/02/Raporti-vjetor-2017-IPK.pdf>

¹⁵⁰ Ibid.

¹⁵¹ Ibid.

¹⁵² Shih *Raportin e Inspektimit mbi Menagjimin e Hetimit dhe Zbulimit të Krimit, si dhe Administrimit të Rasteve*, dhjetor 2019, në <https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/01/RAPORTI-I-INSPEKTIMIT-NR.-06-2019-MENAXHIMI-I-HETIMIT-DHE-ZBULIMIT-T%C3%8B-KRIMIT-SI-DHE-ADMINISTRIMI-I-RASTEVE.pdf>

Declaration prior to integration

I, the undersigned,
hereby declare that I am willing to transfer to the Kosovo institution and be employed by the Kosovo institution (employer).

I confirm that I understand the Kosovo legal framework will apply to my employment with the employer, and that I will be bound by such. In particular, the Law on the Civil Service will govern my employment and I will be bound by its provisions.

I confirm that I have read the First Agreement and the Article 5 of the Law on the Civil Service concerning Conflicts of Interest, and declare that I agree to work exclusively for the Kosovo institution.

I declare that I will not accept any salary or other compensation from any other source than the employer in relation to my duties.

I confirm that I am willing to participate in the training modules set up by the employer to enhance my performance and to contribute to my integration.

I accept that the employer, with assistance and supervision of EULEX will perform background checks to verify information provided by myself and I am aware that my current employer will provide information to my education and professional experience. Furthermore I declare that I have no objections to exchange relevant personal data.

I understand that an employment contract with my employer will be signed following the agreed conclusions concerning the integration process.

I understand that any false information provided in this document, will result in my integration into the Kosovo institution being canceled.

Place and Date:

Signed:

Name:

Address:

DREJTËSIA

NGA PARIMET PËR NORMALIZIM

10. Autoritetet gjyqësore do të integrohen e të veprojnë brenda kornizës ligjore të Kosovës. Gjykata e Apelit në Prishtinë themelon panel me shumicë serbë të Kosovës për të gjykuar rastet e komunave me shumicë serbe. Një divizion i kësaj Gjykate vendoset në veri të Mitrovicës

Që nga shpallja e pavarësisë, Kosova me ngulm kishte kërkuar largimin e institucioneve paralele të sigurisë të cilat financoheshin dhe operonin sipas ligjeve të Serbisë. Kjo ishte bërë edhe pikënisja dhe qëllimi i dialogut.¹⁵³ Bazuar në Marrëveshjen e Parë të Parimeve për Normalizim të Marrëdhënieve, Marrëveshja për Gjyqësorin u arrit më 9 shkurt 2015, mirëpo implementimi ka hasur në shumë vështirësi, në veçanti në integrimin e gjykatësve dhe prokurorëve.

Marrëveshja përcakton se Objekti i Gjykatës Themelore në Mitrovicën e veriut do të përbëhet nga:

- *Njësitë i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë*, me 5 gjyqtarë serbë dhe 2 shqiptarë; dhe
- *Departamenti për krime serioze*, me 4 gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 4 shqiptarë.

Sipas marrëveshjes, u krijua edhe një Gjykatë Themelore dhe një Zyre e Prokurorisë Themelore për rajonin e Mitrovicës që përfshinë katër komunat veriore dhe komunat me shumicë shqiptare dhe më të populluara sic janë ajo e Skenderajt dhe Vushtrrisë, ashtu siç definohet në Ligjin për Gjykatata të Republikës së Kosovës.¹⁵⁴ Gjykata e vetme themelore për rajonin e Mitrovicës do t'a ketë një objekt në komunën veriore dhe një objekt në jugun e Mitrovicës, dhe katër degë të gjykatës: në Zubin Potok, Leposaviq, Skenderaj dhe Vushtrri.

Gjykata themelore në Mitrovicën e Veriut do të ketë edhe Departamentin e Përgjithshëm që trajton të gjitha veprat penale për Mitrovicën e Veriut, Mitrovicën e Jugut dhe Zveçanin. Objekti i gjykatës në Mitrovicën e Jugut do të ketë Departamentin për të Miturit për të gjithë rajonin. Ajo do të gjykojë çështjet civile, deklaratimet e pakontestuar dhe veprat penale të të miturve për Mitrovicën e veriut, Mitrovicën e jugut dhe Zveçanin.

Ujdia mundësoi vendosjen e një sistemi unitar të drejtësisë në tërë territorin e Kosovës dhe integrimin e gjykatësve, prokurorëve dhe punonjësve administrativ të komunitetit serb në institucionet e saj të drejtësisë. Ngjashëm si me policinë, një pjesë e konsiderueshme e gjykatësve dhe prokurorëve të integruar, kishin punuar në sistemin e Kosovës para vitit 2008, ashtu si edhe para vitit 1989. Disa prej tyre po ktheheshin të punonin me kolegët e tyre të vjetër.¹⁵⁵

Sipas marrëveshjes përkatësia e gjykatësve dhe prokurorëve e administratës do të dukej si në tabelën më poshtë. Kjo tabelë në dispozicion për Grupin për Ballkan, është pjesë e marrëveshjes mirëpo asnjëherë nuk është bërë publike nga Qeveria e Kosovës.

¹⁵³ “Bëhemi të qartë që Gjermania e ka pranuar Kosovën ndërsa Serbia jo. Është kjo situatë në të cilën nevojitet përparim – rezultate në dialogun e drejtpërdrejt, në punën e EULEX-it dhe zhbërjen e strukturave paralele”, tha Merkel. Shih transkriptin e konferencës për shtyp Tadiq-Merkel, në <https://www.bundeskanzlerin.de/ContentArchiv/DE/Archiv17/Mitschrift/Pressekonferenzen/2011/08/2011-08-23-pk-merkel-tadic.html>.

¹⁵⁴ Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat, 24 gusht 2018

¹⁵⁵ Beogradi e ka pranuar iniciativën e UNMIK-ut që gjykatësit e kësaj të fundit të fillojnë punën në Mitrovicën e veriut. Iniciativa po ashtu do të duhej të krijonte hapësirë për rifillimin e punës së gjykatësve vendorë, përkrah homologëve të tyre ndërkombëtarë. Shih Raportin e Grupit Ndërkombëtar të Krizave, *Tranzicioni i brishtë në Kosovë*, 5 shtator 2008, fq. i.

Tabela për integrimin e gjykatësve, prokurorëve dhe stafin administrativ sipas marrëveshjes						
	Gjykatësit		Prokurorët		Personeli	
	Shqiptarë	Serb	Shqiptarë	Serb	Shqiptarë	Serb
Gjykata Themelore e Mitrovicës (Objekti në Veri)	10	14			26	54
Gjykata Themelore e Mitrovicës (Objekti në Jug)	14	11			54	26
Departamenti për Krimet Serioze	4	4				
Departamenti i Përgjithshëm	4	5				
Divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut	2	5				
Dega në Leposaviq		2				7
Dega në Zubin Potok		2				7
Prokuroria Themelore në Mitrovicë			9	9	24	24

Në vitin , Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) rekrutuan 34 gjyqtarë dhe 9 prokurorë të komunitetit serb. Vala e dytë e rekrutimit u zhvillua në vitin 2016. Të gjithë kandidatët kaluan edhe provimin e jurisprudencës. Ky proces i mbështetur edhe nga EULEX-i përfundoi me dekretimin e 40 gjykatësve dhe 13 prokurorëve me përkatësi të komunitetit serb në tetor të vitit 2017. Gjykata dhe Prokuroria filluan punën në vitin 2018 dhe kanë të punësuar gjithësej 149 anëtarë të stafit administrativ prej të cilëve 115 u integruan në gjykatat e reja dhe 34 në kuadër të Prokurorisë.¹⁵⁶

Në tetor 2017, u dekretuan 40 gjykatës dhe 13 prokurorë serbë, të cilët filluan punën pas tri ditësh në pjesën veriore të Kosovës.¹⁵⁷ Një muaj më pas u bë zhvendosja e Gjykatës Themelore të Mitrovicës në objektin e ri në pjesën veriore.

Në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, janë të punësuar gjithësej 30 gjykatës, 18 prej të cilëve janë të komunitetit serb dhe 12 shqiptarë. Në total janë të punësuar 149 staf ndihmës, 75 prej të cilëve janë shqiptarë dhe 72 nga komuniteti serb. Tabela në vijim shfaq numrin e gjykatësve, prokurorëve dhe stafit të tyre administrativ të angazhuar me punë, të ndarë sipas degëve dhe departamenteve. Duhet të merret parasysh se një pjesë e të dhënave të mëposhtme janë të bazuara në kalkulimet e bëra sipas figurimeve në uebfaqen e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe raportet e tyre statistikore.

¹⁵⁶ Ministria e Dialogut e Kosovës, *Raport mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit: 16 qershor – 25 nëntor 2016*, 25 nëntor 2016.

¹⁵⁷ Radio Evropa e Lirë, "Gjyqësori në veri i gatshëm të gjykojë me ligjet e Kosovës", 9 nëntor 2017, në <https://www.evropaelire.org/a/gjyqesori-ne-veri-i-gatshem-te-gjykoje-me-ligjet-e-kosoves-/28844872.html>

Numri i të integruarëve (gjykatësve, prokurorëve dhe stafit administrativ) në punë						
	Gjykatësit		Prokurorët		Personeli	
	Shqiptarë	Serb	Shqiptarë	Serb	Shqiptarë	Serb
Gjykata Themelore e Mitrovicës (Objekti në Veri)	4	11			24	48
Gjykata Themelore e Mitrovicës (Objekti në Jug)	14	11			54	24
Departamenti për Krimet Serioze	4	4				
Departamenti i Përgjithshëm	4	5				
Divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut	2	5				
Dega në Skënderaj	5				32	
Dega në Vushtrri	5				25	
Dega në Leposaviq		2				25
Dega në Zubin Potok		2			2	27
Prokuroria Themelore në Mitrovicë			11	11	33	32

Marrë nga Raporti Statistikor i tremujorit të tretë të Punës së Gjykatës Themelore të Mitrovicës për vitin 2019 / Intervistë e drejtëpërdrejtë e Grupit për Ballkan me Zyrën e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës

Me integrimin e gjykatësve dhe prokurorëve dhe krijimin e gjykatave, numri i pranimit të lëndëve ka shënuar rritje. Poashtu edhe zgjidhja e tyre ka marrë hov.¹⁵⁸ Tabela në vijim shfaqë numrin e saktë të lëndëve të pranuar në dy degët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës.

GJYKATA THEMELORE NË VERI TË MITROVICËS							
Gjykata Themelore e Mitrovicës, Dega Leposaviq				Gjykata Themelore e Mitrovicës, Dega Zubin Potok			
2018		2019		2018		2019	
pranuara	zgjidhura	pranuara	zgjidhura	pranuara	zgjidhura	Pranuara	zgjidhura
767	304	965	373	434	322	514	222
290 të rënda, 14 të lehta		350 të rënda, 23 të lehta		322 të rënda, 0 të lehta		208 të rënda, 14 të lehta	

Serbia duhet gjithashtu t'i shpërbëjë strukturat paralele të drejtësisë në Kosovë, të cilat de facto kanë pushuar së funksionuari në vitin 2013. Për këtë qëllim, kërkohet që Serbia të bëjë ndryshime ligjore në Ligjin mbi

¹⁵⁸ Shih Raportin Vjetor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Statistikor për vitin 2019, Prishtinë, në https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/37650_Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2019_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf

Selitë dhe Juridiksionet Territoriale të Gjykatave dhe Zyrave të Prokurorëve.¹⁵⁹

Sipas vendimit të Gjykatës së Apelit në Nish të datës 5 mars 2018, është bërë i pamundur ndryshimi i Ligjit por lëndët e ish-gjykatave serbe në territorin e Kosovës dhe se ato janë transferuar përkohshësisht nën juridiksionin e gjykatave të Leskovcit, me qëllim që të njejtat të zgjidhen.¹⁶⁰ Aty thuhet se “*juridiksioni duhet të transferohet në ndonjë gjykatë funksionale në sistemin e drejtësisë në Serbi, me qëllim që të mbrohen të drejtat e qytetarëve, posaqërisht të drejtat e pronësisë, trashëgimisë, punës, martesave, etj.*”

Përpos rasteve të ekzekuzimit të sanksioneve kriminale, rastet kriminale të ish-gjykatave serbe në nuk do të jenë të përfshira në këtë transfer. Rastet e transferuara në Gjykatën e Lartë në Leskovc janë zgjidhur nga ish-udhëheqësit e gjykatës në Mitrovicë. Gjithashtu, aty ceket se arkivat do të mbesin në rajonin e Mitrovicës, përderisa depoziti dhe inventari transferohen në gjykatat në Leskovc.¹⁶¹

EULEX-i i ka ofruar asistencë të drejtpërdrejtë procesit të dialogut për drejtësi duke marrë pjesë si anëtar i paneleve për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për stafin mbështetës në të dyja instancat. Përveç kësaj, EULEX ka ofruar edhe një rol këshillues dhe lehtësues për institucionet vendore. Për më tepër, Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian PSBE, EULEX-i dhe USAID-i kanë mbështetur funksionalizimin dhe renovimin e ndërtesës së Gjykatës Themelore.

Si përfundim, për më se dy vite, institucionet e drejtësisë kanë filluar të funksionojnë relativisht mirë në pjesën veriore.¹⁶² Çështjet teknike, si mungesa e përkthimit profesional ose edhe e stafit, vazhdojnë të pengojnë punën e plotë të gjykatave. Edhe qytetarët mendojnë se ka përfitime nga integrimi i autoriteteve gjyqësore pasi që përmes përfshirjes dhe bashkëpunimit do të zvogëlohet numri i krimeve dhe veprave penale e me këtë rritet edhe siguria për të gjithë.¹⁶³



Gjykata në Mitrovicën veriore

¹⁵⁹ Zakon o Sedištima i Područjima Sudova i Javnih Tužilaštava, broj 116/08, [“Ligjin Nr. 116/2008 mbi Selitë dhe Juridiksionet Territoriale të Gjykatave dhe Zyrave të Prokurorëve”], në https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_sedistima_i_podrucjima_sudova_i_javnih_tuzilastava.html

¹⁶⁰ Vendim për transfer të përkohshëm të juridiksionit Su I-1-23/18, Gjykata e Apelit në Nish, 16 prill, 2018.

¹⁶¹ Ministria e Drejtësisë e Serbisë implementoi transferin e regjistrimit elektronik në gjykatat në Leskovc. Këtu përfshihen më shumë se 5000 çështje ekzekutive (për zbatim) dhe 1000 konteste gjyqësore. Secili gjyqtar në gjykatën e Leskovcit u ngarkua me mbi 300 raste nga Mitrovica. Artikulli 223, Paragrafi 2 i Ligjit për Procedurat Civile ku thuhet se rasti mund të suspendohet nëse “*pala është e vendosur në rajon ku gjykata nuk ka qasje, për shkak të kushteve të jashtëzakonshme*” pritej të bëhet referencë e shpeshtë. Tjetër problem ishte përfaqësimi i avokatëve nga Mitrovica, të cilët formalisht janë anëtarë të Odës Ekonomike të Kosovës. Shih Raportin nga YUCOM, *Integration of Judiciary in the context of Belgrade-Prishtina dialogue and EU accession proces* [“Integrimi i Gjyqësorit në kontekstin e dialogut Beograd-Prishtinë dhe procession e integritimit në BE”, maj 2019, në <http://en.yucom.org.rs/wp-content/uploads/2019/05/Integracija-pravosudja-ENG-za-sajt-1-1.pdf>

¹⁶² Editorial i shkruar nga një Prokurorë në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, Nataša Radović për Grupin për Ballkan “Përshtypjet e mia për integrimin i institucioneve të drejtësisë në Mitrovicë”, 8 nëntor 2019, në <https://balkangroup.org/blog/post/articles/my-impressions-integration-judiciary-mitrovica>

¹⁶³ Ibid.

SHUARJA DHE INTEGRIMI I “MBROJTJES CIVILE”

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Beogradi dorëzoi një listë prej 751 anëtarëve të MC-së për t'u integruar.

Prishtina ofroi 483 pozita për veri, ku ata marrin paga por vendet e punës do të përcaktohen në sektorin publik brenda 3 viteve.

Beogradi i ka dorëzuar BE-së një listë të lokacioneve dhe “pikave të vëzhgimit” nën udhëheqjen e anëtarëve të MC-së.

Secila “pikë vëzhgimi”, përfshirë pajisjet teknike dhe qendrën e situatave, do të largohet apo dorëzohet te PK-ja.

Beogradi do të ofroj pajisjet e MC-së tek BE-ja. Prishtina vendos nëse ato përdoren nga institucionet e Kosovës në veri, e pajisjet e mbetura do të transferohen tek pala e Beogradit, që do të verifikohen nga PK-ja dhe EULEX-i.

Më 24 prill 2015 Beogradi do të njoftoj në formë të shkruar BE-në se MC-ja në Kosovë më nuk do të ekzistojë përbrenda sistemit të Serbisë, nga 1 shtatori 2015.

Marrëveshja për shuarjen e “Mbrotjtjes Civile” u arrit më 26 mars 2015.

Zbatimi i kësaj marrëveshje është zhvilluar në tri drejtime:

1. Shuarja e mbrotjtjes civile;
2. Integrimi i ish-pjesëtarëve të saj në institucionet qendrore civile të Kosovës, dhe
3. Abrogimi ligjor i veprimtarisë së saj dhe ndalja e pagave të tyre nga ana e Serbisë.

E paraqitur si organizatë për reagim emergjent, “Mbrotjtja Civile” ka funksionuar si strukturë paramilitare në pjesën veriore në mënyrë të organizuar, ku në posedim ka pasur zyra, depo, pika vrojtuese, sisteme alarmimi dhe pajisje tjera të sigurisë. Për një kohë, ata kanë vepruar në mënyrë të fshehtë dhe ekzistimi i tyre është mohuar. Pas shpërbërjes së strukturave të policisë së Serbisë në Kosovë, pala e Kosovës kishte kërkuar në

vazhdimësi që edhe kjo strukturë të shpërbëhet.¹⁶⁴ Marrëveshja mundësoi që të integrohen 479 prej tyre, nga 735 sa ishte numri tek lista e pjesëtarëve të kësaj strukture e dorëzuar nga pala serbe.¹⁶⁵ Edhe për integrimin e tyre, është përdorë logjika e njejtë si për integrimin e pjesëtarëve të policisë ku fillimisht është bërë verifikimi i të kaluarës së tyre nga institucionet e sigurisë së Kosovës. Një numër i tyre nuk e ka kaluar këtë fazë, e ka pasur të tillë që nuk kanë qenë fare shtetas të Kosovës dhe se atyre nuk iu është mundësuar integrimi.¹⁶⁶ Një pjesë ka kërkuar pensionim të parakohshëm, ndërsa një pjesë ka refuzuar ta nënshkruajë *Deklaratën e para-integrimit në institucionet e Kosovës*.

Qeveria e Kosovës ishte zotuar se do t'i integronte këta pjesëtarë në institucionet e saj dhe si rezultat nga korriku 2015, shpërndarja e tyre është bërë sipas tabelës vijuese.¹⁶⁷

¹⁶⁴ DW, “Civilna Zastita’ në Veri shpërbëhet deri më 1 shtator”, 3 prill 2015, në <https://www.dw.com/sq/civilna-zastita-n%C3%AB-veri-shp%C3%ABrb%C3%ABhet-deri-m%C3%AB-1-shtator/a-18360103>

¹⁶⁵ Ministria e Dialogut e Kosovës, *Raport mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit: 1 tetor 2014 – 20 mars 2015*, 23 mars 2015, në https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Raport_mbi_Zbatimin_e_Marreveshjeve_te_Brukselit_23_mars_2015-signed.pdf

¹⁶⁶ Procesi i integrimit, në http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Agreement_on_CP_-_initialled_by_Kosovo_260315.pdf

¹⁶⁷ Ministria e Dialogut e Kosovës, *Raport mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit: 1 janar – 15 qershor 2016*, 15 qershor 2016, fq. 14, në https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/RAPORT_MBI_ZBATIMIN_E_MARREVESHJEVE_TE_BRUKSELIT_15_qershor_2016-signed.pdf

24 INSTITUCIONE	479 PERSONA
Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave	80
Shërbimi Korrektues i Kosovës	25
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	30
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	32
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	32
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	8
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë	8
Agjencia e Pyjeve	20
Administrata Tatimore e Kosovës	15
Ministria e Shëndetësisë	22
Ministria e Infrastrukturës	32
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	22
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	26
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	14
Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	7
Agjencia e Statistikave të Kosovës	10
Agjencia Shtetërore e Arkivave	9
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	6
Dogana e Kosovës	22
Ministria e Administratës Publike	13
Ministria për Komunitete dhe Kthim	17
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	18
Agjencia Kadastrale e Kosovës	6
Ministria e Financave	5



Largimi i pikës vrojtuese të Mbrojtjes Civile në Mitrovicën veriore

Të integruarit i janë nënshtruar një programi trajnimesh me tre module:

1. Moduli i parë ka pasur të bëjë me njohjen me administratën publike të Kosovës, funksionimin demokratik, shërbimet publike, që do të ndihmojnë në re-integrimin e këtyre personave në administratën publike.
2. Moduli i dytë ka ofruar njohjen e hollësishme të bazës ligjore për punën e tyre duke përfshirë Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore.
3. Moduli i tretë ka përfshirë trajnime profesionale, që do të thotë njohje me institucionin dhe punën ku personat janë të angazhuar. Ky modul udhëhiqej nga përfaqësuesit e institucioneve përkatëse ku ata janë integruar.¹⁶⁸

Paralelisht, janë mbyllur pikat vrojtuese që janë përdorur nga kjo strukturë, bashkë me zyrat dhe depot e tyre. Uniformat dhe pajisjet janë dërguar në Serbi nën mbikëqyrjen e EULEX-it.

Qeveria e Kosovës ka qenë në proces të hapjes së zyrave në komunat veriore, por në objektin e identifikuar në komunën veriore të Mitrovicës, gjatë funksionalizimit të saj, është hedhur një mjet shpërthyes, me ç'rast procesi i hapjes së zyreve është ndalë (përveç Agjencisë së Emergjencave, Shërbimit Korrektues, Doganës dhe AVUK-ut).

Procesi i integritimit ka ngecur për shkak të rënjes së njëpasnjëshme të qeverive me ç'rast qeveritë pasuese kanë hezituuar të merren me këtë proces. Zyra Kombëtare e Auditimit ka ngritur vërejtje se këta persona që kanë kontrata pune me Qeverinë e Kosovës, nuk lajmërohen rregullisht në vendin e punës.¹⁶⁹ Kjo çështje duhet të trajtohet me urgjencë, në të kundërtën ekziston rreziku që ministrinë dhe agjencitë e Kosovës që i kanë integruar këta persona të shkëpusin kontratat me një pjesë të tyre. Një opsion mbetet edhe sistematizimi i tyre në vende pune në insitucione e lokacione të tjera si në Prishtinë, etj.

¹⁶⁸ Ministria e Dialogut e Kosovës, *Raport mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit: 16 qershor – 25 nëntor 2016*, 25 nëntor 2016.

¹⁶⁹ Zëri, "40 nëpunës i kanë marrë rreth 200 mijë euro pa punuar asnjë ditë në ministrinë tona", 13 qershor 2019, në <https://zeri.info/ekonomia/267110/40-nepunes-i-kanë-marrë-rreth-200-mijë-euro-pa-punuar-asnjë-dite-ne-ministrinë-tona/>

NJOHJA RECIPROKE E POLISAVE TË SIGURIMIT

PIKAT KRYESORE TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT

Njohja dhe pranimi reciprok i Auto-përgjegjësisë së Palës së Tretë (TPL) valide

Procesim i pagesave dhe i dëmeve të shkaktuara nga automjetet e siguruar nën juridiksionin e secilës palë.

Implementimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit duhet të bëhet nën juridiksionin e secilës palë.



Më 23 qershor 2015, me lehtësimin e Këshillit të Byrove të Kartonit të Gjelbërt (KB), Memorandumi i Mirëkuptimit për njohjen reciproke të poliave të sigurimit u nënshkrua ndërmjet Shoqatës së Siguruesve Serbë (SHSS), ("Udruženje osiguravača Srbije", UOS) dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), si entitete të autorizuara përgjegjëse për çështjet e sigurimit të automjeteve.¹⁷⁰ Ky memorandum u arrit në frymën e marrëveshjes së Brukselit nga data 19 prill 2013. Nënshkrimi u bë në prani të dy Kryeministrave, atij të Kosovës dhe Serbisë, dhe të përfaqësuesve të BE-së, ku ata u pajtuan për njohjen reciproke dhe pranimin e

Autopërgjegjësisë së Palës së Tretë (TPL) valide si edhe për procedimin dhe pagesën e dëmeve të shkaktuara nga automjetet me mbulim të vlefshëm në juridiksionin e secilit shtet.¹⁷¹

Kjo marrëveshje është duke u zbatuar dhe nuk janë raportuar shkelje të mëdha nga asnjëra palë.

Me nënshkrimin e Memorandumi të Mirëkuptimit në lidhje me sigurimin e automjeteve, janë ulur shpenzimet dhe është thjeshtësuar kalimi në vendkalimet e integruara të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë.

¹⁷⁰ Memorandumi i Mirëkuptimit në http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Signed_MoU_Border_Vehicle_Insurance.pdf

¹⁷¹ 'Sigurimi TPL plus do të kushtojë 40 euro për një vit. Sipas kësaj marrëveshje, automjetet me tabela RKS do të mund të udhëtojnë në Serbi, por vetëm duke i zëvendësuar ato me tabela Prova.' Shih Koha, "Sot në kufirin Kosovë- Serbi me policat reciproke", 12 gusht 2015, në <https://archive.koha.net/?id=1&l=70329>

Përmes njohjes reciproke të policave të sigurimit në mes të byrove të sigurimit të Serbisë dhe Kosovës, kësaj të fundit do të duhej t'i hapet rrugë për anëtarësim në Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjelbër, nëse plotësohen edhe kushtet tjera.¹⁷² Kosova ende ka në qarkullim një numër shumë të madh të veturave të pa-siguruar. Mendohet se afër 150 mijë vetura të pasiguruar qarkullojnë në rrugët e Kosovës.¹⁷³

Tutje, nga Këshilli i Byrove ishte kërkuar që Kosova t'i plotësoj parakushtet për fillimin e procedurave të aplikimit për anëtarësim në kartonin e gjelbër. Në mesin e tyre, ndër më kryesoret ishin: miratimi i Ligjit për Sigurime të Detyrueshme nga Autopërgjegjësia, themelimi i Byrosë Kosovare të Sigurimeve dhe të Qendrës Informativë të Sigurimeve si edhe themelimi i Fondit Garantues, në shumë prej 4 Mil. Euro.¹⁷⁴ Këto parakushte janë plotësuar dhe Byroja Kosovare e Sigurimit e ka dorëzuar aplikacionin për anëtarësim në Këshillin e Byrove në vitin 2011.¹⁷⁵

Por, mos-anëtarësimi në OKB është barrierë kryesore në anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Byrove në Bruksel, duke pasqyruar se kërkesa për anëtarësim në Këshillin e Byrove duhet të dorëzohet nga një vend anëtar i Kombeve të Bashkuara.¹⁷⁶

Plotësimi i të gjitha kriterëve për pranim mbetet ende një proces që kërkon plotësimin e kushteve që Kosova ende nuk i arrin. Përveç anëtarësimin të Kosovës në OKB, Byroja Kosovare duhet të ketë kompetencë mbi të paktën territorin e shtetit ashtu siç njihet nga Kombet e Bashkuara dhe që është nën kontrollin de facto të shtetit. Pra në këtë kontekst, duhet që edhe në komunat veriore të mos qarkullojnë vetura të pa regjistruara përkatësisht të pasiguruar

Një kriter tjetër është që shteti ta ketë të ratifikuar Konventën e Vjenës për Trafikun Rrugor atë për Shenjat dhe Sinjalet Rrugore të 8 nëntorit 1968. Poashtu pasi që Kosova të pranohet si anëtare e cila vepron në cilësinë e një Byroje Kombëtare, ajo fillimisht do të duhet të ketë statusin e një anëtari tranzicional për një periudhë dhjetë vjeçare. Gjatë periudhës së anëtarësimin tranzicional, anëtari me këtë status mund të lëshojë Karton të Gjelbër vetëm për automjetet e regjistruara në shtetin e tij. Për më tepër, çdo anëtar tranzicional duhet të sigurojë garanci financiare në përputhje me Kriteret e Garancive Financiare.¹⁷⁷

Kompanitë e huaja të sigurimit në BE dhe jashtë saj, e përjashtojnë Kosovën nga mbulesa e tyre e sigurimit, dhe si rrjedhojë, asnjë karton i gjelbër i cfarëdo shteti tjetër nuk vlen në Republikën e Kosovës, përveç atij të Republikës së Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë, shtete me të cilat Kosova ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit për njohje reciproke të poliës së sigurimit.¹⁷⁸ Për këtë arsye, qytetarët e vendeve të BE-së detyrohen të paguajnë polia të sigurimit kur hyjnë në territorin e Kosovës. Kjo më së shumti e prek diasporën e Kosovës e cila jeton në vendet e Evropës. Me arritjen e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Byrosë Kosovare në korrik të vitit 2020, Qeveria e Kosovës ka marrë përsipër mbulimin e plotë të primit të sigurimit kufitar për palët që janë subjekt i policës kufitare dhe që vijnë në Kosovë gjatë vitit 2020.¹⁷⁹

¹⁷² Sistemi i kartonit të gjelbër i mundëson qytetarëve të një shteti anëtar, që posedojnë kartonin e gjelbër, lirim nga pagesa e sigurimit të automjetit në kufi për të udhëtuar drejt territorit të një shteti tjetër anëtar.

¹⁷³ Radio Evropa e Lirë, "Mbi 148 mijë vetura të paregjistruara sfidojnë kartonin e gjelbër", 18 shkurt 2020, në <https://www.evropalire.org/a/vetura-regjistrim-kartoni-i-gjelber-/30440946.html>

¹⁷⁴ Intervistë e Grupit për Ballkan me zyrtar nga Byroja Kosovare e Sigurimit, Prishtinë, janar 2020

¹⁷⁵ Byroja Kosovare e Sigurimit është themeluar me 07.09.2011 nga 10 kompanitë e sigurimit të licencuara për të operuar në Republikën e Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-018 mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Ligji mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, në <https://www.bqk-kos.org/repository/docs/2011/Ligji%20per%20Sigurimin%20%28shqip%29.pdf>

¹⁷⁶ Specifikisht e përshkruar në Nenin 5, 1.1a të Nenit e Asociimit të Këshillit të Byrove (*Articles of Association of Council of Bureaux*).

¹⁷⁷ Për më shumë informacion lexo "Articles of association of Council of Bureaux" ["Artikujt e Asociacionit të Këshillit të Byrove"], në https://www.cobx.org/sites/default/files/cob_file_folder/2020-01-15-Articles-of-Association-EN.pdf

¹⁷⁸ Intervistë e Grupit për Ballkan, me zyrtar nga Byroja Kosovare e Sigurimit, Prishtinë, janar 2020.

¹⁷⁹ Ministria e Financave, "Nënshkruhet marrëveshja për mbulimin e primit të sigurimit kufitar për bashkatdhetarët dhe të huajt që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës", 29 korrik 2020, në <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=2,2,948>

NJOHJA RECIPROKE E CERTIFIKATAVE ADR

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Lëvizja e lirë e mallrave të rrezikshme, pa pengesa dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare / Evropiane

Pranimi i dokumentacionit në përputhje me konventën e ADR-së (certifikatat e shoferëve dhe automjeteve).

Me këtë marrëveshje nuk preken detyrimet ndërkombëtare të secilës palë

Një grup për zbatim do të formohet nga BE që të monitorojë implementimin.

Marrëveshja për njohjen e reciproke të certifikatave ADR u arrit më 19 prill 2016.¹⁸⁰ Përmes kësaj marrëveshje, Kosova dhe Serbia u angazhuan për lëvizjen e lirë të mallrave, përfshirë mallrat e rrezikshme, pa pengesa dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Para arritjes së kësaj marrëveshjeje, Kosova dhe Serbia nuk i kanë njohur certifikatat ADR të njëra tjetres sepse Kosova nuk është palë kontraktuese e traktatit të ADR-së.¹⁸¹ Prandaj, ndërmarrjet e Kosovës nuk u lejuan të transportojnë mallra të rrezikshëm në ose përmes territorit të Serbisë e cila e pengoi lëvizjen e mallrave dhe shkaktoi humbje të konsiderueshme financiare për kompanitë.¹⁸²

Materiale të rrezikshme konsiderohen eksplozivët, gazrat, lëngjet e ndezshme, materialet e ngurta të rrezikshme, substancat vet-reaktive dhe eksplozivët e ngurtë të pandjeshëm, substancat që vetëndizen spontanisht, substancat të cilat në kontakt me ujin lëshojnë gazra të ndezshëm, substanca oksiduese, peroksidet organike, helmet, substancat infektive, materialet radioaktive; substancat korrozive dhe substancat e tjera të rrezikshme.¹⁸³



¹⁸⁰ Marrëveshja e Brukselit për njohjen reciproke të Certifikatave ADR. Konkluzionet e kryesuesit të BE-së të datës 19 prill 2016.

¹⁸¹ Traktati i ADR-së ose zyrtarisht Marrëveshja Evropiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme Rrugore, i miratuar më 30 shtator 1957, është një traktat i Kombeve të Bashkuara që rregullon transportin e materialeve të rrezikshme. Deri më tani, 52 vende (përfshirë Serbinë) janë pjesë e këtij traktati. Megjithatë, Kosova nuk është pjesë e këtij traktati shih në: https://www.unece.org/trans/danger/publi/adr/adr_e.html

¹⁸² Shih "Ngarkesë toksike, transportim I sigurt – Efektet e zbatimit të Marrëveshjes mbi Certifikatat ADR", editorial i shkruar nga Lulzim Krasniqi për KSPAG, 16 gusht 2019, në: <http://k-s-pag.org/ngarkese-toksike-transportim-i-sigurt-efektet-e-zbatimit-te-marreshjes-mbi-certifikatat-adr/>

¹⁸³ Ligji për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, në https://www.mit-ks.net/repository/docs/L04183sh_32461390767811.pdf

MARRËVESHJET E PAZBATUARA

Nga marrëveshjet e arritura në mes të Kosovës e Serbisë, disa u implementuan kënaqshëm, disa pjesërisht, e disa nuk u vënë fare në zbatim. Mungesa e zbatimit të marrëveshjeve, acarimi i marrëdhënieve mes dy vendeve dhe zhvillimet brenda dy shteteve, ndikuan që disa nga marrëveshjet të mbeten të pa implementuara. Një prej tyre ishte edhe ajo për Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë - AKS. Kjo marrëveshje u bë shkas për zhvillimin e paprecedent të tensioneve brenda Kosovës por edhe në mes të dy qeverive si dhe uli skajshmërisht përkrahjen (sado e mangët që ishte) për dialogun, së paku në Kosovë.¹⁸⁴

¹⁸⁴ Grupi për Ballkan, *Asociacioni i Komunave Serbe: Kuptimi i pikëpamjeve kundërtënëse të shqiptarëve dhe serbëve*, janar 2017.

NJOHJA RECIPROKE E DIPLOMAVE UNIVERSITARE

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Në përputhje me praktikat evropiane, studentët të kenë qasje në programet arsimore dhe mundësi punësimi në tërë rajonin.

Të dy palët të zgjidhin çështjen përmes një trupi ose institucioni akademik ndërkombëtar.

Palët të kërkojnë nga EUA të bëjnë certifikimin

Zbatimi i marrëveshjes do të bëhet pas certifikimit nga EUA. Njohja do të ndahet në atë profesionale dhe akademike.

Kjo procedurë të zbatohet tek nivelet e arsimit: Bachelor, Master dhe PhD.

Në fund të vitit 2008, Qeveria e Republikës së Serbisë vendosi të njohë diplomat e Kosovës me vulë të UNMIK-ut, por jo ato me simbolin “Republika e Kosovës”, dhe atë vetëm për përdorim në tregun e punës, e jo edhe si diploma të vlefshme për vazhdimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Serbisë.¹⁸⁵ Prandaj kjo çështje mori vëmendjen qysh në fillim të procesit të dialogut, dhe me 2 korrik 2011, u arrit edhe Marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave universitare. Marrëveshja parashihte që “në përputhje me praktikat më të mira evropiane, studentët duhet të kenë qasje në programet arsimore dhe në mundësi punësimi në tërë rajonin”.¹⁸⁶

Zgjidhja do të arrihej me përfshirje të një mekanizmi ndërkombëtar apo institucioni akademik të palës së tretë. Asociacioni Evropian i Universiteteve (AEU) u ftua për të bërë certifikimin e diplomave që do të përdoren në shtetin tjetër, qoftë për vazhdim të edukimit, apo për punësim. Deri në fund të qershorit 2012, Asociacioni Evropian i Universiteteve, përkrahur nga organizata jo-qeveritare SPARK, njohu 74 diplomat e para nga Kosova, me qëllim të vazhdimit të studimit ose aplikimit për një vend pune në shërbimin publik në Serbi.¹⁸⁷ Ndërmjet 2012-2014, 408 aplikime për njohje u dorëzuan në Prishtinë dhe

25 në Beograd. Prej tyre, AEU ka certifikuar 374 diploma të lëshuara nga universitetet e Kosovës dhe 13 të lëshuara nga universitetet e Serbisë.¹⁸⁸

Më 19 Janar 2016, grupet e dialogut ranë dakord t'a ndajnë njohjen e diplomave në *profesionale* dhe *akademike*, që t'i përshtaten specifikave të tyre procedurale.¹⁸⁹ Në mars po të atij viti, grupet u pajtuan për *konkluzionet e përbashkëta operationale* për zbatim e kësaj marrëveshje.¹⁹⁰ Vetëm pas një muaji - në prill 2016, ata u pajtuan për një *Udhëzues të BE-së për njohjen reciproke të Diplomave* në bazë të marrëveshjes fillestare të vitit 2011.¹⁹¹ Të dy palët rikonfirmuan angazhimin e tyre për të zbatuar marrëveshjen për pranimin e ndërsjellët të diplomave profesionale dhe akademike.

Më 1 mars 2012, Qeveria e Kosovës e hapi një zyre në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe vendosi bashkëpunimin me SPARK-un. Në ndërkohë AEU filloi certifikimin e diplomave të lëshuara nga universitetet e Kosovës të verifikuara nga SPARK-u. Mandati i SPARK-ut skadoi në korrik 2014, ndërsa në 2016, ajo u rizgjodh përsëri nga Bashkimi Evropian të shërbej si partner implementues.

¹⁸⁵ Intervistë e Grupit për Ballkan me përfaqësuesin e Komisionit për Verifikimin e Diplomave, Prishtinë, janar 2020.

¹⁸⁶ Shih Konkluzat e Dakorduara. Pranimi i Diplomave Universitare, korrik 2011.

¹⁸⁷ Zyra për Kosovë dhe Metohi, *Progress Report on the Dialogue between Belgrade and Pristina*, [“Raporti i progresit për dialogun teknik mes Kosovës dhe Serbisë: tetor 2015 – prill 2016”] prill 2016, në <http://kim.gov.rs/doc/pregovaracki-proces/2.1%20Izvestaj%20okt-mart%202016%20EN.pdf>

¹⁸⁸ Council for Inclusive Governance, *Parlamentarët e Kosovës dhe Serbisë përkrahin njohjen e diplomave universitare*, qershor 2015

¹⁸⁹ Konkluzionet mbi njohjen reciproke të diplomave bazuar në marrëveshjen origjinale të vitit 2011

¹⁹⁰ Konkluzionet operacionale i grupit punues për Diplomat Bruksel, mars 2016.

¹⁹¹ Udhëzuesi i BE-së për njohjen reciproke të diplomave në bazë të marrëveshjes fillestare të vitit 2011, në https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Udhezuesi_i_BE-se.pdf

Numri i aplikimeve të pranura nga Kosova dhe Serbia për verifikimin e diplomave			
		Aplikimet nga Kosova	Aplikimet nga Serbia
Numri i përgjithshëm i aplikacioneve të dorëzuara tek AEU	433	408	25
Numri i aplikacioneve të aprovuara	387	374	13
Numri i aplikacioneve të refuzuara	46	30	12
Numri i përgjithshëm i certifikatave të lëshuara	375	362	13

Serbia fajësoi Kosovën për mos-implementimin e marrëveshjes pasi që Prishtina nuk e njeh “Universitetin e Prishtinës në Mitrovicë” i cili funksionon në kuadër të sistemit arsimor të Serbisë.¹⁹² Kosova nga ana tjetër u pajtua për njohjen e diplomave nga universitetet e akredituara, por jo të universiteteve që veprojnë në mënyrë të paligjshme dhe që përfaqësojnë institucione paralele, siç bën Universiteti i Mitrovicës së Veriut.¹⁹³

Nga ana tjetër, Qeveria e Kosovës e miratoi një rregullore të veçantë për të lehtësuar çertifikimin e diplomave për shtetasit e Republikës së Kosovës (kryesisht të komunitetit serb) që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut (UMV).¹⁹⁴ Me propozim të MASHT-it, në mars të vitit 2016, Qeveria e autorizoi OJQ-në Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI) për mbështetjen e punës së Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut.¹⁹⁵ Tabela në vijim e shfaq numrin e aplikimeve dhe verifikimeve të diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut deri me datë 31 janar 2020.¹⁹⁶

Aplikacionet e Pranura nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut	1703
Të Verifikuara Pozitive	1629
Të Verifikuara Negative	40
Të Pakompletuara	10
Në Proces të Shqyrtimit	24

¹⁹² Zyra për Kosovë dhe Metohi, *Progress Report on the Dialogue between Belgrade and Pristina*, [“Raporti i progresit për dialogun teknik mes Kosovës dhe Serbisë: tetor 2016 – prill 2017”], prill 2017, në <http://kim.gov.rs/doc/pregovaracki-proces/Izvestaj%20oktobar%20april%202017%20ENG.pdf>

¹⁹³ Ministria e Dialogut e Kosovës, *Raport mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit*, 18 qershor 2018.

¹⁹⁴ Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për Lëshimin e Certifikatave Shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, në [http://kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_\(QRK\)_-_NR_21-2015_PER_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_PER_LESHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTETASVE_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_TE_CILET_KANE_MARR.pdf](http://kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_(QRK)_-_NR_21-2015_PER_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_PER_LESHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTETASVE_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_TE_CILET_KANE_MARR.pdf)

¹⁹⁵ Intervistë e Grupit për Ballkan me përfaqësuesin e Komisionit për Verifikimin e Diplomave, Prishtinë, janar 2020.

¹⁹⁶ Ibid.

Në anën tjetër, dekreti i Qeverisë së Serbisë për zbatimin e kësaj marrëveshje nuk hyri asnjëherë në fuqi.¹⁹⁷ Kjo ndodhi për shkak se në vitin 2014, Gjykata Kushtetuese e Serbisë vendosi se dekreti i Qeverisë së Serbisë (referuar edhe si *Rregullore*) për metodën e veçantë të njohjes së dokumenteve të arsimit të lartë binte ndesh me Kushtetutën dhe ligjin.¹⁹⁸

Në Serbi, Qendra Kombëtare për Njohjen e Dokumenteve të Shkollave të Larta të Huaja (ENIC / NARIC) u ngarkua për verifikimin e diplomave të arsimit të lartë të lëshuara nga universitetet e Kosovë.¹⁹⁹ Por, njohja me qëllim të arsimimit të mëtejshëm mbeti në kompetencë të institucioneve

të pavarura të arsimit të lartë ose universiteteve në bashkëpunim me fakultetet. Deri më tani, vetëm një numër i vogël i diplomave të paraqitura tek autoritetet e Serbisë janë proceduar.

Marrëveshja për diplomat nuk u implementua. Si pasojë, qytetarët shqiptarë në Serbi (kryesisht të Luginës së Preshevës) të cilët kryejnë shkollimin në Kosovë, nuk mund të punësohen apo ta vazhdojnë shkollimin në Serbi. Gjendje më e mirë është në njohjen e diplomave të Serbisë në Kosovë, që iu bë kryesisht si ndihmesë serbëve të Kosovës për punësim në institucionet shtetërore, edhe pse numri i tyre është ende i vogël.

SHËNIMET KADASTRALE

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Me qëllim që të mbrohen të drejtat e njerëzve në pronë, palët do të angazhohen për të vendosur një kadastrë të besueshëm e të plotë në Kosovë.

PSBE-ja do të pranojë kopjet e skanuara të të gjitha origjinaleve para vitit 1999, dhe do t'i ofrojë Kosovës informata specifike.

Një grup teknik i ekspertëve përcakton cilat regjistra kadastralë janë të saktë.

Gjykata Supreme e Kosovës do të jetë instanca e dytë e këtij mekanizmi. Vendimet e saj do të shqyrtohen nga një panel i gjyqtarëve ndërkombëtarë që japin vlerësim final.

Agjencia Kosovare e Kadastrit do të implementojë vendimet finale duke implementuar ndryshimet e nevojshme në kadastrin e Kosovës.

¹⁹⁷ Ministria e Dialogut të Kosovës, *The Technical Dialogue: State of Play and Serbia's Failure in Fulfilling the EU Conditions*, ["Dialogu Teknik: Gjendja e lojërave dhe dështimi i Serbisë në përmbushjen e kushteve të BE-së"], 16 shkurt 2012, në https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/2._Kosova_Report_on_Technical_Dialogue_state_of_play_16022012.pdf

¹⁹⁸ "Uredba o posebnom načinu priznavanja visokoškolskih isprava i vrednovanja studijskih programa visokoškolskih ustanova sa teritorije Autonome pokrajine Kosovo i Metohija koje obavljaju delatnost u skladu sa Rezolucijom 1244 Saveta bezbednosti Ujedinjenih nacija: 125/2014-3, 16/2016-26 ["Dekret për mënyrën e veçantë të njohjes së dokumenteve të arsimit të lartë dhe vlerësimin e programeve të studimit të institucioneve të arsimit të lartë nga territori i Provincës Autonome të Kosovës dhe Metohisë që kryejnë veprimtari në përputhje me Rezolutën 1244 Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara: 125/2014-3, 16/2016-26, në <https://www.pravno-informacioni-sistem.rs/SlGlasnikPortal/eli/rep/sgrs/vlada/uredba/2014/125/1/reg> Për më shumë rreth dekretit lexo Ustavni Sud Republike Srbije, predmet IUo-225/2013, [Rasti Nr. IUo - 225/2013, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Serbisë, 2014], në http://www.ustavni.sud.rs/page/view/sr-Latn-CS/0-102006/saopstenje-sa-16-sednice-ustavnog-suda-odrzane-30-aprila-2014-godine-kojom-je-predsedavala-vesna-ilic-prelic-predsednica-ustavnog-suda?_qs=kosovo

¹⁹⁹ Obaveštenje, Ministarstvo prosvete, nauke i tehnološkog razvoja. [Njoftim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës], në <http://www.mpn.gov.rs/enicnaric-srbija>



Marrëveshja për dokumentacionin kadastral të cilin Serbia e kishte marrë nga Kosova në vitin 1999, u arrit më 2 shtator 2011. Qëllimi ishte që të kthehet dokumentacioni kadastral i Kosovës nga Serbia dhe të plotësohen të dhënat kadastrale të saj.

Të dy qeveritë kanë zvarritur në vazhdimësi zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Fillimisht, pala kosovare për disa vite e vonoi miratimin e ligjit për agjencinë e re teknike - *Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronave (AKKVP)*, e nga ana tjetër, një vendim i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë vendosi se Marrëveshja për Kadastrin nuk ishte në përputhje me Kushtetutën e saj.²⁰⁰

Në vitin 2016, Kosova e ka themeluar agjencinë e saj teknike përmes miratimit të ligjit ku *Agjencia e Pronës* është transformuar në *Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP)*.²⁰¹ Kjo Agjenci ka për qëllim t'i krahasojë dokumentet e skanuara me kadastrën e rikonstruktuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Serbia gjithashtu ka marrë fonde nga BE-ja përmes instrumentit IPA

për skanimin e dokumentacionit kadastral. Procesi i skanimit dhe indeksimit të regjistrave kadastral të zhvendosur nga Kosova tani është përfunduar.²⁰² Megjithatë, mbi 4 milionë dokumente kadastrale që priten të kthehen nga Serbia ende nuk i janë dorëzuar Kosovës, e cila duhet të bëhet përmes Përfaqësuesit Special të BE-së në Prishtinë, siç edhe e parasheh marrëveshja.²⁰³

Moszbatimi i kësaj marrëveshjeje nga Serbia dhe Kosova është dokumentuar edhe në Raportet e Progresit të BE-së për Serbinë dhe Kosovën për vitin 2019, ku thuhet: “Çështjet si kadastrat dhe njohja e diplomave universitare ende nuk janë zgjidhur ashtu si edhe licencimi i targave të automjeteve si element i lidhur me marrëveshjen për lirinë e lëvizjes.”²⁰⁴

Serbia kërkon që Prishtina së pari të anulojë të gjitha aktet dhe vendimet që rezultojnë nga i ashtuquajtimi *Ligji për Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës*, si dhe të gjitha veprimet e tjera ligjore bashkë me pasojat që rezultuan nga zbatimi i tij.

²⁰⁰ Konkluzionet e Akorduara. Shënimet kadastrale, shtator 2011

²⁰¹ Ligji për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, 3 nëntor 2016, në http://www.kpaonline.org/framworkPDFs/English/LAW_NO_05_L010_ON_KOSOVO_PROPERTY_COMPARISON_AND_VERIFICATON_AGENCY.pdf

²⁰² Answer given by Vice-President Mogherini on behalf of the European Commission [“Përgjigje nga Nënkrjetarja Mogherini në emër të Komisionit Evropian”], 22 gusht 2019, në https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/E-9-2019-002211-ASW_EN.html

²⁰³ Plani i Punës 2020, Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, janar 2020, fq. 8, në <http://www.kpcva.org/pdf/plani%20punes%202020.doc>

²⁰⁴ Komisioni Evropian, *Serbia 2019 Report* [“Raporti Serbia 2019”] 25 maj 2019, fq. 54 dhe *Kosovo 2019 Report* [“Raporti Kosovo 2019”] 29 maj 2019, fq. 54.

Vetëm atëherë, sipas Serbisë, mund të zbatohet Marrëveshja në mënyrën e rënë dakord.²⁰⁵

Në anën tjetër, në Kosovë pati hezitime të mëdha. Vet fakti që miratimi i ligjit për agjencinë teknike u vonua për tre vite tregon shumë, pasi që me ardhjen e këtyre dokumentacioneve sfidoheshin shumë vendime të marra pas vitit 1999, ku shumë prona publike ishin përvetësuar apo iu është ndërruar titullari, janë uzurpar apo transferuar. Pjesë e këtyre skemave ishin bërë grupe të ndryshme të interesit, grupe kriminale, por edhe kishin

involvuar institucionet qendore e lokale, përfshirë edhe gjykatat.²⁰⁶ Për faktin se elemente të politikës dhe bartës të institucioneve ishin përfshirë në këto skema masive të transferimit të pronave publike, sidomos në dhe rreth rajonit të Prishtinës, qeveritë e njëpasnjëshme ngurronin të procedonin dhe implementonin këtë marrëveshje. Sipas anëtarëve të delegacionit të Kosovës në procesin e dialogut si njohës të kësaj problematike, kjo marrëveshje edhe mund të mos implementohet kurrë nga ana e institucioneve të Kosovës.²⁰⁷

ENERGJIA

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Kosova lejon EPS-në të themelojë kompani tregtare për energji në Kosovë (ElektroServer)

EPS dorëzon dokumentet për aplikim në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë para fundit të Gushtit 2015

ElektroServer aplikon në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) për licencat e nevojshme

Licenca e furnizimit do të jetë operative kur KOSTT të bëhet anëtarë i ENTSO-E

Elektrosever nënshkruan marrëveshje me KOSTT që të merr pjesë në tregun e energjisë në Kosovë si palë përgjegjëse për balancim

Serbia dhe EMS mbështesin aplikimin e KOSTT për marrëveshje të lidhjes me ENTSO-E

Mohimi:

Kosova konsideron se... prona brenda territorit të Kosovës është në pronësi të Republikës së Kosovës.

Serbia konsideron se... prona brenda territorit të Kosovës është në pronësi të Serbisë, sipas rregullimit specifik provincial dhe në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Serbisë.

²⁰⁵ Zyra për Kosovë dhe Metohi, *Progress Report on the Dialogue Between Belgrade and Pristina: 1 May – 15 December 2018*, ["Raporti i progresit për dialogun teknik mes Kosovës dhe Serbisë: 1 maj – 15 dhjetor 2018", dhjetor 2018, fq. 17. "Ligji në fjalë u miratua nga Prishtina në qershor 2016, në kundërshtim me të gjitha procedurat dhe përkundër kundërshtimit të ngritur nga Beogradi dhe Lista Serbe. Lista Serbe madje paraqiti një kërkesë para të ashtuquajturës Gjykatë Kushtetuese e Kosovës që të rishikojë kushtetutshmërinë e procedurës me të cilën është miratuar ky ligj, por Gjykata e refuzoi atë.", në <http://www.kim.gov.rs/doc/pregovaracki-proces/Sestomesecni%20izvestaj%20o%20dijalogu%20dec%202018%2011%2002%202019%20en.pdf>]

²⁰⁶ Gazeta Express, "Ngrihet aktakuzë ndaj Azem Sylës dhe 39 personave të përfshirë në dallaveret me prona", 25 tetor 2016, në <https://www.gazetaexpress.com/lajme-ngrihet-aktakuzë-ndaj-azem-sylës-dhe-39-personave-te-perfshire-ne-dallaveret-me-prona-270057/>

²⁰⁷ Intervistë të Grupit për Ballkan, Prishtinë, korrik 2015 - maj 2016.



Marrëveshja për Energjinë ka qenë pjesë e pakos së çështjeve teknike që janë diskutuar që nga fillimi i dialogut teknik në vitin 2011. Ajo është konsideruar si çështje teknike edhe pse ka impakt të madh ekonomik dhe politik për Kosovën, por edhe për rajonin në tërësi. Kjo marrëveshje ka shënuar përparim kohët e fundit, duke bërë që operatori i sistemit të transmetimit të energjisë së Kosovës, KOSTT t'a fitoj pavarësinë e saj energjetike dhe të anëtarësohet në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji (ENTSO-E).

Fusha e energjisë paraqet sfida të shumta sepse ka të bëjë me shumë rrjete komplekse të infrastrukturës dhe sistemeve të mirëmbajtjes. Ajo ka të bëjë edhe me mirëqenien sociale pasi qasja në energji të mjaftueshme, të përballueshme dhe të sigurt është thelbësore për cilësinë e jetës së njeriut. Që nga lufta, Serbia ka mbajtur frenat e infrastrukturës energjetike të Kosovës e cila ka çuar në humbje financiare për Kosovën dhe gjithashtu ka prekur katër komunitat në veri të Kosovës, ku furnizimi me energji elektrike ishte shumë i paqëndrueshëm dhe ku mbledhja e faturave të energjisë elektrike nuk ishte bërë kurrë.²⁰⁸

Në vitin 2013, Qeveria e Kosovës dhe e Serbisë kishin rënë dakord që Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe Rrjeti Energjetik i Serbisë (EMS), të nënshkruajnë një marrëveshje dypalëshe brenda tre muajve për të vendosur dhe rregulluar marrëdhëniet në mes të dy operatorëve të sistemit të transmisionit. Në këtë mënyrë



është pritur që të dy rregullatorët të lëshonin licenca për tregtim (import, eksport, transit) dhe furnizim të kompanive të tyre përkatëse të shpërndarjes. Palët gjithashtu janë pajtuar që të krijojnë një kompani të re sipas ligjeve të Kosovës për të furnizuar me energji dhe ofruar shërbime të distribuimit në katër komunitat veriore me shumicë serbe. Aranzhimet u bënë në vitin 2013, por zbatimi ende nuk ka filluar, sepse kompania serbe "ElektroServer" ende nuk ka aplikuar për licencë të operimit në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë. Plani i Veprimit, i nënshkruar me 14 shtator 2014, parasheh që KOSTT-i dhe EMS-ja të funksionojnë si dy operatorë të pavarur që plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga ENTSO-E, e cila përfaqëson 42 OST-ët nga 35 vende të Evropës.²⁰⁹

²⁰⁸ Emini, D. & Stakic, I. "Belgrade and Pristina: lost in normalization?", [Beogradi dhe Prishtina: të humbur në normalizim?], Prill 2018, në <https://www.iss.europa.eu/content/belgrade-and-pristina-lost-normalisation>

²⁰⁹ Plani i veprimit të energjisë, shtator 2014, në http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Energy_Action_Plan_18_September_2014.pdf

KOSTT-i ka qenë pjesë e bllokut të kontrollit Serbi-Mali i Zi - Maqedoni e Veriut, e koordinuar nga OST-ja serbe EMS. Për këtë arsye, KOSTT-i u përballë me pengesa për të krijuar një marrëdhënie me ENTSO-E për shkak të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të Serbisë. Sidoqoftë, më 1 tetor 2015, KOSTT-i nënshkroi një Marrëveshje të Konektivitetit me ENTSO-E dhe 35 shtetet e saj anëtare që do të thotë se përfundimisht Kosova do të mund t'i kontrollojë linjat e veta të transmisionit të energjisë dhe do të fitoj tarifa nga qarkullimi i energjisë përmes rrjetit të Kosovës. Kjo do të ndodhte me kusht që kompania serbe "ElektroSever" më parë ta merrte licencën për furnizimin me energji elektrike dhe të bëhet funksionale sipas ligjeve të Kosovës. Megjithatë, kjo marrëveshje nuk hyri menjëherë në fuqi duke qenë se Serbia ende po e bllokonte këtë proces duke mos e lejuar licencimin e "ElektroServer" dhe duke mos e njohur KOSTT-in si një OST-je të pavarur.²¹⁰

Mos-zbatimi i kësaj marrëveshje nga Serbia kishte cënuar rëndë sistemin energjetik të Kosovës, sigurinë rajonale e gjithashtu kishte ndikuar edhe në ngadalësimin e zbatimit të agjendës rajonale të *Procesit të Berlinit*, mbi ndërlidhjen rajonale në fushën e energjisë. Kjo ngecje ndikoi drejtpërdrejtë edhe në mosvënjen e zbatimit të sistemit të ndërlidhjes (*interconnectivity*) në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, të ndërtuar me fonde gjermane.²¹¹

Në vitin 2008, një ankesë u ngrit zyrtarisht nga KOSTT-i pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë ("Sekretariati"), i cili vlerëson pajtueshmërinë e EMS-së me ligjin e Komunitetit të Energjisë.²¹² Sekretariati zbuloi se mungesa e kompensimit ndaj KOSTT-it për kostot e bëra si

rezultat i tranzitit të energjisë elektrike në rrjetin e operuar nga ai, e shkel Rregulloren (KE) 1228/2003. Rrjedhimisht, u supozua se të ardhurat nuk janë përdorur as për përfitimet e disponueshmërisë së kapacitetit të akorduar, as për investimet në rrjetin e operuar nga KOSTT-i, e as si të ardhura të marra në konsideratë për të ulur nivelin e përgjithshëm të tarifave të transmetimit në rrjetin që operohet nga KOSTT-i. Më 14 tetor 2016, Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë kishte vendosur që Serbia ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saja dhe kërkoi që ajo të merrte të gjitha masat e duhura për të korrigjuar shkeljet e identifikuar dhe për të siguruar pajtueshmërinë me ligjin e Komunitetit të Energjisë deri në dhjetor 2016.²¹³ Me miratimin e këtij vendimi, çështja u mbyll. Sidoqoftë, Sekretariati inicoi një rast të ri në tetor 2017, duke pretenduar se Republika e Serbisë nuk arriti të marrë asnjë masë për të korrigjuar shkeljet e identifikuar dhe se moszbatimi i Vendimit të Këshillit Ministror përbën një shkelje të ligjit të Komunitetit të Energjisë.²¹⁴

Përkundër mos-zbatimit nga ana e Serbisë, vendimi i operatorëve të Sistemit Transmetues të Evropës Kontinentale (UCTE) për njohjen e operatorit të KOSTT-it si zonë rregulluese brenda Evropës kontinentale, mbeti në fuqi.²¹⁵ Kjo i siguroi Kosovës pjesëmarrje dhe angazhim në rrjetin evropian të energjisë elektrike, dhe në vazhden e hapave të Kosovës drejt anëtarësimit dhe funksionalizimit të plotë të saj në ENTSO-E. Në dhjetor të vitit 2019, KOSTT-i nënshkroi një marrëveshje me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë, për themelimin e bllokut rregullues të sistemeve energjetike Kosovë-Shqipëri. Kjo e bëri të mundur shkëputjen e KOSTT-it nga zona rregullatore serbe

²¹⁰ KFOS, *Darkness and Silence after the Bruxelles Agreement: Analysis of the Agreement on the Energy and Communication*, ["Errësirë dhe Heshtje pas Marrëveshjes së Brukselit: Analiza e Marrëveshjes për Energji dhe Komunikim"], 2018, në <http://crnobelivest.com/wp-content/uploads/2018/02/DARKNESS-AND-SILENCE-AFTER-THE-BRUXELLES-AGREEMENT.pdf>

²¹¹ "Projektet e miratuara për secilin shtet të WB6-së financohen pjesërisht nga mekanizmat e BE-së dhe pjesërisht nga vetë këto shtete. Agjenda e Konektivitetit kombinon politikat dhe infrastrukturën, duke ndërlidhur kështu shtetet e WB6-së ndërmjet vete dhe me BE-në qeveritë kanë vendosur një rrjet themelor dhe gjithpërfshirës rajonal të infrastrukturës, duke e bërë kështu Ballkanin Perëndimor pjesë të Rrjetit Trans-Evropian të Transportit (TEN-T). Gjithashtu, Procesi i Berlinit ka gjeneruar edhe iniciativa të lidhjeve rajonale, siç janë bashkëpunimi në energji, Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor (RYCO), krijimi i një Zone Ekonomike Rajonale dhe nënshkrimi i Traktatit të Komunitetit të Transportit." Raport i Grupit për Ballkan, *Procesi i Berlinit në Ballkanin Perëndimor: Përfitimet dhe Sfidat për Kosovën*, janar 2018

²¹² KOSTT-i konstatoi se EMS-js pushoi së kompensuari KOSTT-in për transfere të energjisë elektrike dhe të ardhura nga shpërndarja e kapacitetit të transmisionit në interkonektorët me vendet fqinje në Kosovë*. Problemi mori një dimension ndërkombëtar kur KOSTT-i nuk arriti të ruajë frekuencën e kërkuar prej 50 herit në rrjetin e transmisionit për më shumë se një vit e gjysmë, kinse u iniciua nga fakti se energjia elektrike në veri të Kosovës nuk faturohet, dhe madje edhe nëse faturohet, KOSTT-i nuk i merr ato para.

²¹³ "Rregullore (EC) Nr. 714/2009 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për kushtet për qasje në rrjetin për shkëmbimet tejkufitare të energjisë elektrike dhe për shfuqizimin e Rregullores (EC) Nr. 1228/2003", Neni 12 dhe Neni 6, 13 korrik 2009, në https://mzhe-ks.net/repository/docs/Regulation_714_2009_Alb.pdf

²¹⁴ Case ECS-3/08S, ["Kërkesa e Arsytuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 31 maj 2016"], në <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html>. Case ECS-03/08: Serbia / electricity, [Vendim 2016/02/MC-EnC i Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë], 14 tetor 2016, në <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html>. EnCS u ftua që të monitorojë respektimin nga ana e Serbisë të EnC *acquis communautaire* dhe të kërkojë vendosjen e masave sipas Nenit 92 të Traktatit në 2019, nëse Serbia nuk e zbaton Vendimin e MC-EnC 2016/02/MC-EnC deri më 1 korrik 2019. Ky Vendim hyri në fuqi me rastin e miratimit të tij dhe iu dorëzua institucioneve të EnCT dhe Palëve (Neni 3, Vendimi i MC-EnC 2018/12/MC-EnC

²¹⁵ Listën e plotë të OST-ve të Evropës Kontinentale mund ta gjeni në <https://www.entsoe.eu/about/inside-entsoe/members/>

dhe bashkimin me atë të Shqipërisë. KOSTT-i deklaroi se marrëveshja u nënshkrua me pëlqimin e Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike (ENTSO-E). Pas negociatave të gjata të lehtësuara nga Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energjinë Elektrike (ENTSO-E), një hap i madh drejt zgjidhjes së mosmarrëveshjes mes KOSTT-it dhe EMS-it erdhi në 20 prill 2020, kur OST-të e Evropës Kontinentale votuan në favor të marrëveshjes së konektivitetit me KOSTT-in.²¹⁶ Kjo marrëveshje, pasi të nënshkruhet dhe zbatohet, do t'i japë fund mosmarrëveshjes afatgjatë midis dy OST-ve dhe do t'i japë një shtysë integritetit të tregut në Ballkanin Perëndimor edhe më tej me pjesën tjetër të Evropës dhe hyri në fuqi me 20 prill 2020. Kjo marrëveshje kërkoi edhe miratimin e RGCE (Grupi Rajonal i Evropës Kontinentale), e cila është një nga organet e ENTSO-E.²¹⁷ Gjithashtu, operatori serb në veri, "Elektroserver" do të duhet të operojë si furnizues me licencë, konform kornizës ligjore dhe rregullative të Republikës së Kosovës në fushën e energjisë.

Vendosja e marrëdhënieve energjetike midis të dyja shteteve me lehtësim dhe garanci të BE-së padyshim që do të kontribuojë në shërbime më të mira energjetike për qytetarët. Për më tepër, bashkëpunimi midis Prishtinës dhe Beogradit në këtë fushë është vendimtar për rritjen ekonomike e të dyja vendeve.

Megjithatë çështja e operatorit energjetik në komunat veriore të Kosovës mebetet e pazgjidhur. Operatori i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve "ElektroSever", ende nuk ka aplikuar për licencë të operimit në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë. Si rredhje, veriu mbetet ende jashtë sistemit energjetik të Kosovës, faturat nuk grumbullohen dhe qeveria paguan miliona euro – shumë vjet duke ua faturuar qytetarëve të tjerë si borxh shtesë, e nga viti 2017, nëpërmjet buxhetit të ndarë nga Qeveria.²¹⁸

ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

NGA PARIMET PËR NORMALIZIM

Të krijohet një Asociacion i komunave me shumicë Serbe në Kosovë

Asociacioni themelohet mbi të njëjtën bazë si të Asociacionit ekzistues të komunave të Kosovës

Kompetencat në përputhje me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjin e Kosovës për komunat dhe të tjera shtesë që delegohen nga autoritetet qendrore

Asociacioni ka një përfaqësues në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve

Një pjesë e konsiderueshme e *Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve* i referohet themelimit të Asociacionit të Komunave Serbe (AKS). Në gusht 2015, Kosova dhe Serbia arritën një *Marrëveshje mbi Parimet e*

përgjithshme / Elementet kryesore, të Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, e cila kishte për qëllim të definojë saktë se si do të themelohet asociacioni dhe cila do të jetë struktura dhe fushëveprimtaria e saj. Në praktikë kjo do të thotë

²¹⁶ Koha, "Miratohet marrëveshja e re KOSTT dhe ENTSO-E, Hajdari thotë se Kosova fiton pavarësinë energjetike", 20 prill 2020, në <https://www.koha.net/arberi/218456/miratohet-marreveshja-e-re-kostt-dhe-entso-e-hajdari-thote-se-kosova-fiton-pavaresine-energjetike/>

²¹⁷ Kosova morri 22 vota pro, 4 abstenime (Hungaria, Bullgaria dhe Greqia), dhe 3 kundër (Spanja, Bosnja dhe Hercegovina dhe Sllovakia). Reuters, "Kosovo's power firm hooks up with European grid", ["Firma energjetike e Kosovës shoqërohet me rrjetin Evropian"], 21 prill 2020, në <https://uk.reuters.com/article/kosovo-energy-albania/kosovos-power-firm-hooks-up-with-european-grid-idUKL5N2C91PU>


²¹⁸ Radio Evropa e Lirë, "Qeveria nuk paguan më faturat e energjisë në veri", 20 gusht 2018, në <https://www.evropalire.org/a/qeveria-nuk-paguan-me-faturat-e-energjise-ne-veri/29443484.html>

se, përmes statutit, do të krijohet një asociacion për 10 komunat me shumicë serbe (dhe anëtarësimi do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër, me kusht që anëtarët ekzistues të jenë të pajtimit).²¹⁹ Shpërbërja e tij mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse.

Sipas marrëveshjes, struktura e asociacionit do të jetë mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të Komunave të Kosovës, p.sh., Kryetari, Nënkyetari, Kuvendi, Këshilli, etj., si dhe në përputhje me kompetencat e parapara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e Kosovës. Komunitat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre kolektive përmes Asociacionit. Ndërkaq Asociacioni do të ketë mbikëqyrje të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimin, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural si edhe kompetenca të tjera shtesë, që mund të delegohen nga autoritetet qendrore.

Pas ratifikimit të *Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve* ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së

Serbisë me 22 prill 2013, 12 deputetë të Kuvendit të Kosovës e kishin dërguar ligjin për ratifikimin e saj në Gjykatën Kushtetuese.²²⁰ Kushtetuesja kishte konkluduar se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit për ratifikimin e marrëveshjes dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje është në pajtueshmeri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.²²¹



PARIMET E PËRGJITHSHME / ELEMENTET KRYESORE, TË ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË KOSOVË

ASM do të mund të:

- propozoj ndryshime në legjislacionin dhe rregulloren të tjera përkatëse;
- të iniciojë ose të marrë pjesë në proceset gjyqësore para gjykatave kompetente, përfshirë Gjykatën Kushtetuese;
- të emërojë përfaqësues në organet kompetente të qeverisë qendrore;
- të zotërojë prona të luajtshme dhe të paluajtshme, për të lidhur kontrata, etj;
- të ketë buxhetin e vet;
- të ketë simbolet dhe stemën e vet.

Në gusht 2015, Kosova dhe Serbia u pajtuan për parimet e përgjithshme/elmentet kryesore për Asociacionin e komunave me shumicë serbe. Këto parime definojnë statutin juridik të AKS-

së, kompetencat, statusin, cilësinë juridike, buxhetin etj. Kjo marrëveshje shkaktoi tensione të pa para në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë më 2008. Partitë opozitare organizuan protesta

²¹⁹ Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Zveqan, Leposaviq, Graçanicë, Shtërpçë, Novobërdë, Kllokot, Ranillug dhe Partesh

²²⁰ Ligji Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8892>

²²¹ Aktgjykimi për rastin nr. KO95/13, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, 9 shtator 2013.

masive, bojkotuan kuvendin ku u hodh edhe gaz lotësjellës dhe organizuan peticion kundër AKS-së.²²² Për të parandaluar më të keqen, me 31 tetor 2015, Presidentja e atëhershme Atifete Jahjaga dërgoi marrëveshjen mbi parimet e përgjithshme/elmentet kryesore për asociacionin e komunave me shumicë serbe në Gjykatën Kushtetuese.²²³ Kjo e

fundit vendosi se këto parime nuk ishin tërësisht në përputhje me frymën e saj; sipas vendimit kërkohej që Asociacioni i Komunave Serbe të themelohet sipas Marrëveshjes së Parë, të ratifikuar nga Kuvendi, ndërsa dekreti dhe Statuti i Asociacionit të dërgohen përsëri për shqyrtim në Gjykatë, kur të jenë draftuar.²²⁴

TË GJETURAT KRYESIRE QË DALIN NGA AKTGJYKIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS PËR PARIMET E PËRGJITHSHME / ELEMENTET KRYESORE, TË ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË KOSOVË

Objektivat, buxheti i organizatës strukturore, mbështetja dhe dispozitat e përgjithshme të Asociacionit, tejkalojnë standardet kushtetuese të vetëqeverisjes lokale të Kosovës;

E drejta e iniciativës legislative i jepet ekskluzivisht Presidentit të Republikës së Kosovës, Qeverisë, deputetëve të Kuvendit ose të paktën dhjetë mijë qytetarëve;

Asociacionit / Bashkësisë nuk mund t'i jipet autoriteti i plotë dhe ekskluziv për të promovuar interesat e komunitetit serb të Kosovës në marrëdhëniet e tyre me autoritetet qendrore.

Si pasojë, që nga 2013, themelimi i këtij asociacioni u bë çështja më e kontestuar e dialogut me Serbinë dhe polarizoi skajshmërisht skenën politike dhe opinionin në Kosovë.²²⁵ Brenda shoqërisë kosovare, serbëve të Kosovës, Beogradit dhe të komunitetit ndërkombëtar ka qëndrime dhe pikëvështrime të ndryshme sa i përket kësaj marrëveshje, te cilat e kanë bërë edhe më të vështirë implementimin e saj.²²⁶ Shoqëria në Kosovë e sidomos partitë politike opozitare e shohin këtë si një tendencë të Beogradit për t'a shfrytëzuar asociacionin si mjet për të minuar integritetin territorial dhe sovranitetin e vendit. Kjo ka kulmuar në protesta të shumta.

Pala kosovare vazhdon të insistojë se nuk do e lejoj krijimin e Asociacionit pa hapjen e tërësishme të urës mbi lumin Ibër, si dhe pa shpërbërjen e institucioneve “paralele” të Serbisë. Palët nuk pajtohen as për emrin e tij. Disa dokumente i referohen si “Asociacioni i Komunave Serbe”, disa si “Bashkësi”, ndërsa të tjerë preferojnë termin “Komunat me Shumicë Serbe”. Kjo çështje kërkon ri-angazhim më serioz të skenës politike për t'u përcaktuar drejtë si dhe kërkon zgjidhje të duhur për t'a trajtuar, implementuar apo kthyer në tavolinën e bisedimeve.

²²² Grupi për Ballkan, *Asociacioni i Komunave Serbe: Kuptimi i pikëpamjeve kundërthënëse të shqiptarëve dhe serbëve*, janar 2017

²²³ “Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, a janë në përputhshmëri këto parime dhe elemente me frymën e Kushtetutës, nenin 3, paragrafin 1 (natyra shume-etnike), Kapitullin II (të drejtat dhe liritë themelore) dhe Kapitullin III (të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?”, Aktgjykimi në Rastin nr. KO130/15 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, 23 dhjetor 2015, në http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_shq.pdf

²²⁴ Sipas Gjykatës Kushtetuese në Marrëveshjen e Parë, asociacioni duhet të ketë strukturë të ngjashme me asociacionin ekzistues të komunave të Kosovës. Punonjësit e tij nuk kanë statusin e shërbyesit civil, status i rezervuar për punëtorët e institucioneve qeveritare. Por, më e rëndësishmja, asociacionit nuk do t'i jipet “autoriteti i plotë dhe ekskluziv” mbi komunitetin etnik serb në Kosovë. Asociacioni do të jetë pjesë e Këshillit Konsultativ për Komunitete, por nuk do të minojë fuqitë e tij. Si anëtar, asociacioni mund të sugjerojë propozime legislative, por nuk ka të drejtë të sjellë ligje në Kuvend, që me Kushtetutë është e rezervuar për Presidentin, Qeverinë, deputetët, ose për të paktën dhjetë mijë qytetarë. Qasja e asociacionit në Gjykatën Kushtetuese është e limituar. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. KO130/15.

²²⁵ Grupi për Ballkan, *Asociacioni i Komunave Serbe: Kuptimi i pikëpamjeve kundërthënëse të shqiptarëve dhe serbëve*, janar 2017, fq. 24. Ibid.

²²⁶ Ibid. “E para zotohet që të themelojë asociacionin vetëm sa për ta përmbyshur zotimin e saj ndaj dialogut të Brukselit, të përmbyshur integrimin e serbëve dhe të arrijë fazat e fundit të normalizimit me Serbinë. Kjo e fundit dëshiron që Bashkësia e Komunave Serbe t'ju shërbejë serbëve të Kosovës, të transferojë kompetencat e financimit nga Beogradi në një trupë të re ligjore dhe ta përdor si një urë të bashkëpunimit me Kosovën, në kuadër të kornizës së normalizimit të marrëdhënieve. Serbët e Kosovës, në anën tjetër, kanë pikëvështrime mikro dhe dëshirojnë që bashkësia të jetë një mjet praktik që do t'ju ndihmojë në ruajtjen e identitetit, fuqizimit të tyre për t'u marrë me Qeverinë e Prishtinës dhe në ruajtjen e shërbimeve “vitale” të financuara nga Serbia dhe lidhjeve me Beogradin.” fq 10.

Duke qenë se marrëveshja është ratifikuar më 2013 nga Kuvendi i Kosovës, 15 dispozitat e Marrëveshjes së Parë janë kthyer në një obligim ndërkombëtar për Kosovën. Kjo do të thotë se duhet bërë themelimi i asociacionit në përputhje me Parimet e Përgjithshme dhe marrëveshja duhet të zbatohet, pavarësisht se kush udhëheqë në qeveri.²²⁷



REVITALIZIMI DHE HAPJA PËR LËVIZJE E URËS NË MITROVICË

PIKAT KRYESORE TË MARRËVESHJES

Revitalizimi do të fillojë me 14 gusht 2016.

Ura do të jetë e hapur për qarkullim të plotë më 20 janar 2017.

Komuna e Mitrovicës së Veriut do të revitalizoj rrugën e saj kryesore në zonën për këmbësorë.

Një grup punues bashkë me dy kryetarët e komunave do të monitorojë kushtet politike e të sigurisë gjatë dhe pas procesit të revitalizimit.

Barrkada e vendosur mbi urën e lumit Ibër në Mitrovicë, që u bë simbol i ndarjes së qytetit që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, u hoq pas shumë diskutimeve të zhvilluara në Bruksel, me ç'rast, në vitin 2016, u miratua plani për hapjen e saj.²²⁸

Bashkimi Evropian kishte ofruar mbështetje financiare për rikonstruktimin dhe revitalizimin e urës por ajo ende nuk është e hapur për qarkullim, meqenëse procesi i ndarjes së vijës administrative në mes të Komunës së Mitrovicës Jugore me atë Veriore sipas Planit të Ahtisaarit është i ndërlikuar.²²⁹

²²⁷ Intervistë e Grupit për Ballkan mezyrtarë të lartë të BE-së, Prishtinë, 14-15 qershor 2016.

²²⁸ Plani i BE-së për Implementimin e Marrëveshjes për Urën në Mitrovicë, 5 gusht 2016, në http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/EU_Implementation_Plan_of_the_Agreement_on_the_Mitrovica_Bridge_5_August_2016.pdf

²²⁹ Radio Evropa e Lirë "Suhodolli 'sherr' ndërmjet jugut dhe veriut", 22 shkurt 2016, në <https://www.evropalire.org/a/27567189.html>



Duke u bazuar në Planin e Ahtisaarit, me nënshkrimin e marrëveshjes, vendbanimet mbi lumin Ibër, si Suhodolli, Gushanci e Vinarci, të banuara më shumicë shqiptare, do të kalonin nën administrimin e Mitrovicës së Jugut.²³⁰ Sipas konkluzioneve të grupit punues, kërkohet që kufijtë administrativ për zonat kadastrale të Suhodollit dhe Kroit të Vitakut të përcaktohen përmes një Memorandumi të Mirëkuptimit në mes të dy komunave.²³¹

Komuna e Mitrovicës Veriore pretendon se vija administrative e ndarjes në mes tyre është përtej urës, në drejtim të jugut, ndërsa Komuna e Mitrovicës Jugore, duke u bazuar në Planin e Ahtisaarit dhe në ligjet e Kosovës, pretendon të kundërtën, pasi që edhe në procesin e Vjenës ajo vijë ishte përcaktuar të jetë mbi lumin Ibër, në drejtim të pjesës veriore.²³² PPraktikisht problem është përcaktimi i vijës administrative në fshatin Suhodoll i Epërm, të cilën komuna veriore pretendon t'a ketë nën zonën e saj administrative, ndërkohë që sipas Komunës Jugore të Mitrovicës, ajo është dhe duhet të mbetet nën administrimin e komunës jugore. Në media pati qarkulluar edhe opsioni që kjo pjesë të administrohet nga të dy komunat sipas modelit të partneritetet ndërkomunal.²³³

Para arritjes së marrëveshjes për hapjen e urës, ajo ishte shëndërruar në të ashtuquajturin “parku i paqes” nga ana e zyrtarëve të Serbisë dhe zyrtarëve të komunës veriore të Mitrovicës. Edhe me revitalizimin e urës, tensionet nuk patën së ndaluri pasi Komuna e Mitrovicës Veriore vendosi që të mbyllë rrugën e saj kryesore (rruga “Mbreti Pjetër”) dhe t'a kthejë atë në shëtitore, gjë që qytetarët shqiptarë e panë si tendencë për të penguar lirinë e lëvizjes së qytetarëve të jugut. Megjithatë, në bazë të ligjeve në fuqi në Kosovë, institucionet lokale kanë autoritet të vendosin se cilat rrugë, sheshe ose hapësira publike mund të jenë të mbyllura apo të hapura.²³⁴ Komuna e Mitrovicës veriore e ka kushtëzuar lëvizjen edhe të mjeteve motorike në urën mbi Ibër me definimin e vijës administrative në mes të Jugut dhe Veriut. Definimi i kufijve kadastrale mbetet çështje shumë e ndjeshme për të dyja palët.

Megjithatë, Qeveria e Kosovës duhet që së bashku me BE-në dhe përfaqësuesit serbë të gjejnë një gjuhë të përbashkët dhe modalitete për hapjen e urës dhe rritjen e besimit mes qytetarëve nga të dyja anë. Në të kundërtën, kjo çështje duhet të kthehet në takimet e Brukselit për zgjidhje përfundimtare.

²³⁰ Komuna veriore dhe ajo jugore e Mitrovicës, kanë pasur dallime mbi atë se në cilën komunë është fshati Suhodoll që ndodhet në anën veriore të lumit Ibër. Kufiri administrativ i dy komunave, bazohet në hartën që del nga dokumenti i Marti Ahtisaarit. Sipas dakordimit të Brukselit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) do ti ndihmojë të dy komunave që të arrijnë një memorandum mirëkuptimi për tejkalimin e dallimit por jo dalje nga ligji sepse ligji për Kufijtë Administrativ të Komunave është Ligj vital i miratuar me 20 shkurt 2008. Sipas këtij ligji, nenit 3.3: “Kufiri në mes Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe Komunës Mitrovica e Jugut do të jetë vija e përcaktuar që do të kalojë nëpër zonën kadastrale të Suhodollit”.

²³¹ Konkluzionet e grupit punues për lirinë e lëvizjes/ urën, 25 gusht 2015.

²³² Ibid.

²³³ Insajderi, “Agim Bahtiri tregon se pse nuk largohet barrikada mbi lumin Ibër”, qershor 2016, në <https://insajderi.com/agim-bahtiri-tregon-se-pse-nuk-po-largohet-barrikada-mbi-iber/>

²³⁴ Shih raportin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës “Organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë”, fq 34, Tabela 4, Nr. 10, Gusht 2013, në <https://mapl.rks.gov.net/wp-content/uploads/2018/03/ORGANIZIMI-DHE-FUNKSIONIMI-I-VETEQEVERISJES-LOKALE-NE-KOSOVE.pdf>

MIRATIMI I MARRËVESHJEVE

Marrëveshja e Parë për Normalizimin e Marrëdhënieve është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës si marrëveshje ndërkombëtare më 27 qershor 2013. **Nga 120 deputetë, 84 votuan pro, 3 kundër dhe 1 abstenoj.** Kushtetuta e Kosovës përcakton se marrëveshjet ndërkombëtare duhet të ratifikohen nga dy të tretat (2/3) e votave sa herë që bëhet ndonjë ndryshim në çështjet e territorit, paqes, aleancave, çështjeve politike e ushtarake, të drejtave e lirive themelore, anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe marrjen e obligimeve financiare nga Republika e Kosovës.²³⁵ Si rezultat, në përputhshmëri me Nenin 19, Paragrafin 2 të Kushtetutës së Kosovës, marrëveshjet ndërkombëtare të cilat ratifikohen nga Kuvendi i Kosovës kanë epërsi mbi Kushtetutën dhe ligjet e vendit.²³⁶ Kjo do të thotë se ratifikimi i marrëveshjes së parë si marrëveshje ndërkombëtare është mbi Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, e cila pamundëson iniciativat ligjore kundrejt zbatimit të dispozitave ligjore që rrjedhin nga marrëveshja. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Serbisë refuzoi shqyrtimin e kushtetueshmërisë së Marrëveshjes së Parë duke e cilësuar atë si çështje politike dhe jo ligjore, gjë e cila e bëri të pamundur ratifikimin e saj nga ana e Kuvendit të Serbisë.²³⁷

Sa i përket marrëveshjeve të tjera të dialogut teknik, ato asnjëherë nuk janë dërguar për miratim në Kuvendin e Kosovës. Sipas qeverisë, kjo ka ndodhur për shkak se ato kanë qenë konkluzione të dakorduara për zbatimin e të cilave nuk ka pasur nevojë të ndryshohet legjisllacioni. Përrjashtohen rastet kur është dashur të miratohet nga Qeveria ndonjë dokument si ai i Protokollit Teknik të IBM-së, apo nxerrja e ndonjë rregulloreje apo vendimi në nivel të ministrit për t'a zbatuar ndonjë pjesë të marrëveshjes si p.sh. drejtësia, policia, apo rasti i nenit shtesë të ligjit për buxhet për t'a mundësuar Fondin Zhvillimor. Marrëveshjet që janë miratuar nga Qeveria e Kosovës, përveç Protokollit Teknik të IBM-së, janë edhe Integrimi i personelit të ish-Mbrojtjes Civile, Marrëveshja për kompletimin e zbatimit të Marrëveshjes për Lëvizjen e Lirë e vitit 2011, si dhe ajo për Telekomin dhe Energjinë.

Marrëveshjet që i ka trajtuar Gjykata Kushtetuese e Kosovës janë Marrëveshja për Normalizim, Ligji i Amnistisë, Fondi Zhvillimor në kontekst të Ligjit për Buxhetin dhe Asociacionin si edhe parimet e përgjithshme/parimet kryesore të tij. Për këtë të fundit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar mospërputhje të disa neneve me frymën e Kushtetutës. Një ndër arsytet e ngurrimit të Qeverisë së Kosovës për t'i dërguar marrëveshjet e tilla për miratim në Kuvend, mund të jetë edhe zgjatja e procesit për shkak të tensioneve dhe ndasive ndërmjet subjekteve politike parlamentare.

LIGJI PËR AMNISTINË

Në mënyrë që të mundësohet integrimi i pjesëtarëve të ish-strukturave paralele të sigurisë të financuara nga Beogradi, Kosova kishte miratuar edhe Ligjin për Amnistinë i cili ka hyrë në fuqi me 17 shtator 2013.²³⁸ Ky ligj është zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në procesin e integritit të qytetarëve serbë të pjesës veriore dhe vendbanimeve tjera, në institucionet e Kosovës, ashtu siç parashikohej nga Marrëveshja e Brukselit.

Konkretisht, Ligji i Amnistisë është zbatuar në procesin e integritit të pjesëtarëve të policisë serbe dhe atyre të mbrojtjes civile në Policinë e Kosovës. Ky ligj ka përcaktuar kushtet dhe procedurat në të cilat është dhënë amnistia për personat që janë të dënuar për një veprë penale, personat që janë në ndjekje të një veprë penale apo personat që ishin objekt i ndjekjes penale për veprat e kryera para datës 20 qershor 2013. Ligji poashtu është shqyrtuar edhe nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila ka vlerësuar se të gjitha procedurat e miratimit të këtij ligji janë në përputhje me Kushtetutën.²³⁹ Gjatë vitit 2014, Gjykata e Mitrovicës i ka shqyrtuar 941 lëndë dhe 1237 persona kanë përfituar nga Ligji për Amnistinë, kryesisht për armëmbajtje pa leje, prej të cilëve 1000 kanë qenë shqiptarë, 216 serbë dhe 21 boshnjakë.²⁴⁰

²³⁵ Ligji Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, Neni 18, paragrafet 1 & 2, 2011 E disponueshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2789>

²³⁶ Ibid, Neni 19.

²³⁷ Zëri, "S'ka normalizim të marrëdhënieve", 20 prill 2019, në <https://zeri.info/aktuale/253872/ska-normalizim-te-marredhenieve/>

²³⁸ Ligji Nr. 04/L-209 për Amnistinë

²³⁹ Aktgjykim në Rastin Nr. KO108/13," Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, Nr. 04/L-209, për Amnisti", shtator 2013.

²⁴⁰ Koha, "Ligji për Amnisti s'po jep rezultate", 11 shtator 2014

VEPRIMET POLITIKE, LIGJORE DHE ADMINISTRATIVE TË INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS NË LIDHJE ME DIALOGUN ME SERBINË

Kosova ndërmori edhe një varg hapash për të zhvilluar dialogun me Serbinë me lehtësimin e BE-së.

2011	01.03	Platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës për dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë
	10.03	Rezolutë për Dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë
	28.07	Rezolutë për Veriun e Kosovës
	07.12	Vendim i Kuvendit për miratimin e rekomandimeve të GP LVV
2012	20.01	Vendim i Kuvendit të Republikës së Kosovës pas mocionit të propozuar nga PDK për të mbështetur Dialogun e Brukselit për Normalizim
	18.10	Rezolutë për Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë
2013	22.04	Rezolutë për dhënien e pëlqimit për nënshkrim të Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë
	27.06	Ratifikimi i Marrëveshjes së Parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë
	9.09	Rishikim i Kushtetueshmërisë së Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë, si dhe Planit Implementues të saj
2014	29.04	Qeveria e Kosovës, <i>Dialogu i Brukselit, Hapat e ardhshëm</i>
2015	15.01	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit, 2014 – 2018
	15.12	Vlerësimi i përputhshmërisë së parimeve që përmbanë dokumenti i titulluar “Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë Serbe - parimet kryesore” me frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës
2016	29.12	Rezolutë lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës
2020	15.03	Rezolutë për Dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

Për t'i implementuar marrëveshjet e dala nga dialogu me Serbinë, Kosova ka miratuar edhe një sërë ligjesh si në vijim:

1. Ligji Nr. 04/L-199 - Për Ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë
2. Ligji Nr. 04/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013
3. Ligji Nr. 06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019
4. Ligji Nr. 04/L-209 për Amnistinë
5. Ligji Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Poashtu, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë edhe veprime të tjera administrative dhe akte nënligjore, në përkrahje të procesit të dialogut.

1. IBM

Protokolli teknik i IBM, 24 shkurt 2012;

- Miratuar në Qeverinë e Kosovës më 29 shkurt 2012, Nr. 09/63

Ndërtesat e përhershme të IBM-së 5 shtator 2014

- Miratuar në Qeverinë e Kosovës vendimet për shpronësime me Nr. 04/147 më 15 qershor 2017 për ndërtimin e ndërtesave të përhershme të menaxhimit të integruar të kufirit IBM pikat kufitare Bërnjak, Merdare dhe Mutivodë.

Hapja e dy pikëllimeve të reja (Kapi dhe Izvor)

- Miratuar në Qeverinë e Kosovës vendimi për shpronësim Nr. 10/67 më 30 dhjetor 2015

Njohja e certifikatave fito-sanitare

- Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr. 16/2011 Për caktimin e formës dhe përmbajtjes së të dhënave në fitocertifikatën për eksport, ri-eksport dhe fitocertifikatën për qarkullim të brendshëm të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera

Integrimi i zyrtarëve doganorë që e kishin lëshuar punën në shkurt 2008 në veri

- Vendimi për themelimin e panelit integruar
- Deklarata e betimit

2. PËRFAQËSIMI DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL

- Udhëzues i qarkulluar nga MPJ-ja për përfaqësimin rajonal 2012

3. LIRIA E LËVIZJES

Miratimi i marrëveshjes së re për Lirinë e Lëvizjes 2016

- Miratuar në Qeverinë e Kosovës me Nr. 02/132 më 16 shkurt 2017

Zgjatja e validitetit të targave të Kosovës me mbishkrimin KS

- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 02/2018 Për regjistrimin e mjeteve me targa 'KS'

Kthimi në përdorim i targave 'KS'

- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 24/2011 Për regjistrimin e mjeteve me targa 'KS'

Pranimi i dokumenteve të vjetra për mundësimin e pajisjes me letërnjoftime të komunitetit të integruar

- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 05/2017 Për kriteret që përbëjnë dëshmi për shtetësinë e ish-RFJ-së dhe banimin e përhershëm në territorin e Kosovës më 1 janar 1998

Mundësimi i transformimit të regjistrimeve të vjetra në ato të Kosovës

- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 38/2012 – Për regjistrimin e automjeteve nga targat të ish-RFJ-së në targa të përkohshme të Republikës së Kosovës

Hapja e zyrave të Regjistrimit Civil në veri

- Vendimi për Panelin për Integrim

4. LIBRAT E GJENDJES CIVILE

Integrimi i librave të skanuara në sistemin ekzistues të Agjencisë së Regjistrimit Civil

- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 11/2018 Për përdorimin e kopjeve të certifikuara të regjistrave origjinal themeltar të gjendjes civile të Kosovës, të cilat janë marrë nga ish-pushteti serb, para qershorit të vitit 1999)
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 01/2015 Për përdorimin e kopjeve të certifikuara të regjistrave origjinal themeltar të gjendjes civile të Kosovës, të cilat janë marrë nga ish-pushteti serb, para qershorit të vitit 1999)

5. INTEGRIMI I POLICISË

Krijimi i drejtorisë së re rajonale të Policisë së Kosovës në veri

- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 12/ 2013 Për zgjedhjen e drejtorit rajonal të policisë për rajonin Mitrovicë-Veri)

6. SHUARJA E "MBROJTJES CIVILE"

Miratimi i marrëveshjes në Qeveri

- Miratuar në Qeverinë e Kosovës, Vendimi Nr. 6/39 i datës 22 korrik 2015

Integrimi


- Vendimet për krijimin e paneleve rekrutuese 2015
- Deklarata e betimit para integrimi, 2016
- Udhëzues i qarkulluar nga MpD për integrimin pjesëtareve të ish-“MC-së” nëpër ministritë dhe agjencitë 2015
- Udhëzues i qarkulluar nga MpD në lidhje me konsolidimin e mëtejshëm të veprimtarisë së Institucioneve qendrore në veri të vendit

7. DREJTËSIA

- Vendimi për Themelimin e Panelit për Integrim

8. ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

- Vendimi i ministrit të MAPL-së për ndryshimin e anëtarëve të grupit menaxhues 30 qershor 2016
- Vendimi i ministrit të MAPL-së për emërimin e anëtarëve të grupit menaxhues 14 qershor 2013



Përveç hapave të lartpërmendur, marrëdhënia e Kosovës me Serbinë dhe në një formë edhe vet dialogu, ka qenë i ndikuar nga dy vendime të Kuvendit të Kosovës, të datës 7 dhjetor 2011 (inicuar nga LVV) që kërkon reciprocitet të plotë politik, ekonomik e tregtar me Serbinë dhe të 20 janar 2012 (inicuar nga PDK), si kundërshtim i të parit, meqenëse marrëveshjet e dialogut teknik paraqiten më prioritare.²⁴¹

Në mars 2020, Qeveria e Kosovës e dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit zotohet për *normalizim të marrëdhënive me Serbinë - për dialog dhe frymë reciprociteti*, duke insistuar në “tema të nxehta”, siç janë të pagjeturit, dëm-shpërblimet për dëmet e luftës, kërkimi i pjesës kosovare nga pasuria e ish-Jugosllavisë dhe njohje

mes të dyja shteteve. Plani gjithashtu determinon se *karakteri i Kosovës është i paprekshëm, duke vlerësuar se krijimi i një autoriteti të tretë administrativ për vendbanimet me një popullsi specifike etnike është në kundërshtim me frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për rrjedhojë nuk do të miratohet nga Qeveria e Kosovës.*²⁴²

Kurse më 15 mars 2020, në një seancë të bojkotuar nga opozita, Kuvendi i Kosovës miratoi rezolutë për bisedimet me Serbinë, me të cilën Kuvendi e autorizon Qeverinë e Kosovës që të udhëheqë bisedimet me Serbinë dhe kërkohet njohja reciproke mes Kosovës dhe Serbisë, me garantimin e tërësisë territoriale të Kosovës.²⁴³

²⁴¹ Gazeta Express, “Historia e reciprocitetit, kur Kurti e akuzonte Thaçin se ia ndali masat ndaj Serbisë”, 7 shkurt 2020, në <https://www.gazetaexpress.com/historia-e-reciprocitetit-kur-kurti-e-akuzonte-thacin-se-ia-ndali-masat-ndaj-serbise/>

²⁴² Radio Evropa e Lirë, “Kurti: Dialogun do ta udhëheq unë, jo presidenti”, 10 tetor 2019, në <https://www.evropaelire.org/a/kurti-dialogun-e-udheheq-une-jo-presidenti/30210044.html>

²⁴³ Zeri i Amerikës, “Parlamenti i Kosovës miratoi rezolutën për bisedimet me Serbinë”, 15 shkurt 2020, në <https://www.zeriamerikes.com/a/parlamenti-i-kosov%C3%ABs-miratoi-rezolut%C3%ABn-p%C3%ABr-bisedimet-me-serbin%C3%AB/5329771.html>

SFIDAT DHE MUNDËSITË

Gjatë tërë procesit të dialogut, sfidë e veçantë ka qenë mungesa e përcaktimeve kohore për zhvillimin e bisedimeve. Kjo ka rezultuar në mbarëvajtje të parregullt të takimeve të Brukselit. Në periudha të caktuara, për më shumë se gjashtë muaj nuk është mbajtur asnjë takim. Përveç zhvillimeve ndërkombëtare, këto pengesa kanë ardhur edhe nga grupe të ndikuara nga zhvillimet e brendshme, të cilat shpesh kanë prodhuar kriza të brendshme dhe tensione në mes të dy vendeve. Ri-shikimi apo ri-negocimi i vazhdueshëm i marrëveshjeve krijoi vonesa, pengoi implementimin e tyre dhe uli angazhimin e të dyja Palëve në këtë proces, përfshirë edhe të atyre që ishin angazhuar drejtëpërdrejtë në negociata. Ky rishikim ndodhte edhe për faktin se vet përbërja e ekipeve negociatore, sidomos atij të Serbisë, ndryshonte shpesh.

Në mungesë të transparencës si edhe për shkak të interpretimeve kundërthënëse të marrëveshjeve, niveli i zbatimit të tyre është vështirë të monitorohet me saktësi. Të dyja grupet e dialogut jo vetëm që i kanë bërë marrëveshjet me dykuptimësi dhe pa njoftuar drejt publikun e gjerë, por edhe zbatimi i tyre bëhet kryesisht fshehurazi, përveç në raste të caktuara ku implementimi i tyre ka mund të përdoret për avantazhe politike. Edhe pse ekipet negociatore prodhonin raporte të rregullta gjashtë-mujore për të informuar qeveritë e tyre përkatëse lidhur me zhvillimet gjatë procesit të dialogut, institucionet nuk i bëjnë publike vendimet e tyre që ndërlidhen me implementimin e marrëveshjeve, emërojnë grupe të caktuara zyrtarësh dhe shpesh fshehin veprimet e tyre. Kjo gjithësi bëri që të përhapet një perceptim negativ e i gabueshëm mbi dialogun.

Edhevetkompozimi i marrëveshjeve ofronte hapësirë për interpretime të ndryshme e rrjedhimisht edhe për ngecje në implementim të tyre. Marrëveshja për energjinë përfundon me “mohim” - një klauzolë në fund të tekstit të marrëveshjes, e cila i thekson pikëvështrimet e kundërta të Kosovës e Serbisë në lidhje me pronësinë. Një sërë marrëveshjesh tjera përmbajnë informata plotësuese (fusnota) ku prap theksohen dallimet në perspektiva dhe qëndrime mes të dy grupeve të dialogut, p.sh., të marrëveshja e IBM-it, ajo e të hyrave doganore dhe marrëveshjes për ndihmë të ndërsjellë juridike nuk ka konsensus

nëse vija ndarëse mes Kosovës dhe Serbisë është kufi (në mes të dy shteteve) apo “kufi administrativ” (brenda një shteti të vetëm). Prandaj procesi i negociatave mes Prishtinës e Beogradit, shpesh është prezantuar si “fushëbetejë” në mes të dy vendeve, më shumë se sa si mundësi për gjetjen e zgjidhjeve praktike për problemet e qytetarëve. Kjo ka bërë që marrëveshjet të shihen nga prizmi i “humbjes” apo “fitores” në raport me palën tjetër, e jo si dakordime përmes të cilave ofrohen lehtësime në realizimin e të drejtave të qytetarëve, duke rritur mirëbesimin mes Kosovës dhe Serbisë. Për më shumë, prezantimi i këtij procesi nga ana e të dy grupeve të përfshira si një “dyluftim diplomatik”, ka bërë që pritjet lidhur me rezultatet e procesit në terren të rriten përtej atyre reale. Rrjedhimisht, pritjet e mëdha kanë shkaktuar edhe dëshpërim të madh në publik dhe kanë ulur tej mase besimin në të.

Megjithatë, dialogu duhet të shihet si një rrugëtim i përbashkët i Kosovës dhe Serbisë drejt integritit të plotë të të dy vendeve në strukturat evropiane. Në Serbi, dialogu ndikoi që çështja e ndjeshme e Kosovës të mund të flitet në publik, dhe që mundësitë e ndryshme të ofruara për zgjidhje të mos jenë tabu.²⁴⁴ Prandaj, si mangësi mund të konsiderohet edhe fokusi publik vetëm në rezultatet “e prekshme” të procesit, duke neglizhuar kështu qëllimin madhor të këtij procesi, së paku të deklaruar nga të dy shtetet.

Qasja e “ambivalencës konstruktive”, ani pse në fillim të procesit ju mundësoi grupeve punuese që përkundër dallimeve të mëdha dhe kundërthënive në qëndrimet e tyre, të gjejnë formulën e duhur për zgjidhjen e disa çështjeve praktike, mundësoi edhe interpretime të ndryshme të teksteve të dakorduara, me çka bëri dëm të madh në procesin e implementimit të tyre. Një qasje e tillë mundësoi edhe ri-shikim të vazhdueshëm të teksteve për të cilat të dy qeveritë fillimisht pajtoheshin. Çka rezultoi me takime shtesë për tema të njëjta dhe me “marrëveshje për marrëveshjet”, që edhe prezantoheshin si sukses, si marrëveshje shtesë, ndonëse në fakt ishin rezultat i mos-dedikimit të të dy grupeve në përmbushjen e marrëveshjeve paraprakisht të arritura. Prandaj, nëse dykuptimësia ka qenë e nevojshme për të filluar procesin, ajo nuk duhet të vazhdojë tutje dhe aq më pak në fazat e implementimit të marrëveshjeve të arritura.

²⁴⁴ Nga Paneli “Pikëpamjet mbi marrëveshjet e dialogut teknik në mes të Kosovës dhe Serbisë”, organizuar nga KSPAG, Prishtinë, 21 shkurt 2020

SHTOJCAT

1. RRUGËTIMI I PROCESIT TË DIALOGUT TË BRUKSELIT
2. INTEGRIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR I KOSOVËS GJATË PROCESIT TË DIALOGUT
3. NIVELI I IMPLEMENTIMIT TË MARRËVESHJEVE
4. TEKSTET E MARRËVESHJEVE TË DIALOGUT TEKNIK SIPAS QEVERISË

1. RRUGËTIMI I PROCESIT TË DIALOGUT TË BRUKSELIT

2008	17.02	Kosova shpalli pavarësinë
	15.08	Serbia kërkon mendimin e GjND për ligjshmërinë e kësaj
2010	22.07	GjND deklaroi pajtueshërinë e aktit me të Drejtën Ndërkombëtare
	09.09	OKB miratoi Rezolutën për fillimin e dialogut teknik
2011	24.02	Edita Tahiri zgjedhet udhëheqëse e delegacionit të Kosovës për Dialog
	25.02	Robert Cooper takon qeveritë e Kosovës dhe Serbisë, për fillimin e dialogut
	07.03	Rezoluta e Kuvendit të Kosovës në mbështetje të dialogut teknik me Serbinë
	8,9.03	<i>RUNDI 1 i dialogut teknik; regjistri civil, kadastra, CEFTA, vulat doganore</i>
	16.03	Robert Cooper takon në Prishtinë dhe Beograd, përfaqësuesit e të dy vendeve
	28.03	<i>RUNDI 2. energjia, telekomunikacioni, regjistri civil, kadastrat</i>
	15.04	<i>RUNDI 3. lëvizja e lirë, diplomat, energjia, telekom, regjistri civil, kadastrat, vula doganore</i>
	12.05	Borko Stefanoviç, udhëheqës i ekipit të Serbisë, përfaqësuesi i parë i Serbisë që takon qeverinë e Kosovës, në institucionet e saj
	17,18.05	<i>RUNDI 4. të pagjeturit, trashëgimia kulturore dhe njohja e diplomave</i>
	2.07	RUNDI 5. Marrëveshje për: Lëvizjen e lirë, Njohjen e diplomave, Regjistrin civil
	19.07	RUNDI 6 – anulohet. Serbia nuk pranon vulat e doganave të Kosovës
	20.07	Qeveria e Kosovës vendos reciprocitet, duke mos njohur vulat e doganave të Serbisë dhe BiH
	25.07	Qeveria e Kosovës aksionin për marrje nën kontrollë të pikave kufitare 1, 31
	02.09	Marrëveshja për dosjet kadastrale dhe njohje reciproke të vulave doganore
	16.09	Fillon në praktikë zbatimin e marrëveshjes për vulat doganore
21,22.11	RUNDI 4. IBM, <i>bashkëpunim rajonal, telekom, energji</i> . Marrëveshja për njohje të diplomave	
02.12	Arrihet marrëveshja për <i>Menaxhimin e Integruar të Kufirit</i> , IBM	
07.12	Fillon procesi i certifikimit të librave të gjendjes civile	
26.12	Fillon zbatimin e marrëveshjes për lëvizjen e lirë	
2012	04.01	Nënshkruhet plani aksional i IBM
	24.02	Marrëveshja për bashkëpunim dhe përfaqësim rajonal. Protokollin teknik për zbatimin e IBM
	29.02	Qeveria e Kosovës miraton protokollin teknik të IBM
	17.10	Rezoluta e Kuvendit për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë
	20.10	Fillon dialogu politik, takohen Kryeministrat Thaçi e Daçiç. Ndërmjetës, Baronessa Ashton
	7.11	Mbahet takimi i dytë në mes të kryeministrave
	10.12	Fillon zbatimin e marrëveshjes për IBM në Jarinjë dhe Mërdare
	31.12	Fillon zbatimin e IBM edhe në Bërnjak, Mutivodë, Dheu i Bardhë dhe Muçibabë

2013	9.01	Marrëveshja për Ndhimën e ndërsjelle juridike në kuadër të IBM
	17.01	Fondi për zhvillim të komunave veriore, mbledhje të hyrave dhe licencim të kompanive në veri
	24.01	Marrëveshja për këmbimin e informatave përmes sistemit SEED
	19.04	Arrihet <i>Marrëveshja e parë për normalizimin e marrëdhënieve</i> në mes të kryeministrave
	25.04	Takimi i parë i grupit trepalësh për zbatimin e marrëveshjes së IMB
	21.05	Nënshkruhet nga kryeministrat <i>Plani për zbatimin e marrëveshjes për normalizim</i>
	30, 31.05	Takimi i parë për zbatimin e Marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve.
	11.07	Parlamenti i Kosovës miraton <i>Ligjin për amnistinë</i>
	05.09	Njohja reciproke e çertifikatave fito-sanitare
	8.09	Arrihen marrëveshjet për energjinë dhe telekomunikacionin
	3.11	Mbahen zgjedhjet lokale, përfshi katër komunat më shumicë serbe në veri
5.11	Konkluzionet e përbashkëta për fillimin e zbatimit të marrëveshjes për mbledhjen e të hyrave doganore në Jarinjë dhe Bërnjak	
2014	31.01	Përfundon procesi i integritit të policëve serbë në veri
	6.03	Kthehen nga Serbia kopjet e fundit të regjistrave të gjendjes civile
	18.06	Largohen barrikatadat në veri. Ajo mbi urën e Ibrit zëvendësohet me <i>“parkun e paqes”</i> .
	22.07	Konkluzionet për largimin e barrikadave dhe fillimin e revitalizimit të urës së Ibrit
	4.09	Nënshkruhet marrëveshja për ndërtesat e përhershme të IBM
	22.09	Aeroporti i Beogradit hapet transit për qytetarët e Kosovës, konform marrëveshjes
	14.11	Arrihet marrëveshja për administrimin e vizitave zyrtare
15.11	Marrëveshja për lirinë e lëvizjes edhe për Aeroportin e Nishit dhe pikëkalimet me Kroaci, Hungari, Maqedoni, Bullgari	
2015	9.02	Arrihet marrëveshja për drejtësinë
	26.03	Arrihet marrëveshja për shuarjen e <i>“Mbrojtjes civile”</i> në veri dhe integrimin e pjesëtarëve të saj
	5.05	Arrihet marrëveshja për njohjen reciproke të Certifikatave Farmaceutike
	22.05	Arrihet dakordimi për hapjen e dy pikëllimeve të reja (Kapi dhe Izvor)
	17.06	Fillojnë takimet e grupeve punuese për planin e zbatimit të ASK
	23.06	Marrëveshja për Njohje reciproke të Sigurimit TPL dhe ajo për procesim dhe pagesë të kërkesave
	10.08	Arrihet marrëveshja për njohjen reciproke të sigurimeve të automjeteve
	25.08	Dakordim për planin e zbatimit të marrëveshjeve për energji, telekom, elementet e ASK dhe dizajni për revitalizim të urës së Ibrit
2016	19.04	Arrihet marrëveshja për njohjen reciproke të çertifikatave ADR
	5.08	Arrihet dakordimi për planin e revitalizimit të urës së Ibrit
	14.09	Arrihet dakordimi për avancimin e marrëveshjes së lirisë së lëvizjes
	15.12	Kosova e merr kodin telefonik ndërkombëtar +383
2017	10.01	Institucionet e drejtësisë së Kosovës vendosen në komunat veriore
2020	20.01	Arrihet marrëveshja për hapja e linjës direkte ajrore Prishtinë – Beograd dhe anasjelltas
2020	14.02	Arrihet marrëveshja për Vendosijen e një korridorit hekurudhor mes Prishtinës dhe Beogradit
2020	20.04	Miratohet marrëveshja për operimin e KOSTT si zonë e pavarur rregulluese brenda ENTSO-E
2020	16.07	Takimi i parë i drejtëpërdrejtë i përfaqësuesëve të Kosovës dhe Serbisë në kuadër të dialogut të Brukselit pas më shumë se 20 muajsh.

2. INTEGRIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR I KOSOVËS GJATË PROCESIT TË DIALOGUT

NR.	ORGANIZATA	MISIONI	KOMENT
1.	Central European Free Trade Agreement, CEFTA	(2006) marrëveshje tregtare mes shteteve në proces integrues, si fazë përgatitore për anëtarësim në BE	UNMIK, në emër të Kosovës
2.	Vienna Economic Forum, VEF	(2004) promovon bashkëpunimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve në vendet nga Deti Adriatik në Detin e Zi	
3.	Brdo Process	Fuqizimi i raporteve ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e integruese. Mbledh liderët kryesor të shteteve anëtarë, me të ftuar liderët e BE dhe SHBA-së	
4.	Western Balkans Investment Framework, WBIF	(2009) strukturë rajonale që mbështet integrimin dhe zhvillimin socio-ekonomik në rajon	
5.	Energy Community – EnC	Organizatë ndërkombëtare që përfshinë BE-në dhe fqinjët e saj për të krijuar një treg energjetik të integruar Pan-Evropian.	
6.	European Association of Public Service Media in SEE	Protokoll mbi Bashkëpunimin Rajonal në Edukim dhe Trajnim ndërmjet anëtarëve të Asociacionit të Shërbimeve Mediale Publike në Evropën Juglindore	
7.	South East Europe Investment Committee, SEEIC (Në kuadër të RCC)	Synon të jetë trup koordinues me mandat të inicijojë e përkrahë reformat dhe implementimin e politikave që promovojnë investimet e brendshme e të jashtme në Evropën Juglindore	Kosova vëzhguese
8.	Regional Rural Development Standing Working Group of South East Europe, SWG	Organizatë Ndërkombëtare Ndër-qeveritare, mbledhë institucionet përgjegjëse për zhvillim rural në shtetet dhe rajonet respektive.	
9.	SEE Trade Union Forum, SEETUF	Promovon dimensionin social të reformave ekonomike në rajon	
10.	Electronic South Eastern Europe Initiative – eSEE + bSEE Task Force (Në kuadër të RCC)	eSEE Initiative dhe bSEE Task Force operojnë nën ombrellën e RCC-së dhe kanë synim promovimin e një tregu të vetëm, të hapur dhe kompetitiv rajonal të teknologjisë informative dhe të komunikimit	UNMIK, në emër të Kosovës
11.	Energy Community Secretariat	Institucion permanent përgjegjës për mbështetjen ditore të aktiviteteve të Komunitetit të Energjisë dhe monitorimin e implementimit të Traktatit	
12.	South East Europe Transport Observatory - SEETO	Organizatë rajonale e transportit për promovimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit infrastrukturor.	Kosova + UNMIK-u - KE – DGMOVE
13.	Network of Associations of Local Authorities of SEE, NALAS	Rrjet i asociacioneve të autoriteteve lokale të Evropës Juglindore, me 16 Asociacione, rreth 9000 autoritete lokale.	
14.	South East European Public Privat Partnership Network, SEPPPN	(2009) Koordinimi rajonal i shkëmbimit të ekspertizave rreth PPP-ve dhe avancimi i ambientit dhe masave për zhvillimin e PPP-ve në rajon.	
15.	US – Adriatic Charter (A5)	Asociacion i formuar fillimisht nga Shqipëria, Kroacia e Maqedonia me SHBA-të, me synim të ofrimit të përkrahjes në përpjekjet e tyre për t'u anëtarësuar në NATO.	Vëzhgues: Serbia, Kosova, Sllovenia
16.	Education Reform Initiative of South Eastern Europe - ERI SEE	Platformë rajonale për bashkëpunim në fushën e edukimit dhe trajnimeve.	Vëzhgues: Kosova, Bullgaria, Rumania

17.	RCC Task Force Fostering and Building Human Capital - TF FBHC	<i>Promovimi i koherencës dhe koordinimit në fushën e edukimit dhe kërkimeve shkencore në Evropën Juglindore duke krijuar një platformë për dialog dhe bashkëpunim të aktorëve të involvuar në këta sektorë.</i>	
18.	South East European Center for Entrepreneurial Learning – SEECCL	<i>Të mësuarit e sipërmarrjes si një kompetencë kryesore, në linjë me politikat dhe praktikën e BE-së.</i>	
19.	Regional Environmental Network for Accession – RENA	<i>Rritja e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi në fushën e ambientit në kuadër të perspektivës së anëtarësimit në BE.</i>	
20.	The Implementation of Single European Sky in South East Europe Programme - ISISECAA	<i>Iniciativë e Komisionit Evropian që synon të reformojë sistemin evropian të menaxhimit të trafikut ajror.</i>	Përfundoi më 2017
21.	(OECD) Investment Compact for SEE	<i>Përkrahja e qeverive të rajonit për përmirësimin e klimës investuese dhe fuqizimin e zhvillimit të sektorit privat.</i>	Kosova, vëzhguese
22.	Regional Cooperation Council – RCC	<i>Kornizë gjithëpërfshirëse rajonale e bashkëpunimit mes vendeve të Evropës Juglindore, komunitetit ndërkombëtar dhe donatorëve që përkrahin integrimin evropian dhe euroatlantik të rajonit.</i>	
23.	Regional School of Public Administration - ReSPA	<i>Organizatë ndërkombëtare me synim avancimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e Administratës Publike në Ballkanin Perëndimor.</i>	Kosova, në proces aderimi
24.	South-East European Cooperation Process - SEECP	<i>Forum për dialog diplomatik dhe politik.</i>	
25.	Berlin Process - WB6	<i>Avancimi i proceseve integruese në Ballkanin Perëndimor. Janë mbajtur katër samite të nivelit të lartë, samiti i radhës mbahet në Londër. RYCO dhe TCT janë rezultat i marrëveshjeve të deritashme. Aktualisht, po shqyrtohet krijimi i Regional Economic Area, për çka është aprovuar edhe Multi-annual Action Plan (MAP)</i>	
26.	Centre for Security Cooperation – RACVIAC	<i>Ka për synim ofrimin e trajnimeve për kontroll të armëve, promovimin e besimit, ndërtimin e masave të sigurisë dhe zgjerimin e bashkëpunimit në Evropën Juglindore.</i>	Kosova e ftuar për Pjesëmarrje
27.	Migration, Asylum, Refugees Regional Initiative - MARRI	<i>Promovimi i bashkëpunimit rajonal dhe qasjes gjithëpërfshirëse e të harmonizuara të në fushat e: migrimit, azilit, kontrolleve kufitare, regjimit të vizave, integritetit dhe kthimit të refugjatëve.</i>	
28.	Western Balkans Research and Innovation Centre - WISE	<i>Mbështetje për fuqizimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, duke përmirësuar klimën e Ballkanit Perëndimor për hulumtim dhe inovacion.</i>	

29.	Western Balkans Fund – WBF	<i>Shtytja e bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve, forcimi i relacioneve dhe kohezionit rajonal, për të avancuar integrimin në BE.</i>	
30.	Regional Youth Cooperation Office - RYCO	<i>Mekanizëm institucional që funksionon në mënyrë të pavarur, i themeluar nga pjesëmarrësit e WB6 për promovimin e ripajtimit dhe bashkëpunimit ndërmjet të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimeve.</i>	
31.	Transport Community Treaty – TCT	<i>Integrim më i thellë i Ballkanit Perëndimor në tregun e transportit të BE-së drejt standardeve të përbashkëta, rrjetit të efqencës dhe kualitetit të shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe bizneset</i>	
32.	South East European International Institute for Sustainable Technologies	<i>Bashkëpunim në fushën e shkencës, teknologjisë dhe industrisë, përkatesisht trajnimin e talenteve të rinjve të bazuar në transferimin e njohurive dhe teknologjisë nga qendrat evropiane.</i>	
33.	Regional Environmental Centre For Southern And Central Europe - REC	<i>Projekte të fokusuara në qeverisjen mjedisore, ekonominë me nivel të ulët karboni, përshtatshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, menaxhimin e burimeve natyrore dhe ruajtjen e mjedisit.</i>	
34.	Business Advisory Council for South Eastern Europe - BACSEE	<i>Grup këshillëdhënës i përbërë nga 35 investitorë ndërkombëtarë dhe përfaqësues biznesesh nga më shumë se 20 vende.</i>	
35.	Steering Platform for Research in Western Balkans - WBC-RTI	<i>Avancimi i integritit të Ballkanit Perëndimor në Zonën e Kërkimeve Evropiane në kuadër të perspektivës anëtarësuese në BE</i>	
36.	WB6 Advocacy Group	<i>Iniciativë e think tank-ave të Ballkanit Perëndimor me synim të lehtësimit dhe ndihmës së zgjerimit të Bashkimit Evropian drejt Ballkanit Perëndimor.</i>	
37.	South East Europe Regional Council - International Council on Large Electric Systems – SEERC CIGRE	<i>CIGRE është një organizatë ndërkombëtare jo fitim-prurëse për promovimin e bashkëpunimit në mes të ekspertëve nga e gjithë bota, për të ndarë përvojat, bashkuar forcat dhe shkëmbyer njohuritë për të përmirësuar sistemet elektrike.</i>	
38.	Police Cooperation Convention for Southeast Europe - PCC SEE	<i>Konventa parashikon forma moderne të bashkëpunimit midis palëve kontraktuese, siç janë analiza e përbashkët e kërcënimeve, zyrtarët e ndërlidhjes, ndjekja e shpejtë, mbrojtja e dëshmitarëve, vëzhgimi ndërkufitar, dorëzimi i kontrolluar, hetimet e fshehta kundër krimeve dhe për të parandaluar veprat penale...</i>	Kosova merr pjesë si “E ftuar” (Guest)
39.	Cetinje Parliamentary Forum - CPA	<i>Iniciativë rajonale e bashkëpunimit parlamentar në Evropën Juglindore në rrugën drejt BE-së</i>	

3. NIVELI I IMPLEMENTIMIT TË MARRËVESHJEVE

MARRËVESHJET E DIALOGUT TEKNIK		IMPLEMENTIMI
1.	LIRIA E LËVIZJES, 2 korrik 2011	
2.	REGJISTRI CIVIL (LIBRAT AMZË), 2 korrik 2011	
3.	NJOHJA RECIPROKE E DIPLOMAVE UNIVERSITARE, 2 korrik 2011	
4.	SHËNIMET KADASTRALE, 2 korrik 2011	
5.	VULAT DOGANORE, 2 shtator 2011	
6.	MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT (IBM), 2 Dhjetor 2011	
7.	PËRFAQËSIMI DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL, 24 shkurt 2012	
8.	MBLEDHJA E TË HYRAVE DOGANORE, 17 janar 2013	
9.	ENERGJIA, 8 SHTATOR 2013	
10.	TELEKOMUNIKACIONI, 15 dhjetor 2016	
11.	NJOHJA RECIPROKE E POLICAVE (SIGURIMEVE) TË AUTOMJETEVE, 23 qershor 2015	
12.	ÇERTIFIKATAT ADR, 19 prill 2016	
13.	REVITALIZIMI DHE HAPJA PËR LËVIZJE E URËS NË MITROVICË, 5 gusht 2016	
ARANZHIMET E DALA NGA MARRËVESHJA PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE		
14.	ZGJEDHJET LOKALE/ FUNKSIONIMI I KATËR KOMUNAVE NË VERI, 2013	
15.	ZYRTARËT NDËRLIDHËS, 31 maj 2013	
16.	INTEGRIMI I POLICISË, SHPËRBËRJA E MUP, 31 dhjetor 2013	
17.	SHPËRBËRJA DHE INTEGRIMI I 'MBROJTJES CIVILE', 26 mars 2015	
18.	DREJTËSIA, 9 shkurt 2015	
19.	ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE, 25 gusht 2015	

4. TEKSTET E MARRËVESHJEVE TË DIALOGUT TEKNIK SIPAS QEVERISË

LIRIA E LËVIZJES, <i>Konkluzat e Dakorduara</i>	2 korrik 2011
<ol style="list-style-type: none"> 1. Qytetarët (me vendbanim të përhershëm) të të dyja palëve duhet të kenë mundësi të udhëtojnë lirshëm brenda ose përmes territorit të njëra-tjetrës. 2. Secila palë do të zbatojë, sa më shpejt që është e zbatueshme në aspekt operativ, një sistem të kalimit të kufirit/kufirit administrativ të qytetarëve të palës tjetër me letërnjoftime; 3. Secila palë mund të zbatojë një sistem ku letërnjoftimet të shoqërohen nga dokumente me shkrim “hyrje-dalje” për personat nga pala tjetër të ciët dëshirojnë të kalojnë tranzit në një shtet të tretë. 4. Si zgjedhje kalimtare, secila palë do t’ua mundësojë qytetarëve të palës tjetër blerjen e polisave të sigurimit kufitar/kufitar administrative. Nën përkujdesjen e BE-së, palët do të vazhdojnë të punojnë për një marrëveshje komerciale për sigurimin reciprok të automjeteve ashtu që të gjitha automjetet në të dy anët e kufirit/kufirit administrativ të jenë të siguruar sa më shpejt që është e mundur. 5. Secila palë do të ndërmarrë të gjitha masat që t’ua mundësojë qytetarëve të palës tjetër të udhëtojnë lirshëm brenda dhe përmes territorit të njëra-tjetrës me patent shoferin e lëshuar nga autoritetet e veta. 6. Si masë kalimtare, autoritetet në Kosovë do të vazhdojnë vlefshmërinë e targave KS të automjeteve për një periudhë fillestare prej pesë vitesh, në përfundim të së cilës çështja do të rishikohet nga të dyja palët (me lehtësimin e BE-së nëse kërkohet); 7. Të gjithë pronarët e automjeteve me vendbanim në Kosovë do të përdorin tarfat RKS ose KS (sipas pikës 6 më lartë). Ato do të lëshohen nga autoritetet përkatëse në Kosovë dhe do të shpërndahen me ndihmën e EULEX-it kudo që kërkohet. Secila palë do të bëjë përpjekje maksimale për të implementuar si më lartë. 8. Si masë e përkohshme, autoritetet në Beograd do t’ua mundësojnë automjeteve nga Kosova që bartin targat KS të qarkullojnë lirshëm në dhe përmes territorit të saj; 9. Si masë kalimtare, për cilindo pronar automjetesh që dëshiron, do të vihen në dispozicion targa të përkohshme, në pikëkalimet kufitare/kufitare administrative. 10. Përkritazi me riatdhesimin dhe duke marrë parasysh obligimet e Prishtinës në këtë fushë, pikat e marrëveshjeve më lartë nuk do të krijojnë obligime për palën e Beogradit për të pranuar kërkesat për ripranim për personat me dokumente të Kosovës në kuadër të marrëveshjes ekzistuese për ripranim ndërmjet Serbisë dhe BE-së 11. Një grup implementues, i kryesuar nga BE, do të formohet për të siguruar që marrëveshjet e lartëpërmendura , së bashku me pika të tjera përcjellëse, të zbatohen sa më shpejt që është e mundur nga aspekti operativ, pika 7 do të zbatohet nga 1 nëntori 2011. 	
<p>ⁱ Të gjitha dokumentet hyrje-dalje do të përbajnë gjuhë neutrale</p>	

KONKLUZIONET PËRFUNDIMTARE OPERATIVE, GRUPI IMPLEMENTUES PËR LIRINË E LËVIZJES	29 nëntor 2011
<ol style="list-style-type: none"> 1. Konkluzionet operative të dialogut për lirinë e lëvizjes të datës 2 korrik 2011 janë zbatuar në tërësi më 29 nëntor 2011; 2. Qytetarët e Kosovës që udhëtojnë në ose nëpër Serbi do të pajisen me dokument hyrje/dalje; 3. Qytetarët e Serbisë që udhëtojnë në ose nëpër Kosovë do të pajisen me dokument hyrje/dalje; 4. Dokumenti përfundimtar hyrje/dalje i secilës palë është i bashkëngjitur me këto konkluzione; 5. Pas kërkesës për konfirmim të identitetit, LNJ tregohet bashkë me këtë dokument hyrje/dalje; 6. Dokumenti hyrje/dalje quhet dokument hyrje/dalje. Gjuha në dokument hyrje/dalje do të jetë vetëm gjuhë procedurale: “dokumenti hyrje/dalje nuk bën të humbet dhe në rast të humbjes, personi gjegjës duhet t’i drejtohet stacionit më të afërt të policisë për t’u pajisur me vërtetim që ai/ajo ka humbur dokumentin hyrje/dalje etj”; 7. Dokumenti hyrje/dalje nuk do të përmbajë fotografi; 8. Të miturit që udhëtojnë me çertifikatë lindjeje do të pajisen me dokument të veçantë hyrje/dalje dhe duhet të sjellin një fotografi me vete për të siguruar sistemin nga trafikimi i fëmijëve; 9. Në fillim do të jenë të hapura dy vendkalime, një mes Serbisë dhe Hungarisë (Horgosh) dhe një mes Serbisë dhe Kroacisë (Batrovci) për hyrje/dalje nga Serbia. Gradualisht, më vonë do të hapën të gjitha vendkalimet e tjera. 10. Në fillim do të hapen portat 1, 3 dhe 5. Gradualisht, më vonë do të hapën të gjitha vendkalimet e tjera. 11. Duke marrë parasysh konkluzionet për MIK, palët janë pajtuar që të shikojnë periudhën tranzicionale për zbatimin e pikës 7 për tabelat e regjistrimit në konkluzionet operative për lirinë e lëvizjes në dritën e situatës në terren; 12. Automjetet me tabela regjistrimi KS do të mund të udhëtojnë në/nëpër Serbi; 13. Secila palë do të vendosë skemë të sigurimit në kufi/në vijë administrative. Çmimi i sigurimit do të jetë në pajtim me çmimoren e sigurimit të aplikueshëm në vijë kufitare , i cili aktualisht si kohë më të shkurtë parasheh periudhën një-muajshe në palën e Beogradit. Pala e Beogradit do të bëjë çdo përpjekje për të vendosur polica më të lira sigurimi për periudha më të shkurta brenda javësh; 14. Njëkohësisht, palët, nën kujdesin e BE/Këshillit të Byrove, do të vazhdojnë të punojnë në gjetjen e aranzhimeve komerciale për mbulimin e ndërsjellë të sigurimit të automjeteve ashtu që të gjitha automjetet të jenë të mbuluara në dy anët e kufirit/të vijës administrative sa më shpejtë të jetë e mundur; 15. Tabelat e regjistrimit të automjeteve me RKS do të zëvendësohen me tabela të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve në palën e Serbisë. Sa më shpejtë të jetë e mundur operacionalisht, do të zbatohet një taksë e zbritur për tabela të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve. Pala e Kosovës do të zbatojë njëjtën taksë; 16. Pala e Kosovës rezervon të drejtën që, pas konsultimeve me BE-në, gjithashtu të zbatojë regjimin e tabelave të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve; 17. Në fillim, do të përdoren tabela të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve ashtu siç janë; 18. Beogradi dhe Prishtina janë zotuar të punojnë për aplikimin e tabelave “neutrale” të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve sa më shpejtë që të jetë operacionalisht e realizueshme. 	

ARANZHIMET LIDHUR ME FINALIZIMIN E ZBATIMIT TË MARRËVESHJES PËR LËVIZJEN E LIRË TË VITIT 2011**14 shtator 2016**

1. Palët janë pajtuar që të mbulohen pjesët relevante të tabelave respektive të automjeteve me dy letër ngjitëse të bardha.
2. Ky sistem me letër ngjitëse do të hyjë në fuqi me 15 nëntor 2016.
3. Infrastruktura administrative për lëshimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e automjeteve me tabela të lëshuara nga autoritetet e Kosovës do të hyjë në fuqi në nëntor 2016.
4. Regjistrimi i të gjitha automjeteve me tabelat e lëshuara nga autoritetet e Kosovës (KS/RKS) do të fillojë më 15 janar 2017 dhe do të zgjasë për 12 muaj. Në fund të së cilës periudhë do të ketë vlerësim nga të dy palët me ndërmjetësimin e BE-së.
5. Kosova do të zgjasë validitetin e tabelave KS për pesë vite në fund të kësaj periudhe kohore, çështja do të shqyrtohet nga të dyja palët (me ndihmën e BE-së nëse një gjë e tillë kërkohet).
6. Përjashtimet nga taksat dhe detyrimet për regjistrimin e automjeteve do të garantohet nga Kosova në të njëjtën mënyrë sikurse në rastin e kaluar. Bashkëpunim i ngushtë dhe i shpejtë do të vendoset në mes të dyja palëve për të verifikuar pronësinë e automjetit.
7. Një fushatë informuese për t'ua shpjeguar banorëve të afektuar modalitetet për regjistrim të automjeteve do të ndërmerret nga të dy palët dhe BE-ja. Diskutimet e mëtejshme mbi fushëveprimin dhe modalitetet e fushatës së lartpërmendur do të diskutohen në grupin për zbatim.
8. Tabelat e veturave që preken nga procesi i regjistrimit nuk do të afektohen nga sistemi i letër ngjitëseve.
9. Për shkak të ndjeshmërisë ndërlidhur më pikat e lartpërmendura, palët janë pajtuar të vlerësojnë zbatimin e këtyre konkluzioneve në intervale të rregullta.

LIBRAT AMZË, Konkluzat e Dakorduara**2 korrik 2011**

1. Palët, bashkërisht, do të bëjnë krejt çka është e mundur, për të krijuar një regjistër civil plotësisht të besueshëm në Kosovë;
2. Do të formohet një "komitet i përbashkët" trepalësh i përbërë nga ekspertë të regjistrimit civil nga të dy palët dhe EULEX-i. Ky i fundit vepron si kryesues, për të identifikuar zbrastësit në librat amzë origjinal të para vitit 1999 të cilat mungojnë;
3. EULEX-i do t'i vërtetojë kopjet e librave amzë nga Kosova, komunë pas komune, në konsultim me ekspertët nga të dyja palët sipas nevojës; EULEX-i do t'i procesojë kopjet e vërtetuara me qëllim që në Kosovë të vendoset një regjistër plotësisht i besueshëm.
4. Sipas kërkesës, EULEX-i do të jetë i gatshëm të ofrojë informata të caktuara sipas nevojës.

PRANIMI I DIPLOMAVE UNIVERSITARE, Konkluzionet e Dakorduara**2 korrik 2011****2 KORRIK 2011**

1. Në përputhje me praktikën më të mira evropiane, studentët duhet të kenë qasje në progrmet arsimore dhe në mundësi punësimi në tërë rajonin për të shfrytëzuar si është më së miri shkathtësitë dhe talentet e tyre.
2. Të dy palët janë pajtuar në parim që të zgjidhin çështjen e pranimit të diplomave universitare përmes një trupi ndër-kombëtar të dakorduar reciprokisht ose përmes një institucioni akademik të palës së tretë.
3. Detajet do të finalizohen në takimin e radhës së Dialogut.

21 NËNTOR 2011

1. Në bazë të konkluzioneve operacionale të 2 korrikut 2011 për pranimin e diplomave univrsitare, palët bien dakord që të kërkojnë nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane që të bëjnë certifikimin e diplomave universitare të lëshuara nga secili universitet, që të përdoren nga tjetri në lidhje me edukimin e mëtejshëm dhe/ose punësimet pubike;
2. Gjatë verifikimit të diplomave universitare të lëshuara nga institucionet e autorizuara në përputhje me praktikën më të mira Evropiane, certifikimi do të bëhet nga një Komitet i ekspertëve akademik evropian, themeluar nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane;
3. Shtojcave të Diplomave dhe transkripti i të dhënave që u prezantuan gjatë Dialogut, dhe konkluzionet do t'i bashkëngjiten diplomës universitare. Ajo do të jetë për autoritetet e secilës palë për të vendosur se cili nga dokumentet janë të vlefshme për këtë proces, me kusht që efekti të jetë pranimi i kualifikimit i prezantuar nga diploma;
4. BE-ja do të bëjë çdo për të siguruar zbatimin e konkluzioneve të mësipërme nga 1 Janari 2012.

KONKLuzionet mbi njohjen reciproke të diplomave bazuar në marrëveshjen origjinale të vitit 2011	19 janar 2016
<ol style="list-style-type: none"> 1. Duke qenë në dijeni për progresin e kufizuar që është arritur në zbatimin e Marrëveshjes së vitit 2011 mbi njohjen reciproke të diplomave, Palët u pajtuan që prap të përpqihen dhe të ndërtojnë mbi përvojat e deritanishme me qëllim që të tejkalohen sfidat dhe të thjeshtësohen proceset.. 2. Palët u pajtuan që të zbatojnë marrëveshjen për diplomat pas certifikimit nga EUA. Njohja do të ndahet në njohje profesionale dhe akademike. Njohja profesionale do të realizohet nga organet përkatëse qeveritare, brenda afatit maksimal prej 90 ditëve pas pranimit të aplikacionit dhe me një tarifë maksimum 50 euro ose ndonjë shumë ekuivalente. Njohja profesionale do të konsiderohet e pranueshme për mundësitë e punësimit, përfshirë edhe për punësimin në organet qeveritare. Njohja akademike nevojitet vetëm për vazhdimin e studimeve; procedurat do të varen nga secili institucion i arsimit të lartë veç e veç, dhe do të ketë një afat të përgjithshëm prej 5 muajsh. 3. Të gjitha certifikatat e EUA të marra më parë do të njihen nga Palët dhe diplomat e certifikuar nga EUA do të mund të dorëzohen direkt për njohje. Të gjitha njohjet e mëparshme të diplomave do të konsiderohen si të vlefshme. Partneri zbatues do t'iu ofrojë informacionet Palëve lidhur me natyrën e kërkesës së aplikuesëve (profesionale ose akademike) brenda një periudhe maksimum prej dy muajsh. Për më tepër, palët u pajtuan të shkëmbejnë të gjitha informacionet relevante për procedurat e kërkuara, përfshirë shpenzimet e tarifës, deri në fund të muajit shkurtit të vitit 2016. Palët bien dakord që të gjitha diplomat EUA të certifikuar më parë dhe të dorëzuara për njohje do të fillojnë të procesohen duke filluar nga 4 prill 2016 dhe procedurat e njohjes do të përfundojnë në përputhje me afatet e përcaktuara në konkluzionet nga janari 2016. 4. Marrëveshja mbi diplomat dhe këto konkluzione vlejën vetëm për institucionet dhe programet e akredituara të arsimit të lartë nga organet përkatëse të Palëve, respektivisht Beogradit dhe Prishtinës. Palët do të shkëmbejnë listën e Institucioneve të akredituara të Arsimit të Lartë, deri në fund të muajit shkurt të vitit 2016. 5. Palët u pajtuan që kjo procedurë të zbatohet tek nivelet e arsimit: Bachelor, Master dhe PhD. Palët u pajtuan gjithashtu që të njohin diplomat e arsimit fillor, të mesëm, profesional dhe nivelin e pestë të kualifikimit sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (EQF), ndërsa modalitetet e zbatimit do të diskutohen në takimin e radhës 6. Bazuar në atë që u tha më lartë, Palët u pajtuan që të fillojë faza e dytë e projektit original. 7. BE-ja do të krijojë një grup zbatues trepalësh deri në fund të muajit shkurt të vitit 2016, për monitorimin e zbatimit të këtyre dakordimeve dhe konkluzioneve. 8. Zbatimi i marrëveshjes mbi Njohjen Reciproke të Diplomave nga të dyja Palët do të rinis me 1 mars 2016. 	
KONKLuzion Operacional i Grupit Punues për Diplomat	21 mars 2016
<ol style="list-style-type: none"> 1. Palët informuan njëra-tjetrën për procedurat e tyre përkatëse për njohjen e diplomave të Institucionit të Arsimit të Lartë për përdorim profesional dhe akademik, diplomat për shkolla fillore, të mesme dhe trajnime profesionale dhe për diploma të nivelit të pestë të kualifikimit, sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK) dhe për doktoraturë (PhD). 2. Palët bien dakord të respektojnë plotësisht afatet / tarifat e përcaktuara në konkluzionet e janarit 2016 3. Palët bien dakord që të gjitha diplomat EUA të certifikuar më parë dhe të dorëzuara për njohje do të fillojnë të procesohen duke filluar nga 4 prill 2016 dhe procedurat e njohjes do të përfundojnë në përputhje me afatet e përcaktuara në konkluzionet nga janari 2016. 4. Palët kanë dorëzuar tek kryesuesi i BE-së listën përkatëse të Institucioneve të akredituara të Arsimit të Lartë. Kryesuesi i BE-së do t'i ndajë ato me palët 5. BE-ja do të ecë përpara me projekt(e) për të zgjedhur partnerët implementues (për certifikim dhe qëllime administrative) dhe do t'i mbajë palët të informuara për progresin. 6. Në ndërkohë, ministritë përkatëse nga palët do të mbledhin aplikacionet për njohjen e diplomave duke filluar nga 4 prilli 2016 dhe do t'i dorëzojnë ato tek partnerët implementues/administrativ të zgjedhur më herët. Palët do t'i dërgojnë e-mail adresat relevante sa më herët që është e mundur. BE-ja do të lëshojë një komunikata për shtyp përmes përfaqësive të tyre në Beograd dhe Prishtinë, për të informuar opinionin. Palët ranë dakord për Termat e Referencës në vijim të Grupit Trepalësh për Implementimin GTI: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Grupi aktual i punës për diplomat do të veprojë si GTI. ▪ GTI do të kryesohet nga BE-ja dhe do të takohet së paku dy herë në vit ose më shpesh me kërkesë të palëve. ▪ GTI do të monitorojë zbatimin e marrëveshjeve mbi diplomat dhe konkluzionet mbi njohjen e ndërsjellë të diplomave në bazë të marrëveshjeve origjinale nga viti 2011. ▪ Partneri implementues/administrativ, në bashkëpunim me ministritë përkatëse nga të dyja palët do të raportojë rregullisht në GTI në lidhje me numrin e aplikacioneve për njohje të dorëzuara, certifikuar, të dhëna dhe të refuzuara, me arsyet për refuzim, të paktën çdo gjashtë muaj ▪ GTI do të ketë të drejtë të kërkojë informata në lidhje me rastet e kontestuara. <p>GTI mund të propozojë masa për të zgjidhur mosmarrëveshjet e mundshme në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve dhe konkluzionet / mund të sugjerojnë mjetet adekuate.</p>	

UDHËZUESI I BE-SË PËR NJOHJEN RECIPROKE TË DIPLOMAVE NË BAZË TË MARRËVESHJES FILLESTARE TË VITIT 2011

4 prill 2016

Në kontekst të dialogut të lehtësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, të dyja palët kanë rikonfirmuar që do të zbatojnë marrëveshjen për pranimin reciprok të diplomave profesionale dhe akademike.

Diplomat fillimisht do të vërtetohen nga një organizatë e përzgjedhur nga BE. Pas këtij vërtetimi mund të dorëzohet aplikacioni për njohje tek institucionet përkatëse të secilës palë. Njohja do të ndahet në pjesën profesionale dhe akademike.

Njohja profesionale do të bëhet nga organet qeveritare përkatëse, brenda një maksimumi kohor prej 90 ditësh pas pranimit të aplikacionit dhe me një tarifë e cila është e barabartë me 50 euro ose ndonjë shumë të barabartë me të. Njohja profesionale do të konsiderohet e mjaftueshme për mundësi punësimi, përfshirë këtu edhe në organet qeveritare.

Njohja akademike do të nevojitet për vazhdimin e studimeve; procedurat do të varen nga institucioni i caktuar i arsimit të lartë dhe do të ketë një afat të përgjithshëm prej pesë muajsh.

Të gjitha certifikatat që janë marrë më herët në EUA do të njihen nga të dyja palët. Diplomat e vërtetuara tashmë nga EUA mund të dorëzohen direkt për njohje. Palët do t'i procesojnë ato që

nga 4 prilli 2016. Të gjitha njohjet e mëparshme të diplomave do të trajtohen të vlefshme.

Për më tepër, palët janë pajtuar të zgjerojnë fushëveprimin e marrëveshjes së vitit 2011, për të përfshirë edhe këto nivele arsimimi: arsimi i lartë (Bachelor, Master dhe PhD) dhe arsimi parauniversitar (fillestar, sekondar, edukimi profesional dhe niveli i pestë i kualifikimit sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimit).

Bashkimi Evropian do të vazhdojë të mbështesë këtë proces përmes financimit të një projekti që do të lehtësojë zbatimin e kësaj marrëveshjeje në fazën fillestare të certifikimit. Hollësitë për modalitetet e këtij projekti dhe partnerin(ët) e përzgjedhur implementues do të shpallen në një fazë më të vonshme.

Në ndërkohë, kërkohet që aplikuesit e interesuar t'u drejtohen ministrive përkatëse të arsimit për të dorëzuar aplikacionet e tyre.

Në Prishtinë, ju lutem kontaktoni:

Për njohjen e diplomave para-universitare:

Email: avni.rexha@rks-gov.net

Për njohjen akademike dhe profesionale,

Email: Qamile.sinanaj@ks-gov.net

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Web: www.masht-gov.net

Rr. Agim Ramadani, Kodi postar: 10000 Prishtinë, Kosovë

Në Beograd, ju lutem kontaktoni:

Për njohjen para-universitare, akademike dhe profesionale:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik

Email: diplomekim@mpn.gov.rs

Web: <http://www.mpn.gov.rs/>

Rr : 22-26 Nemanjina

11 000 Beograd

SHËNIMET KADASTRALE

2 shtator 2011

1. Me qëllim për të mbrojtur të drejtat e njerëzve me kërkesa legjitime mbi pronën, palët do të bëjnë çdo përpjekje për të vendosur një kadastrë plotësisht të besueshëm në Kosovë;
2. Një grup trepalësh, i përbërë nga ekspertë kadastral nga të dyja palët dhe i kryesuar nga BE, do të monitorojë punën e një agjencie teknike (të përzgjedhur pas konsultimeve me të dyja palët), roli i së cilës do të jetë të identifikojë zbrastësit në shënimet kadastrale origjinale të para vitit 1999;
3. Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE), do t'i marrë kopjet e të gjitha shënimeve origjinale kadastrale të cilat janë larguar nga Kosova. Sipas kërkesës, PSBE do të ofrojë të dhëna të caktuara nga Kosova.
4. Agjencia teknike, e lartpërmendur në pikën 2, do t'i krahasojë të gjitha kopjet e shënimeve kadastrale origjinale të pronës private¹ të para vitit 1999 me kadastrën e rikonstruktuar të Kosovës. Rastet kur krahasimi tregon se shënimet nuk përputhen do t'i përcillen nga grupi trepalësh, një mekanizmi gjyqësor në Kosovë. Ky mekanizëm gjyqësor do të përcaktojë përfundimisht se cilat shënime kadastrale janë të sakta.
5. Shkalla e parë e mekanizmit gjyqësor do të ushtrohet nga një komision i ekspertëve kadastral dhe pronësorë ndërkombëtarë dhe kosovarë. Shumica e ekspertëve do të emërohen nga PSBE, duke marrë parasysh interesat e të gjitha komuniteteve;
6. Gjykata Supreme e Kosovës do të veprojë si shkallë e dytë e apelit e mekanizmit gjyqësor. Vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës do të merren nga një kolegji në të cilën shumicën do t'a përbëjnë gjykatësit ndërkombëtarë dhe të njejtat do të jenë vendime përfundimtare dhe pa mundësi ankese;
7. Vendimet të cilat dalin nga mekanizmi gjyqësor i lartpërmendur do t'u kumtohen të gjitha palëve të interesuara. Agjencia Kadastrale e Kosovës do t'i zbatojë vendimet përfundimtare që dalin nga mekanizmi gjyqësor i lartpërmendur duke i futur ndryshimet e nevojshme në kadastrin e Kosovës;
8. Grupi trepalësh implementues do të monitorojë zbatimin dhe funksionimin e shpejtë të arranzhmaneve të lartpërmendura dhe do ta njoftojë rregullisht palët në IDialog lidhur me progresin.

1. Kjo do të përfshijë pronën private, private komerciale dhe dokumentacionin kadastral të pronës private të kshihës.

VULAT DOGANORE, <i>Konkluzionet e Dakorduara</i>	2 shtator 2011
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Palët do të bëjnë çdo përpjekje të mundshme për të siguruar qarkullimin e lirë të mallrave në përputhje me marrëveshjen e CEFTA-s; ▪ Vulat doganore me mbishkrimin ‘Dogana e Kosovës’, siç u është konfirmuar të gjitha palëve të CEFTA-s, do të pranohet; ▪ Të gjitha dokumentet dhe komunikimet përcjellëse gjithashtu do ta pasqyrojnë këtë formulim. 	

KONKLUZIONET PER LICENCIME DOGANORE TE IMPORTEVE	16 dhjetor 2014
<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbledhja e të gjitha institucioneve dhe kompanive relevante të Kosovës të regjistruara në katër komunat veriore që kanë nevojë për licenca për import të mallrave të kontrolluara, do të organizohet më 22 dhjetor 2014 nga ZAMV në mjediset e përshtatshme në Mitrovicën e Veriut. Takimi do të lejojë këto kompani të paraqesin një kërkesë për licencë. 2. Sa i përket konkluzioneve më 5 nëntor 2013, licencat do të lëshohen në përputhje me legjislacionin e Kosovës. 3. Sa i përket konkluzioneve të arritura me 17 janar 2013, kompanitë në katër komunat veriore të themeluara para asaj dite, gjatë aplikimit për licenca nuk kanë nevojë të paraqesin dokumentacionin nga Administrata Tatimore e Kosovës (numrin fiskal, numrin e TVSH), numrin e regjistrimit, kartat e identitetit të Kosovës ose dëshmitë gjyqësore. 4. Kompanitë nga katër komunat veriore, të cilat nuk do të dorëzojnë aplikacionet për licencim për importimin e mallrave të kontrolluara para 31 dhjetor 2014, nuk do të jenë në gjendje të vazhdojnë importimin pas kësaj date, pa dokumentet e duhura të licencimit të lëshuara në përputhje me legjislacionin e Kosovës. 5. Kompanitë nga katër komunat veriore, të cilat dorëzojnë aplikacionet për licencim për importimin e mallrave të kontrolluara para 31 dhjetor 2014, do të jetë në gjendje të vazhdojnë importimin deri në një vendim përfundimtar të nxjerrur nga institucioni përkatës i Kosovës dhe deri sa të njoftohet kompania. 6. Pala e Beogradit do të paraqes listat e tyre të barnave esenciale (për trajtim të brendshëm dhe të jashtëm të pacientëve) të përdorura në institucionet publike shëndetësore deri më 22 dhjetor 2014. 7. Afati i fundit për licencimin e barnave të paraqitura nga pala e Beogradit do të zgjatet deri më 30 maj 2015. Licencimi do të bëhet në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Për të siguruar që barnat të licencohen deri më 30 maj 2015, pala tjetër duhet të paraqes të gjitha dokumentet sa më shpejt të jetë e mundur, duke përfshirë CPP, me kusht që forma e CPP të jetë dakorduar në përputhje me doganat, dokumentet fito sanitare dhe veterinarë. 8. Deri në 30 maj 2015, importi i këtyre barnave do të rregullohet nga regjimi I importeve humanitare të ofruara nga legjislacioni i Kosovës. 	

KONKLUZIONET E DAKORDUARA TË IBM ¹ -IT	2 dhjetor 2011
<ol style="list-style-type: none"> 1. Në përputhje me Traktatin e Lisbonës dhe legjislacionin relevant të BE²-së dhe duke pasur parasysh se të dy palët janë pjesë e agjendës së BE-së për Ballkanin Perëndimor, atyre do t’ju kërkohej që gradualisht të harmonizojnë legjislacionin e tyre me atë të BE-së dhe në veçanti t’a zbatojnë konceptin e IBM-it; 2. Në interes të procesimit më të shpejtë dhe më efektiv, palët, nën drejtimin e përgjithshëm të BE-së, do ta zbatojnë konceptin e IBM-it; 3. Palët kanë për qëllim që të instalojnë gradualisht për objekte të përbashkëta dhe të sigurta në të gjitha vendkalimet e tyre të përbashkëta të IBM-it. Ky bashkëpunim do t’i ndjek praktikën më të mira evropiane të cilat janë duke u zhvilluar më tutje në mënyrë progresive nga Komisioni Evropian. Kësaj pune do t’i jepet prioritet i lartë; projektet do të identifikohet bashkërisht dhe do të zbatohen sa më parë që praktikisht të jetë e mundur. 4. Objektet e përbashkëta, të integruara, të vetme dhe të sigurta do të vendosen përbrenda një “zone të përbashkët të vendkalimeve të IBM-t,” të shënuar bashkërisht, ku zyrtarët e secilës palë kryejnë kontrollet përkatëse. Përfundimisht dhe kufizuar vetëm në zonat e përbashkëta të vendkalimeve të IBM-it, palët nuk do të shfaqin simbolet e juridiksioneve të tyre përkatëse. 5. Aranzhimet do të përfshijnë një prani të balancuar, në përputhje me nevojat, nga të dy palët të shërbimeve përkatëse siç janë Doganat, Policia, etj., dhe do të përfshijnë çështje siç janë lokacioni, vendkalimet, natyra e objekteve përcjellëse, orari i punës, etj. Në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij³, në vendkalimet Jarinjë/Rudnicë dhe Tabavije/Bërnjak, kjo prezencë do të përfshijë zyrtarë të EULEX-it. EULEX-i do të jetë i pranishëm poashtu në vendkalimet si Dheu i Bardhë/Konçul, Merdare/Merdarë, Mutivodë/Mutivode dhe Depce/Muçibabë; 6. Në thelb të marrëveshjes do të jenë përgjegjësitë dhe detyrimet e qarta ligjore në fuqi sipas juridiksionit të secilës palë. 7. Një grup trepalësh implementues, kryesuar nga BE, do të formohet për zbatimin e marrëveshjeve të lartëpërmenduar, sa më parë që praktikisht është e mundur. Për këtë qëllim një Protokoll Teknik do të hartohet dhe nënshkruhet, nëse është e nevojshme ndarazi me BE-në, i cili do t’i marrë parasysh pikëpamjet e ndryshme të palëve lidhur me çështjen e statusit. Implikimet e këtyre konkluzioneve do të merren parasysh në zbatimin e lirisë së lëvizjes. 8. Kjo marrëveshje nuk përfshinë asnjë çështje të përgjithshme ose të veçantë që ka të bëjë me çështjet e të hyrave apo ato fiskale; 	
<p>¹ Njëra palë e nje vijën si kufi; pala tjetër e nje vijën si kufi administrativ. ² siç është përcaktuar veçanërisht me Kodin e Shengenit për Kufijtë, Rregulloren e Frontex-it, Rregulloren e Trafikut të Kufijve Lokalë, Rregulloren VIS dhe Kodin e BE-së për Vizat; ³ Siç është përcaktuar me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124 CEFSP, kreu 3, pjesa a.</p>	

PROKOLLI TEKNIK PËR ZBATIMIN E KONKLUZAVE TË DAKORDUARA TË DIALOGUT IBM-IT TË 2 DHJETORIT 2011

23 shkurt 2012

A. Dispozitat e përgjithshme:

1. Në përputhje me konkluzat e dakorduara të IBM-it, me Traktatin e Lisbonës dhe legjislacionin relevant të BE-së² dhe duke pasur parasysh se të dyja Palët janë pjesë e agjendës së BE-së për Ballkanin Perëndimor, atyre do t'ju kërkohet që gradualisht të harmonizojnë legjislacionin e tyre me atë të BE-së dhe në veçanti ta zbatojnë konceptin e IBM-it, ashtu siç paraparë në Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian të 4-5 dhjetorit 2006;
2. Duke vepruar në mirëbesim, Palët do t'i vendosin dhe do të fillojnë funksionalizimin e pikëkalimeve të përbashkëta të IBM-it (në tekstin e mëtejshëm "PK") Jarinjë/Rudnica; Bërnjak/Tabalije; Dheu i Bardhë/Konçul; Merdarë/Merdare; Mutivodë/Mutivoda and Muçibabë/Depce;
3. "PK-të" do të vendosen në zonën e përbashkët të IBM-it (në tekstin e mëtejshëm "ZPK") ku një prani e balancuar e të gjitha autoriteteve kompetente, në përputhje me nevojat, siç janë Dogana, Policia, Fitosanitaria dhe Veterina dhe shërbimet e tjera përcjellëse dhe ndihmëse të secilës palë do të kryejnë kontrollat ndarazi brenda pjesës së vetë të zonës së përbashkët të IBM-it, në përputhje me përgjegjësitë dhe obligimet ligjore përkatëse nën juridiksionin e vetë përkatës, duke respektuar në plotëni të drejtat e njeriut të garantuara me standarde evropiane dhe ndërkombëtare;
4. Vendosja e "PK-ve" brenda "ZPK" do të thjeshtësojë kryerjen e aktiviteteve që lidhen me kontrollin e personave, mallrave dhe automjeteve në "PK", në interes të lehtësimit të kalimit të personave, automjeteve dhe mallrave si dhe të parandalimit, detektimit dhe hetimit të çfarë aktiviteti kriminal;
5. Palët do të fillojnë së vendosuri dhe funksionalizuar "PK-të/ZPK" Jarinjë/Rudnice, Dheu i Bardhë/Konçul, Bërnjak/Tabalije dhe Merdarë /Merdare. Vendosja dhe funksionalizimi i "PK-ve/ZPK" Muçibabë/Depce dhe Mutivodë/ Mutivode do të fillojë në një fazë të mëvonshme;
6. Në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij³, në vendkalimet Jarinjë/Rudnicë dhe Tabavije/Bërnjak, kjo prezencë do të përfshijë zyrtarë të EULEX-it. EULEX-i do të jetë i pranishëm poashtu në vendkalimet Dheu i Bardhë/ Konçul, Merdare/Merdarë, Mutivodë/Mutivode dhe Depce/Muçibabë;
7. Komisioni Evropian (Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim), pas konsultimit me Palët dhe EULEX-in, do të hulumtohen mundësitë për financimin e zhvillimit të "PK/ZPK". Gjithashtu, do të hulumtohen mundësitë për bashkëfinancim të "PK/ZPK" ndërmjet Palëve;
8. Në pritje të procedurave financiare të përmendura në pikën 8, Palët do të hulumtojnë mundësitë e vendosjes së shpejtë të objekteve të përkohshme për praninë e shërbimeve të parapara në pikën 3. BE do të bëjë përpjekjet më të mira për t'i angazhuar Palët për zbatimin e kësaj sa më parë që është praktikisht e mundur pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit;
9. Liria e lëvizjes do të vazhdojë sipas marrëveshjes në konkluzat e Dialogut.

B. Grupi implementues

10. Një grup i ri trepalësh (tash e tutje në tekst i referuar si IG) siç është paraparë të themelohet nga konkluzionet e Dialogut dhe i kryesuar nga BE, do të formohet pas përfundimit të këtij Protokollit Teknik dhe do të jetë përgjegjës për zbatimin e këtij Protokollit Teknik, do të ketë mundësi të propozojë masa ose zgjidhje lidhur me çështjet që lidhen me zbatimin e këtij Protokollit Teknik dhe të propozojë masa për zgjidhjen e kontesteve dhe/ose konflikteve. GI do t'i miratojë procedurat e veta të punës;
11. GI do të takohet dy herë në vit në nivel të lartë. Përveç kësaj, GI mund të thirret në këtë nivel me kërkesë të cilësdo Palë.
12. Përbërja/nivelet e GI janë të parapara në pjesën E të këtij Protokollit Teknik;

C. 'PK/ZPK'

13. Përmes këtij Protokollit Teknik, Palët, brenda një "ZPK" të shënuar bashkërisht, do të vendosin objekte dhe infrastrukturë adekuate të "PK" për një prani të balancuar, në përputhje me nevojat, nga të dy palët të të gjitha organeve kompetente të secilës Palë për kryerjen e kontrolleve në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrimet e veta përkatëse ligjore në fuqi;
14. Objektet e përbashkëta, të integruara, të vetme dhe të sigurta do të vendosen përbrenda një "zone të përbashkët të vendkalimeve të IBM-it," të shënuar bashkërisht, ku zyrtarët e secilës palë kryejnë kontrollet përkatëse. Fasilituar nga BE, Grupi teknik trepalësh do të dakordojë hollësitë lidhur me vendosjen e zonave të përbashkëta të IBM-it duke i marrë parasysh kushtet gjeografike dhe teknike në terren. Secila palë do të vendosë për lokacionin e zonave të përbashkëta të IBM-it në pjesën e vetë të territorit;
15. "ZPK-të" do të përfshijnë segmentet rrugore, të objekteve, të objekteve ndihmëse, objekteve përcjellëse siç janë toaletet, rrethojat dhe ndriçimi ose çfarëdo hapësire ose objekt i nevojshëm për zbatimin e kontrolleve/procedurave përkatëse nga organet kompetente përkatëse;
16. Dizajni i çdo "PK/ZPK" duhet t'i përmbahet skemës së "PK/ZPK" të diskutuar nga Palët, e cila do t'i përshtatet kushteve/nevojave/ komunikacionit/relievit të çdo "PK/ZPK";
17. Secila Palë do të mbulojë shpenzimet operative/të mirëmbajtjes në pjesën e vetë të "PK/ZPK";
18. "PK/ZPK" do të funksionojë 24/7. Palët do ta njoftojnë njëra-tjetrën për procedurat e tyre për procesimin e personave, automjeteve dhe mallrave dhe për çdo ndryshim të tyre;
19. Policia do të operojë në të gjitha "PK/ZPK" zakonisht me orar të punës me ndërrime 12 orëshe të cilat do të harmonizohen ndërmjet Palëve për të siguruar një qarkullim të pandërprerë të njerëzve, automjeteve dhe mallrave. Hollësitë tjera do të diskutohen dhe dakordohen nga GI. Dogana do të operojë me orar të njëjtë të punës në të gjitha "PK/ZPK" me përjashtim të Mutivodës/Mutivode ku Policia do të jetë autoriteti i vetëm i pranishëm. Shërbimet fitosanitare dhe veterinare do të operojnë vetëm brenda Terminaleve Doganore zakonisht me ndërrime 12 orëshe të cilat do të harmonizohen ndërmjet Palëve për të siguruar një qarkullim të pandërprerë të njerëzve, automjeteve dhe mallrave nëpër "PK/ZPK". Procesimi/qarkullimi i kafshëve të gjalla dhe bimëve do të bëhet përmes "PK/ZPK" Merdarë/Merdare dhe Jarinjë/Rudnica.
20. Gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në zonën e përbashkët të menaxhimit të integruar kufitar, zyrtarët nga të dyja Palët do të gëzojnë imunitetet dhe privilegjet përkatëse dhe t'u përgjigjen organeve të veta kompetente të origjinës.
21. Zyrtarët e secilës Palë, gjatë hyrjes-daljes dhe gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare duhet t'i bartin uniformat dhe emblemat e tyre zyrtare;

22. Zyrtarët e secilës Palë do të bartin një kartën zyrtare të identifikimit dhe një autorizim zyrtar të cilat i japin të drejtë zyrtarit që të hyjë dhe punojë në pjesën e vetë të "ZPK". Karta zyrtare e identifikimit duhet të lëshohet nga organi kompetent i secilës palë. Secila Palë e njofton Palën tjetër se cilat karta identifikimi janë të vlefshme për hyrje-dalje në "ZPK";
23. Në pjesën e vetë të zonës së përbashkët të menaxhimit të integruar kufitar, përdorimi i forcës dhe masat e tjera të zbatimit të ligjit nga e Palëve rregullohen me legjislacionin e përkatës të secilës Palë;
24. Përjashtimisht dhe kufizuar vetëm në zonat e përbashkëta të zonës së përbashkët të menaxhimit të integruar kufitar Palët nuk do të shfaqin simbolet e juridiksioneve të tyre përkatëse⁴;
25. Informacionet funksionale në "ZPK" do të postohen në gjuhët zyrtare. Përveç kësaj, tekstet do të postohen edhe në anglisht;

D. Funksionimi i "PK/ZPK"

26. Brenda "ZPK", procesimi i personave, automjeteve dhe mallrave nga zyrtarët e territorit të daljes do të kalojnë të procesohen nga zyrtarët e territorit të hyrjes. Pas largimit nga territorit i daljes, personat, automjetet dhe mallrat nuk mund të procesohen më nga zyrtarët e daljes përveç nëse u është refuzuar hyrja nga zyrtarët e territorit të hyrjes;
27. Personat dhe mallrat të cilëve u është refuzuar hyrja në territorin e njëres Palës duhet të kthehen në territorin e Palës tjetër;
28. Lidhur me azilin dhe migracionin do të zbatohen ligjet përkatëse të secilës Palë;
29. Kontrolli i lehtësuar mund të zbatohet në rrethana të jashtëzakonshme dhe të paparishikueshme të shkaktuara nga shkalla e shtuar e qarkullimit. Në këto raste, autoritetet kompetente të secilës Palë do të marrë masa për lehtësimin e trafikut të ngjeshur. Masat e tilla të lehtësuara do të vendosen vetëm në baza të përkohshme. GI do të hartojë dhe dakordojë hollësi të tjera varësisht sipas rrethanave dhe nevojave;
30. Palët do të hartojnë dhe vendosin plane rezervë lidhur me ngjarje të mundshme të paparashikuara dhe/ose të papritura. Në rastet e tilla, Palët, në bazë të kërkesës, do t'i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë reciproke. Hollësitë do të hartohen dhe dakordohen nga GI;

E. Shkëmbimi, përpunimi dhe përdorimi i informatave

31. Pa paragjykuar çfarëdo obligimi në të cilat kanë hyrë Palët me BE-në dhe/ose organizatat ndërkombëtare, Palët do të vendosin mekanizma me qëllim të shkëmbimit të informatave dhe të dhënave tjera të cilat janë ose mund të jetë relevante për parandalimin, detektimin dhe hetimin e aktiviteteve kriminale si dhe për mbrojtjen e jetërave dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve, ambientit dhe sigurisë së ushqimit në pjesën e tyre të përgjegjësisë, duke përfshirë shkëmbimin e të dhënave statistikore të qarkullimit të njerëzve dhe të mallrave me qëllim të zbulimit të aktiviteteve të paligjshme;
32. Asnjëra Palë nuk do t'i përdorë informata dhe të dhënat e tjera të ofruara nga pala tjetër përpos për qëllimet e përmendura në pikën 31 e as nuk do t'ua vëjë ato informata në dispozicion një Pale tjetër, përveç organeve përkatëse të BE-së. I tërë përpunimi i të dhënave do të bëhet në përputhje të plotë me standardet e BE-së për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave;
33. GI, në format adekuat për plotësuar kushtet e përmendura në pjesën E do të jetë përgjegjëse për të siguruar shkëmbimin, përpunimin dhe përdorimin e informatave;
34. Për këtë qëllim do të mbahen takime të rregullta në të gjitha nivelet (lokale, regjionale, qendrore). Intervalet e këtyre takimeve do të rregullohen dhe dakordohen nga GI;
35. GI do të hartojë/miratojë dispozita të hollësishme për shkëmbimin, përpunimin dhe përdorimin e informatave dhe të dhënave tjera siç parashihet në pikën 32, në përputhje të plotë me standardet e BE-së;
36. BE do të bëjë përpjekjet më të mira për të lehtësuar shkëmbimin e informatave nga Palët përmes nismave/projekteve/sistemeve të vendosura nga BE (psh. Sistemi i Shkëmbimit Elektronik i të Dhënave (S.E.E.D.) etj.);

F. Përgjegjësitë/Obligimet

37. Për çdo kundërvajtje ose shkelje penale si dhe për çdo obligim ose dëm në lidhje me kryerjen e detyrës zyrtare në "ZPK", Pala e cila e ka faktuar zyrtarin i cili ka kryer veprimet të tilla do të jetë përgjegjëse dhe legjislacioni i Palës përkatëse / autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit janë përgjegjëse;
38. Pala e njofton menjëherë palën tjetër në rast të kundërvajtjes ose shkeljes penale nga ana e ndonjë zyrtari të saj;
39. Lehtësuar nga BE, Palët do të synojnë të vendosin ndihmë reciproke ligjore;

G. Dispozitat përfundimtare

40. Lehtësuar nga BE, zbatimi i këtij Protokollit Teknik do të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të tij. Për këtë qëllim, Grupi trepalësh Teknik do të mblidhet menjëherë pas nënshkrimit të Protokollit Teknik;
41. Ndryshimet në këtë protokoll do të diskutohen dhe dakordohen nga ana e GI;
42. Pas konsultimit me BE-në, secila palë është e lirë të njoftojë për shkëputjen e këtij Protokollit Teknik gjë që do zbatohet përmes njoftimit të të gjitha Palëve të këtij Protokollit Teknik. Shkëputja do të hyjë në fuqi dymbëdhjetë muaj pas njoftimit;
43. Pas shkëputjes së këtij Protokollit Teknik, mjetet e ofruara nga secila Palë do të mbesin në pronësi të asaj Pale. Mjetet e ofruara përmes financimit të BE-së do të trajtohen në përputhje me dispozitat në Termat e Referencës dhe/ose kontratat.

¹ Njëra palë e njej vijën si kufi shtetëror; pala tjetër e njej vijën si kufi administrativ.

² Siç definohet në Kodin Kufitar të Shengenit, Rregulloren e Frontexit, Rregulloren për Trafikun e Kufinjve Lokalë, Rregulloren VIS dhe Kodin e Komunitetit për Vizat.

³ Siç është paraparë në Council Joint Action 2008/124 CEFSP, Neni 3, Pika a.

⁴ Kjo është përkufizuar mëtej në letrën e Lehtësuesit dërguar secilës palë me 6 dhjetor 2011.

PLANI FINAL I VEPRIMIT I GRUPIT ZBATUES (GZ) PËR PROTOKOLLIN TEKNIK PËR MIK, e qasshme në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ZKM-ALB-IBM Action Plan final - 04 December 2012 (2).pdf	4 dhjetor 2012
PROCEDURAT PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE	13 dhjetor 2012
<p>Letër njoftuese nga Fisnik Rexhepi, Koordinator i Kosovës për GI MiK për Z. Gentilini Duke ditur që përpjekjet për mbështetjen e sundimit të së drejtës avancohen me qasje bashkëpunuese dhe në pajtim me Protokollin teknik për zbatimin e Konkluzave të dakorduara të dialogut për MIK¹, palët pajtohen të krijojnë procedura të cilat lehtësojnë procedimin e kërkesave për Ndihmë të ndërsjellë juridike (NNJ):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Palët do të krijojnë një kanal komunikimi për NNJ ndërmjet organeve të tyre përgjegjëse, në pajtim me juridiksionin relevant të secilës palë; 2. Fushëveprimi i kërkesave që do të barten do të përbëhet nga: 2.1 Kërkesat e përgjithshme për NNJ 3. Palët pajtohen që nga EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, do të kërkohet të veprojnë si ndërmjetës për të ndërmjetësuar komunikimin vetëm me transmetimin e kërkesave për NNJ dhe përgjigjet e palëve për to. Palët pajtohen që EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, në asnjë mënyrë nuk mund të thirret në përgjegjësi për dëmet ose të jetë përgjegjës për mospajtim në zbatimin e kërkesave. 4. Teknikisht, ndërmjetësimi në komunikim ndërmjet palëve do të bëhet si vijon: organi kërkues do t'ia dorëzojë kërkesat ose përgjigjet EULEX-it, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij. Pas pranimit, EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, do të bashkëngjijë një shkresë përcjellëse në të cilën do të specifikohen bashkëngjitjet e kërkesës ose përgjigjes, dhe do ta bartë atë me dokumentet e bashkëngjitura të pala pranuese sipas rastit. 5. Procedurat e paraqitura nuk do të ndikojnë në detyrimet e palëve lidhur me juridiksionin relevant të zbatueshëm, traktatet ose aranzhimet e tjera në fuqi. 6. Palët do të përpiqen që të zgjidhin çfarëdo mosmarrëveshje që mund të shfaqet lidhur me pranimin, zbatimin ose realizimin e këtyre procedurave. Me ndërmjetësim të EULEX-it, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, palët do të takohen së paku një herë në vit për këtë dhe me qëllim të vlerësimit dhe përmirësimit të zbatimit të këtyre procedurave. Për më tej, me kërkesë, palët mund të takohen në çfarëdo niveli kompetent të palëve, përfshirë EULEX-in, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij. EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, do të mbajë shënime zyrtare, për të cilat do të pajtohen palët. 7. Palët do të përballojnë kostot dhe shpenzimet e veta që paraqiten lidhur me pranimin, zbatimin ose realizimin e këtyre procedurave. 8. Pas konsultimit me BE-në, secila palë është e lirë të njoftojë për shpërndarjen e këtyre procedurave, gjë që do zbatohet përmes njoftimit të të gjitha palëve. Shkëputja do të hyjë në fuqi tre muaj pas njoftimit. 9. Pas pranimit të këtyre procedurave me shkrim nga secila palë, BE-ja do të njoftojë palët për hyrjen në fuqi të këtyre procedurave. <p>¹ Njëra palë e njuh vijën si kufi shtetëror; pala tjetër e njuh vijën si kufi administrativ.</p>	

KONKLuzionet, Takimi për SEED, Romë, Itali	24 janar 2013
<p>Në harmoni me Protokollin Teknik për implementimin e MIK¹ konkluzionet e dakorduara nga Dialogu me datën 2 dhjetor 2011 dhe Plani Final i Veprimit për Grupin Implementues (GI) për Protokollin Teknik mbi MIK – 4 dhjetor 2012, ku janë arritur konkluzionet si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të dyja Palët (siç është përcaktuar në Protokollin Teknik për implementimin e MIK konkluzionet e dakorduara nga Dialogu me datën 2 dhjetor 2011) pajtohen për implementimin e sistemit SEED për shkëmbimin elektronik të të dhënave. 2. Të dyja Palët janë pajtuar që të shkëmbejnë të dhëna të cilat aktualisht janë në kompetencat e tyre Doganore, që në ç' rast se njëra nga Palët (Beograd) nënkuptohet vetëm deklarata të transitit, përfshirë TIR dhe ATA carnet. 3. Opsioni për përpunimin e të dhënave përmes një serveri të vetëm të mesëm është opsioni që preferohet nga të dyja Palët. 4. Sa i përket lokacionit të serverit të mesëm, të dyja Palët janë pajtuar për lokacione tjera përveç Beogradit dhe/ose Prishtinës: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Propozimi i parë i dakorduar nga të dyja Palët që lokacioni i serverit të mesëm të jetë brenda Komisionit Evropian në Bruksel; ▪ Opsioni i dytë i preferuar për lokacionin e serverit të mesëm të jetë brenda Agjencisë Doganore të Italisë (ADI) (agjencia implementuese e projektit të SEED) në Romë – ky propozim është mbështetur plotësisht nga Drejtori i Përgjithshëm i ADI, i cili i ka siguruar të dyja Palët që e gjithë ndihma e nevojshme për të garantuar mbrojtjen e pajisjeve dhe të dhënave do të sigurohet; ▪ Opsioni i tretë është të kontrollohet mundësia që serveri i mesëm të jetë në njërin nga Zyrat e BE-së për Delegim në Rajon, përveç në Beograd dhe/ose në Prishtinë; <p>Vendimi mbi lokacionin e serverit të mesëm do të merret nga Ndërmjetësi Kryesor i BE-së për MIK dhe në diskutim me anëtarët e GI gjatë vizitave të afërta në Beograd dhe Prishtinë gjatë javës së ardhshme.</p> <ol style="list-style-type: none"> 5. Brenda 7 ditësh së pranimit të vendimit për lokacionin e serverit të mesëm, ekipi për Projektin SEED pajtohen që të krijojnë një Plan Veprimi për implementim, për të përfshirë aktivitetet, periudhat kohore dhe buxhetin. 6. Për të siguruar financat për implementimin e shkëmbimit të të dhënave SEED, Ndërmjetësi i Marrëveshjes së BE-së për MIK kërkohet që të dërgoj një kërkesë formale për DP për Zgjerim. <p>¹ Njëra Palë e njuh vijën si kufi; dhe Pala tjetër e njuh vijën si kufi administrativ.</p>	

MARRËVESHJA E BRUKSELIT PËR DIZAJNIN E PIKËKALIMEVE TË PËRHERSHËM TË IBM	4 shtator 2014
<ol style="list-style-type: none"> 1. Në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, palët u takuan për të diskutuar hapat e ardhshëm për zbatimin e Protokollit Teknik të IBM-së i dakorduar nga viti 2012. 2. Palët u morën vesh për projekt dizajnë për pikat e kalimit të përherëshëm të IBM-së dhe i nënshkruan dokumentet përkatëse. 3. Palët janë pajtuar edhe për mënyrën e vazhimit tutje siç është propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit: <ul style="list-style-type: none"> • Kontraktori (Safage) do të finalizojë FIDIC (Libri i verdhë) deri në fund të vitit 2014. • Pas përfundimit të librit të verdhë, kontrata për projektimin dhe ndërtimin do të shkojnë për tenderim. • Fondet përkatëse do të jepen nga IPA-të respektive, të cilat tashmë janë zotuar dhe do të ndahen zyrtarisht në muajin e ardhshëm. • UNOPS do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të fazës tjetër. 4. Palët do të njoftohen në kohën e duhur nga ana e KE (Drejtoria për Zgjerim) mbi progresin e arritur. 	

ARANZHIMET LIDHUR ME PËRFAQËSIMIN DHE BASHKËPUNIMIN RAJONAL, Konkluzionet e Dakorduara	24 shkurt 2012
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të dy palët konfirmojnë përkushtimin e tyre për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal efektiv dhe gjitëpërfshirës. 2. Për përmbushje të kësaj, 'Kosova*' është deniminimi i vetëm që do të përdoret në kornizën e bashkëpunimit rajonal. 3. Fusnota që do të aplikohet në asteriksin e cekur në paragrafin 2 është "Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKSBB 1244 dhe Opinionin e GjND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës." 4. 'Kosova*' merr pjesë në interes të saj dhe fet për veten e saj në të gjitha takimet rajonale. 5. Kur inicihohet dhe/ose nënshkruhen marrëveshje të reja, përfaqësuesi i Kosovës* do të nënshkruan sipas përcaktimit në paragrafët 2 dhe 3. 6. Sa i përket modifikimeve të marrëveshjeve ekzistuese e të nënshkruara nga UNMIK-u, asgjë në këto konkluzione nuk do të interpretohet me paragjykim për të drejtat legale të UNMIK-ut. Përfaqësuesi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) do të ftohet në takimet e organizuara në kuadër të marrëveshjeve ku është nënshkruar. UNMIK do të vendos nëse dëshiron të merr pjesë në ndonjërin nga këto takime. 7. Nikoqiri i takimeve do të inkurajohet që të shmang shpërfaqjen e simboleve shtetërore përveç të tij dhe të BE-së, duke marrë parasysh statutet e organizatave relevante. 8. Be-ja si ndërmjetësuese do t'i informojë organizatat relevante rajonale dhe etnitetet për aranzhimet për deniminimin, përfaqësimin dhe nënshkrimin. Ato duhet të reflektohen në takimet e ndryshme rajonale. BE-ja do ta monitoroj zbatimin e këtyre aranzhimeve. 9. Të dy palët dhe BE-ja do t'i nxisin partnerët që të mbështesin këto aranzhime dhe të ndihmojnë në zbatimin e tyre. 10. Organizatat rajonale për të cilat bëhet fjalë në këto konkluzione janë ato ekzistueset dhe të tjerat që do të themelohen, ndërqeveritare ose aranzhime që kanë për qëllim që të promovojnë bashkëpunimin ose integrimin në rajonin të Ballkanit. "Takimet rajonale" përfshirë takimet e këtyre organizatave dhe poashtu takimet ad-hoc ose takimet jo-formale me qëllime të ngjashme. Kjo gjithashtu përfshinë takimet me institucionet e BE-së në kontekst të agjendës Evropiane. 11. Këto aranzhime janë aprovuar në baza të përkohshme. 	

MARRËVESHJA E BRUKSELIT MBI MBLEDHJEN E TË HYRAVE DOGANORE

17 janar 2013

Përfundimet e Kryesuesit, Grupi Punues (GP) Doganor, 10 -17 janar 2013: *Në harmoni me përfundimet relevante të mëparshme të dakorduara (në veçanti mbi MIK)¹, me Marrëveshjen e CEFTA-së, Traktatin e Lisbonës dhe legjislacionin relevant të BE-së² dhe duke pasur parasysh që të dyja Palët janë pjesë e agjendës së BE-së për Ballkanin Perëndimor, Palët janë pajtuar si në vijim:*

A. Grumbullimi i detyrimeve doganore, detyrimeve të akcizës dhe TVSH-së:

1. Të gjitha mallrat, pavarësisht llojit, sasisë dhe vlerës mund të hyjnë në Kosovë³ përmes PKDve të MIK në Jarinjë/Rudnica dhe në Tabavijë/Bërnjak .
2. Për mallrat e liruar në qarkullim të lirë dhe të paracaktuara për kompanitë dhe ndërmarrjet e regjistruara dhe/ose individët që jetojnë në Leposaviq, në veri të Mitrovicës, Zubin Potok dhe Zveçan, të gjitha detyrimet doganore dhe Akcizore e poashtu edhe të TVSH-së do të mblidhen në pajtim me paragrafin 3 në objektet që gjenden në Pikë Kalimet doganore në zonën e përbashkët të MIK-ut (që këtej e tutje do të quhet si "ZPKD") nëse këto mallra kanë hyrë përmes PKD-ve Jarinjë/Rudnica dhe Tabavijë / Bërnjak. Të gjitha mallrat tjera që kanë hyrë përmes PKD-ve Jarinjë/Rudnica dhe Tabavijë/Bërnjak do të drejtohen për në Terminalin e Mitrovicës jugore për t'u liruar.
3. Procedurat e liritimit, përfshirë të gjitha kontrollet e nevojshme, do të realizohen në pjesën e Kosovës nga autoritetet Kosovare në pajtim me përgjegjësitë e tyre ligjore dhe detyrimet sipas këtij juridiksioni (përfshirë normat doganore, Akcizore dhe të TVSH-së), plotësisht duke i respektuar të drejtat e tyre njerëzore të garantuara nga standardet Evropiane dhe ndërkombëtare; EULEX do të jenë të pranishëm, në harmoni me dhe gjatë mandatit të tyre⁴ dhe në pajtim me marrëveshjen për MIK.
4. Regjistrimi i kompanive dhe ndërmarrjet që referohen në paragrafin 2 do të bëhen për qëllimet e kësaj marrëveshjeje. Regjistrimi do të bazohet në dokumentacionin ekzistues dhe në pajtim me paragrafin 3.
5. Për kompanitë dhe ndërmarrjet në Leposaviq, në veri të Mitrovicës, Zubin Potok dhe Zveçan të themeluara para se kjo marrëveshje të ketë hyrë fuqi, të gjitha dokumentet regjistruese të mëparshme automatikisht do të konsiderohen të vlefshme për regjistrim. Në vijim të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, regjistrimet / ndërmarrjet për kompanitë e reja do të kryhen në pjesën Kosovare të ZPKD-së nga autoritetet Kosovare në pajtim me përgjegjësitë e tyre ligjore dhe detyrimet sipas këtij juridiksioni, duke i respektuar plotësisht të drejtat njerëzore të cilat janë të garantuara sipas standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare; EULEX-i do të jetë i pranishëm, në harmoni me dhe gjatë mandatit të tyre.⁵ I gjithë dokumentacioni relevant mund të përdoret për regjistrim dhe mbledhje të të hyrave.
6. Siç është arritur marrëveshja për përfundimet e MIK, të gjitha informatat dhe provat e grumbulluara për zbatimin e operacioneve të lartcekura do të ndahen bashkërisht në mes të Palëve dhe sipas dokumenteve nga Marrëveshja e MIK-ut, përfshirë dhe Marrëveshjen Teknike.

B. Fondi Zhvillimor

7. Fondi Zhvillimor (që këtej e tutje Fondi) duhet të krijohet për të promovuar zhvillimin socioekonomik dhe për të mirën e popullsisë lokale në Leposaviq, në veri të Mitrovicës, Zubin Potok dhe Zveçan.
8. Funkcioni i Fondit do të vendoset nga Bordi Menaxhues. Bordi Menaxhues do të jetë i përbërë nga tre anëtarë, një përfaqësues i komunitetit Serb i cili jeton ose në Leposaviq, veri të Mitrovicës ose Zubin Potok ose Zveçan, një përfaqësues nga autoritetet Kosovare dhe Përfaqësuesi Special nga Bashkimi Evropian për Kosovë (PSBE). PSBE-ja do të ftojë përfaqësuesit e lartcekur pas konsultimeve me palët e interesuara në Fond. Bordi Menaxhues do të vendos me konsensus. Në rast të paaftësisë së përsëritur të arritjes së konsensusit, PSBE-ja mund të përdor votën vendimtare për të përkrahur qëllimin e Fondit, përfshirë edhe miratimin e Kushteve e përkohshme të Referencës.
9. Të hyra të grumbulluara në ZPKD-të në Jarinjë/Rudnica dhe Tabavijë/Bërnjak do të transferohen në llogarinë e Fondit të krijuar në një bankë komerciale në Prishtinë të caktuar nga BE.

C. Dispozitat kalimtare:

10. Palët më tutje pajtohen që brenda 3 ditëve të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, zyrtarët Kosovar dhe të EULEX-it duhet të kenë qasje të papenguar në ZPKD, përfshirë përmes rrugës, në lidhje me këtë marrëveshje dhe përfundimet e mëparshme mbi MIK. Çdo përpjekje e mundshme, përfshirë edhe përmes deklaratave publike në nivelin më të lartë politik, do të bëhen në këtë nivel.
11. Brenda 7 ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Fondi do të themelohet me iniciativën e PSBE-së i cili do të bëjë hapjen e llogarisë bankare të lartcekur.
12. Grumbullimi i detyrimeve doganore dhe të akcizës e poashtu edhe TVSH-së në ZPKD në Jarinjë/Rudnica dhe Tabavijë / Bërnjak do të fillojë menjëherë pas themelimit të Fondit. Autoritetet Kosovare do të sigurojnë që dokumentacioni i lëshuar (forma e përkohshme) për kompanitë dhe ndërmarrjet do të përmbajë informacione specifike mbi paracaktimin e të hyrave.
13. Brenda 30 ditëve pas hyrjes së në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Palët do të kenë miratuar rregulloret e nevojshme për të zbatuar këtë marrëveshje dhe do të kenë shfuqizuar rregulloret që janë në kundërshtim me marrëveshjen e lartcekur.
14. Nuk do të ketë shpajim të të hyrave të deponuara në Fond derisa Palët të vendosin ndryshe.
15. Përgatitjet për regjistrim janë në baza të përkohshme.

D. Dispozitat finale:

16. Kjo Marrëveshje do të hyj në fuqi më 19 janar 2013 në ora 00:00.
17. Zbatimi i marrëveshjes do të rishikohet nga grupi punues monitorues (GP) i kryesuar nga Beja dhe i përbërë nga Palët. GP kryesisht do të koncentrohet në sigurimin e procesit të regjistrimit sipas paragrafëve 4 dhe 5 të cilat do të jenë të dobishme vetëm për këtë marrëveshje.

(përkthim jo-zyrtar)

¹ Njëra palë e pranon vijën si kufi; pala tjetër e pranon vijën si kufi administrativ.

² Në veçanti Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 2007/2000 e 18 shtatorit 2000 që paraqet masat e jashtëzakonshme tregtare për vendet dhe territoret pjesëmarrëse ose të lidhura me procesin e BE-së mbi Stabilizimin dhe Asociacionin, sipas plotësimin.

³ *Ky përcaktim nuk është paragykues nga pozitës së statusit dhe është në harmoni me Rezolutën 1244/99 dhe Mendimin e Gjykatës për Drejtësi Ndërkombëtare mbi Deklarimin e Pavarësisë nga Kosova.

⁴ Siç është përcaktuar nga Akti i Përbashkët i Këshillit 2008/124 CEFSP, Neni 3, Pjesa a.

⁵ Siç është përcaktuar nga Akti i Përbashkët i Këshillit 2008/124 CEFSP, Neni 3, Pjesa a.

MARRËVESHJA E PARË E PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE

19 Prill 2013

1. Do të krijohet një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë Serbe në Kosovë.
2. Bashkësia/Asociacioni do të themelohet përmes statutit. Shpërbërja e tij mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse. Do të ketë garanca ligjore përmes ligjit aplikues dhe të drejtës kushtetuese (përfshirë rregullën për shumicën prej 2/3)
3. Struktura e Asociacionit/Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë si edhe statutit të Asociacionit ekzistues të komunave të Kosovës, p.sh. Kryetari, Nënkryetari, Kuvendi, Këshilli.
4. Në përputhje me kompetencat e parapara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjin e Kosovës për komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin kolektiv të kompetencave të tyre përmes Bashkësisë/Asociacionit. Asociacioni/Bashkësia do të ketë vështrim të plotë mbi fushat si zhvillimi ekonomik, arsimit, shëndetësia, planifikimi urban dhe rural.
5. Asociacioni/Bashkësia do të ushtrojë kompetenca të tjera shtesë siç mund të delegohen nga autoritetet qendrore.
6. Bashkësia/Asociacioni do të ketë rol përfaqësues të autoritetet qendrore dhe për këtë qëllim do të ketë një përfaqësues në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve. Në përmbushje të këtij roli parashihet funksioni monitorues.
7. Do të ketë një polici në Kosovë e quajtur Policia e Kosovës. E gjithë policia në veri të Kosovës do të integrohen brenda kornizës së Policisë së Kosovës. Pagat do të jenë vetëm nga ana e PK-së.
8. Pjesëtarëve të strukturave serbe të sigurisë do t'u ofrohet vend në strukturat ekuivalente të Kosovës.
9. Do të ketë një Komandant Regjional i Policisë për katër komunat me shumicë serbe në veri (Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi). Komandanti i këtij regjioni do të jetë një serb i nominuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nga lista e ofruar nga katër kryetarët e komunave në emër të Bashkësisë/Asociacionit. (Do të ketë Komandant tjetër regjional për komunat e Mitrovicës Jugore, Skënderajit dhe Vushtrrisë). Komandanti regjional i katër komunave në veri do të bashkëpunojë me komandantë të tjerë regjional.
10. Autoritetet gjyqësore do të integrohen dhe të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës.
Gjykata e Apelit në Prishtinë do të themelojë një panel të përbërë me shumicë Serbe të Kosovës për të gjykuar të gjitha rastet e komunave me shumicë Serbe.
Një divizion i kësaj Gjykatë të Apelit, i përbërë nga staf administrativ dhe gjyqtarë, do të vendoset në mënyrë të përhershme në veri të Mitroviçës (në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës)
Secili panel i divizionit të mësipërm do të ketë përbërje me shumicë të gjyqtarëve S/K.
Gjyqtarët përkatës do të vendosen në panel në varësi të natyrës së rastit në fjalë.
11. Zgjidhjet lokale në komunat e veriut do të organizohen në vitin 2013, me lehtësimin e OSBE-së, në përputhje me ligjin e Kosovës, dhe me standardet ndërkombëtare.
12. Një plan zbatimi, i cili përfshin dhe afatin kohorë, do të krijohet deri më 26 Prill. Në zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të trajtohet dhe parimi i financimit transparent.
13. Diskutimet lidhur me Energjinë dhe Telekomin do të intensifikohen nga të dy palët, dhe do të përfundojnë deri më 15 qershor.
14. Është dakorduar që asnjëra palë nuk do të bllokohet, apo të inkurajojë të tjerët të bllokohen, progresin e palës tjetër në rrugën përkatëse drejt BE-së.
15. Do të themelohet një komitet zbatimi nga të dy palët, me lehtësimin e BE-së.

Plani i Zbatimit është i qasshëm këtu: http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani_i_Zbatimit_te_Marreveshjes_se_Pare_per_Normalizimin_e_Marredhenievet.pdf

MARRËVESHJA PËR ZYRTARËT NDËRLIDHËS, *Konkluzionet e Kryesuesit*

31 maj 2013

Të dy palët u takuan më datat 28-29 janar, 5 shkurt, 14 shkurt, 5-6 mars, 11 mars, 9 maj dhe 30 maj të vitit 2013 për të shkëmbyer pikëpamjet mbi marrëveshjet ndërlidhëse.

Ata shqyrtuan modalitetet e propozuara nga BE-ja në lidhje me pritjen e Zyrtarit Ndërlidhës dhe stafit të tij në Delegacionin e BE/Zyrën e BE-së.

Përveç kësaj, ata ranë dakord që dispozitat e mëposhtme do të zbatohen për Zyrtarin Ndërlidhës dhe stafin e tij:

Preambula: Në kontekstin e perspektivës evropiane për Ballkanin Perëndimor, Beogradi dhe Prishtina janë angazhuar në hapat e mëtejme që shpijnë drejt normalizimit të marrëdhënieve mes dy palëve. Në dhjetor të vitit 2012, Këshilli i BE-së gjithashtu mirëpriti vendimin për të emëruar persona ndërlidhës të cilët do të duhej të vendoseshin në zyra të ofruara nga Delegacioni i BE-së në Beograd dhe Zyra e BE-së në Prishtinë të cilët do të ndjekin të gjitha çështjet që lidhen me normalizimin e marrëdhënieve dhe do të adresojnë problemet e përditshme që mund të ndodhin. Bashkimi Evropian ofron lehtësim për të arritur këto aranzhime dhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre në përputhje me praktikatat më të mira të BE-së.

Shkëmbimi i Zyrtarëve Ndërlidhës do të fillojë më 15 qershor 2013.

1. Zyra e përdorur nga Zyrtari Ndërlidhës dhe stafi i tij në kuadër të Delegacionit të BEsë/Zyrës së BE-së, si dhe arkivat dhe dokumentet që ata përdorin, duke përfshirë edhe korrespondencën zyrtare, do të gëzojnë paprekshmëri.
 2. Rezidenca private e Zyrtarit Ndërlidhës dhe stafit të tij do të jetë e paprekshme. Të dy palët do të ofrojnë mbrojtje të objekteve 24/7.
 3. Pala përkatëse do t'i ofroj Zyrtarit ndërlidhës dhe stafit të tij liri të lëvizjes dhe udhëtimit, e cila është në përputhje me marrëveshjen për liri të lëvizjes e arritur në dialogun e datës 2 korrikut 2011.
 4. Paprekshmëria dhe mbrojtja personale. Të dyja palët do të ofrojnë mbrojtje personale për Zyrtarin Ndërlidhës dhe për stafin e tij 24/7.
 5. Procedurat penale, civile dhe administrative kundër Zyrtarit Ndërlidhës dhe asistentit të tij do të kryhen vetëm para Gjykatës dhe autoriteteve tjera të juridiksionit të Palës së Zyrtarit Ndërlidhës dhe asistentit. Zyrtari Ndërlidhës dhe asistenti nuk do të jenë subjekt i paraburgimit, arrestimit apo të detyrohen të japin dëshmi si dëshmitar.
- Shoferi do të përfitojë nga dispozitat e mëparshme, përveç nëse këto dispozita që kanë të bëjnë me procedurat civile dhe administrative nuk do të zgjerohen në veprimet e kryera jashtë detyrave të tij.
6. Zyrtari Ndërlidhës dhe stafi i tij do të paguajnë të gjitha taksat dhe detyrimet mbi të ardhurat të ndërlidhura me detyrat e tyre për Palën e tyre përkatëse.
 7. Pala përkatëse do të lejojë hyrjen e granteve dhe lirimim e tyre nga të gjitha detyrimet doganore, taksat dhe tarifatat që kanë të bëjnë me:
 - a. artikujt për përdorim zyrtar të Zyrtarit Ndërlidhës ose të stafit të tij;
 - b. artikujt për përdorim personal të Zyrtarit Ndërlidhës ose të stafit apo për anëtarët e familjes së tij.
 8. Pas njoftimit 24 orësh, të dy palët do të ofrojnë procedura preferenciale të hyrjes/daljes, përjashtim nga inspektimi i bagazheve personale si dhe mbrojtje personale.
 9. Anëtarët e familjes së Zyrtarit Ndërlidhës dhe stafit të tij (bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare), që janë pjesë e familjes së tyre do t'i gëzojnë të njëjtat kushte të specifikuar në paragrafët 3, 5, 6 dhe 8 me përjashtim të mbrojtjes personale. Në këtë aspekt:

Procedurat penale, civile dhe administrative kundër familjes së Zyrtarit Ndërlidhës dhe asistentit të tij që janë pjesë e familjeve të tyre përkatëse, do të bëhen kryhen vetëm para gjykatës dhe autoriteteve tjera në juridiksionin e Palës së tyre, përveç në rast të ndonjë veprimi në lidhje me ndonjë aktivitet profesional apo tregtar të anëtarëve të tyre të familjes.

Procedurat penale kundër familjes së shoferit që janë pjesë e familjes së tij, do të kryhen vetëm para gjyqit dhe autoriteteve tjera nën juridiksionin e Palës së shoferit.
 10. Automjeti i Zyrtarit Ndërlidhës do të pajiset me targa të barasvlershme me ato që iu jepen Delegacionit të BE-së / Zyrës së BE-së.
 11. Stafi i paraparë në bazë të këtyre dispozitave do të përbëhet nga një Zyrtar Ndërlidhës, një asistent dhe një shofer.
 12. Zyrtari Ndërlidhës dhe stafi i tij, si dhe anëtarët e familjeve të tyre do të pajisen me letërnjoftime të veçanta me titujt e tyre si dhe me një referencë të kësaj marrëveshje.
 13. Në mungesë të Zyrtarit Ndërlidhës, asistenti do t'i kryej detyrat e tij. Njoftimi për mungesën e Zyrtarit Ndërlidhës do t'i dorëzohet palës përkatëse.
 14. Të dyja Palët do të mbajnë kanale të hapura dhe të drejtpërdrejta të komunikimit me Zyrtarin përkatës Ndërlidhës.
 15. Të dyja Palët do të sigurojnë që të gjitha kushtet e nevojshme praktike dhe administrative të jenë të plotësuara në mënyrë që t'i mundësojnë Zyrtarit Ndërlidhës dhe stafit të tij që t'i kryejnë detyrat e tyre.
 16. Me kërkesë të njëres Palë, këto kushte do të rishikohen dhe mundësisht të ndryshohen me pëlqimin e ndërsjellë.
 17. Këto kushte do të zbatohen përmes legjislacionit të secilës Palë përkatëse. Secila palë mund të paraqesë një shënim shpjegues për këtë qëllim

MARRËVESHJET PËR VIZITA ZYRTARE	14 nëntor 2014
<p>1. Palët përkatëse do të njoftojnë palën tjetër rreth vizitave të zyrtarëve të tyre. Njoftimet do të bëhen sipas mënyrës në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Institucioni që bën kërkesën do të dërgoj njoftimin drejtpërdrejtë tek ZN-ja e palës se ku do të zhvillohet vizita, duke dërguar një kopje (cc) për ZN-në e palës kërkuuese për vizitë. ZN-ja e cila ka pranuar njoftimin do ta konfirmojë menjëherë pranimin. ▪ Nëse në afatin e caktuar (në varësi të kategorisë, si më poshtë) nuk ka përgjigje atëherë vizita konsiderohet e miratuar. ▪ Nëse janë ngritur kundërshtime në lidhje me afatin e dhënë ato duhet t'i komunikohen direkt ZN-së së palës që ka dërguar njoftimin. BE-së (Delegacioni i BE-së në Beograd ashtu dhe zyra e PSBE-së në Prishtinë) do të përfshihen (cc) në komunikim dhe do të krijohen lehtësira nëse ka nevojë. <p>2. Njoftimi është i nevojshëm për kategoritë e mëposhtme të zyrtarëve:</p> <p>a) Grupi i parë përbëhet nga presidenti, kryeministri, zëvendëskryeministrat, kryetari i kuvendit dhe ministrat e punëve të brendshme, punëve të jashtme dhe të mbrojtjes. Për këtë kategori, njoftimi duhet të bëhet të paktën 72 orë përpara dhe çdo vërejtje duhet të ngrihet brenda 48 orëve të para.</p> <p>b) Grupi i dytë përbëhet nga të gjitha ministrat tjerë, nënkryetarët e kuvendit, drejtorët e zyrave qeveritare dhe agjencive të ndërlidhura me siguri, kryetarët e gjykatave kushtetuese dhe supreme, prokurori i shtetit si dhe të gjithë personat tjerë, të tillë si udhëheqësit fetarë që janë nën regjimin e mbrojtjes së afërt. Për këtë kategori njoftimi duhet të bëhet të paktën 48 orë përpara dhe çdo vërejtje duhet të ngrihet brenda 24 orëve të para.</p> <p>3. Afatet rrjedhin pavarësisht ditëve të punës dhe ditëve që nuk punohet, por njoftimet duhet të dërgohen gjatë orarit të punës (E hëne -E premtë deri në ora 5 pasdite).</p> <p>4. Në rast emergjence që kërkon udhëtim të menjëhershëm, të dy ZN-të mund të bien dakordohen në mënyrë ad-hoc</p> <p>5. Të gjitha ndryshimet e mundshme në programet e vizitave duhet të bëhen të paktën 24 orë para vizitës. Në rastin e vonesave të vogla gjatë vizitës, do të tregohet një fleksibilitet nga pala pritëse.</p> <p>6. Zbatimi i pikave të lartpërmendura do të vlerësohet dhe nëse është e nevojshme do të rishikohet pas 3 muajsh me kërkesën e njëjës apo dy palëve.</p> <p>Këto marrëveshje do të zbatohen që nga 1 dhjetor i vitit 2014.</p>	

ARANZHIMET LIDHUR ME TELEKOMUNIKACIONIN	8 shtator 2013
<p>1. Në kontekstin e dialogut të lehtësuar nga BE-ja, të dyja palët janë dakorduar që Kosovës do të i ndahet një kod telefonik 3-shifror nga ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve - UNT) në përputhje me standardet dhe parimet dhe afatet kohore të ITU-së, të dyja palët ranë dakord se një modalitet i pranuar reciprokisht do të duhet gjetur në lidhje me këtë proces brenda tre muajve, me lehtësimin e BE-së sipas nevojës.</p> <p>Qëllimi është që periudha e migrimit në lidhje me kodin telefonik duhet të përfundojë deri në Janar 2015. Pas kësaj date, ky kod telefonik nga ITU do të përdoret nga të gjithë operatorët në Kosovë. Operatorët e të dyja palëve do të reduktojnë kostot e thirrjeve lokale për qytetarët.</p> <p>2. Rregullatorët e të dyja palëve do të pajtohen për marrëveshje teknike për harmonizimin e përdorimit të spektrit për GSM, dhe sinjaleve televizive, duke përfshirë transmetimet digjitale tokësore, me qëllim për të siguruar ofrimin e shërbimeve të papenguara reciprokisht të bazuar në parimet e ITU-së dhe shmangien e interferencave të dëmshme ndërmjet shërbimeve. Secila Palë zotohet të mos mbulojë kufirin/kufirin administrativ të palës tjetër në mënyrë të qëllimshme.</p> <p>Rregullatorët gjithashtu do të inkurajojnë dhe të lehtësojnë procesin e interkoneksionit dhe marrëveshjes roming midis operatorëve mobil të të dyja palëve me synimin për të reduktuar kostot për qytetarët. Ata gjithashtu do të hyjnë në një proces të harmonizimit edhe për frekuencat digjitale.</p> <p>3. Në telefoninë fikse, një licencë e plotë për shërbime të telefonisë fikse do të lëshohet një Kompanie të Re, degë kjo e një kompanie serbe, e regjistruar në përputhje me kornizën rregullatore të Kosovës.</p> <p>4. Sa i përket telefonisë mobile, autoritetet e Kosovës do të lëshojnë një kompanie të re një autorizim të përkohshëm, sipas kornizës rregullatore të Kosovës, për operimet e tashme, të kufizuara në infrastrukturën aktuale në terren. Ky autorizim i përkohshëm nuk do të përfundojë para Janarit 2015.</p> <p>Autorizimi i përkohshëm do të skadojë sapo autoritetet e Kosovës të lëshojnë një licencë të re të plotë, të pakufizuar, të telefonisë mobile, si rezultat i një tenderi / ankandi. Tenderi do të organizohet në përputhje me standardet e BE-së.</p> <p>5. Megjithatë shërbimet postare nuk ishin pjesë e këtyre diskutimeve, të dyja palët bien dakord për të diskutuar ato në një fazë të mëvonshme.</p> <p>6. Një grup për implementim do të formohet, me lehtësimin e BE-së sipas nevojës, në mënyrë që të hartojë një plan të plotë të veprimit për zbatimin e Marrëveshjes. Pasi aranzhimet e mësipërme të ketë hyrë në fuqi, grupi për zbatim mund të diskutojë, me kërkesë të ndonjë palë, çfarëdo çështjesh tjera që mund ndërlihdet me këto aranzhime. Procesi i zbatimit të plotë do të fillojë pas pranimit me shkrim të Planit të Veprimit.</p> <p>Plani i Veprimit i Telekomunikacionit është i qasshëm këtu: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani_i_perbashket_i_veprimit_per_Telekomini_FINAL_-_25_Gusht_-_2015_-_perkthimi_zyrtar_Shqip.pdf</p>	

ARANZHIMET LIDHUR ME ENERGJINË

8 shtator 2013

1. Të dyja palët e konfirmojnë zotimin e tyre për të përbushur të gjitha detyrimet sipas Traktatit të Komunitetit për Energjinë dhe për zbatimin e acquis së BE-së për energjinë. Këto aranzhime janë në përputhje të plotë me të dyja.
2. KOSTT-i dhe EMS-i do të nënshkruajnë një marrëveshje bilaterale të operimit brenda tre muajve, duke vendosur dhe rregulluar marrëdhëniet e ndërsjella si dy Operatorë të Sistemit të Transmisionit. Si rrjedhojë, Marrëveshja e mëhershme e përkohshme mbi shkëmbimin e energjisë dhe Marrëveshja e përkohshme teknike do të shfuqizohen. KOSTT do të njihet si Operator i Sistemit të Transmisionit për territorin e Kosovës me qëllim të pjesëmarrjes në të gjitha mekanizmat relevantë (ITC, Menaxhimin e Kongjestionit, et). EMS do të mbështesë KOSTT-in që të bëhet anëtare e ENTSO-E-së.
3. Autoritetet rregullatore për energji të të dyja palëve do të hapin kanale të drejtpërdrejta të komunikimit për të diskutuar mbi çështjet me interes të ndërsjellë. Autoritetet rregullatore të të dyja palëve do të, në aplikim, pa vonesa, dhe në përputhje me ato që kërkohen nga korniza ekzistuese për licencim në juridiksionin e tyre, të lëshojnë licencë për mbulim tregtie (import, eksport, transit) dhe furnizim për KEK-un, KEDS-in dhe EPS-in, respektivisht.
4. Të dyja palët do të përshpejtojnë procesin e hapjes së tregut deri më 1 korrik 2014, sipas afateve të përcaktuara nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, duke lejuar themelimin e një kompanie të re që do të furnizojë konsumatorët. Të dyja palët po ashtu pajtohen që një kompani e tillë do të themelohet sipas kornizës ligjore dhe rregullatore të Kosovës.
5. Kjo kompani e re do të furnizojë me energji dhe mund të ofroj shërbime të distribuimit (siç janë faturimi, inkasimi, mirëmbajtja dhe lidhja fizike konsumatorët të rinj)për konsumatorët në katër komunat me shumicë serbe të pjesës veriore dhe mund ta ketë mundësinë që të blejë dhe shes energji në tregun e hapur. Kjo kompani e re, në mënyrë që të operojë sipas pikës 4 do të nënshkruajë marrëveshje me KOSTT-in në mënyrë që të merr pjesë në tregun e energjisë së Kosovës dhe për t'u bërë palë përgjegjëse për balancë. Menjëherë pasi të krijohet kjo kompani e re, ajo do të hyjë në bisedime me KEDS-in dhe KOSTT-in për të gjitha çështjet tjera me interes të ndërsjellë, duke përfshirë sigurimin e qasjes si palë e tretë. Punëtorët e JP Elektrokosmet do të inkuadrohen në këtë kompani të re ose do t'u ofrohet punësim në KEDS. KOSTT-i do të rilidh linjën 110 kv në Vallaq. Operatorët aktual në nënstacionin e Vallaqit do të respektojnë urdhrat e qendrës dispeçere të Kosovës.
6. Të dyja palët pajtohen që të provojnë të gjejnë zgjidhje të përbashkët në lidhje me kërkesat e KOSTT-it dhe të EMS-it. KOSTT-i konsideron se këto kërkesa janë për tranzitin e papaguar dhe alokimet e të hyrave të interkoneksionit dhe kërkesat e EMS-it për rregullim sekondar. EMS konsideron se këto kërkesa janë për shërbimet për rregullime sekondare dhe terciare. Nëse do të jetë e pamundur që të arrihet një marrëveshje e përbashkët brenda 6 muajve, të dyja palët do të pajtohen që kërkesat e tyre ti nënshtrohen një arbitrazhi ndërkombëtarë.
7. Do të formohet një grup implementues në mënyrë që të hartohet një Plan të plotë Veprimi për zbatimin e marrëveshjes së ardhshme. Procesi i plotë i implementimit do të fillojë pas pranimit me shkrim të planit të veprimit.

KONKLUZIONET E LEHTËSUESIT TË BE MBI IMPLEMENTIMIN E MARRËVESHJES PËR ENERGIJË TË VITIT 2013

25 gusht 2015

Në mënyrë që të implementohen obligimet nën 'Aranzhimet për energji' të nënshkruar nga dy Kryeministrat në shtator 2013, të dy palët pajtohen për si vijon:

Themelimi i kompanisë së re tregtare

1. Kosova do të lejoj EPS që të themeloj një kompani tregtare për energji në Kosovë, në pajtim me obligimet e mos diskriminimit nën Komunitetin e Energjisë dhe në pajtim me kornizën ligjore dhe rregullatore të Kosovës.
2. EPS do të dorëzoj dokumentet në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për të aplikuar për çertifikatën e regjistrimit para fundit të Gushtit 2015.
3. Në pajtim me rregullat dhe afatet e vetë Kosovës, kjo çertifikatë e regjistrimit do të lëshohet brenda 7 ditëve.
4. Kjo kompani do të aplikoj për, dhe do t'i jepet një licencë e cila mbulon importin, eksportin dhe transitin.

Themelimi i kompanisë së re për furnizim dhe shërbimet shpërndarjes

5. Kosova do të lejoj EPS që të themeloj një kompani furnizimi në Kosovë, në pajtim me obligimet e veta për mos diskriminim nën Komunitetin e Energjisë dhe në pajtim me kornizën ligjore dhe rregullatore të Kosovës.
6. EPS do të dorëzoj dokumentet në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për të aplikuar për çertifikatën e regjistrimit para fundit të Gushtit 2015.
7. Në pajtim me rregullat dhe afatet e vetë Kosovës, kjo çertifikatë e regjistrimit do të lëshohet brenda 7 ditëve.
8. Emri i kësaj kompanie do të jetë 'ElektroSever'.

Licenca e furnizimit

9. Kjo kompani do të aplikoj në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) për licencat e nevojshme për të furnizuar konsumatorët, për të blerë dhe shitur energji në tregun e hapur dhe të importoj dhe eksportoj energji. Kjo licencë do të jepet në pajtim me kornizën ligjore dhe rregullatore të vetë Kosovës.
10. Licenca e furnizimit do të jetë operative kur KOSTT të bëhet anëtarë i ENTSO-E.
11. ElektroSever do të nënshkruaj marrëveshje me KOSTT në mënyrë që të merr pjesë në tregun e energjisë elektrike në Kosovë dhe të bëhet palë përgjegjëse për balancim.
12. ElektroSever do të ketë të drejtë që të bëjë faturimin dhe arkëtimin, pasi që këto janë aktivitete normale për një kompani të furnizimit.
13. Do të sigurohet qasja në infrastrukturën e transmisionit dhe distribucionit për KOSTT, KEDS dhe ZRRrE si dhe të dhënat e konsumatorëve. Këto të dhëna do të ofrohen nëpërmjet BE.
14. ElektroSever do të hyjë në diskutime me KEDS dhe KOSTT, për të siguruar qasjen e palës së tretë.

Shërbimet e distribucionit

15. Të dy palët do të vazhdojnë të punojnë, me lehtësimin e BE, me qëllim që të lejojnë ElektroSever që të ofroj shërbimet e distribucionit të bazuara në parimet e 'Aranzhimeve për Energji'.

Çështjet tjera

16. Serbia, dhe EMS do të mbështesin aplikacionin e KOSTT për të nënshkruar një marrëveshje interkonjeksioni me ENTSO-E, përfshirë edhe procesin e apelit.
17. Të dy palët pajtohen se të gjitha pikat e këtyre konkluzioneve do të implementohen pavarësisht nga progresi në pikën 15.

Mohimi: Kosova konsideron se, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjet e Kosovës, dhe ligjin ndërkombëtar, përkatësisht UNSCR 1244 dhe Rregulloret përkatëse të UNMIK, prona brenda territorit të Kosovës është në pronësi të Republikës së Kosovës. Serbia konsideron se, në pajtim me ligjin vendor dhe ndërkombëtar, përkatësisht UNSCR 1244, prona brenda territorit të Kosovës është në pronësi të Serbisë, sipas rregullimit specifik provincial dhe në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Serbisë.

MARRËVESHJA PËR DREJTËSI

9 shkurt 2015

9. Ligjet e Kosovës do të aplikohen nga institucionet gjyqësore në përputhje me Marrëveshjen e Parë
10. Do të ketë një Gjykatë Themelore dhe një Zyrë të Prokurorisë Themelore për rajonin e Mitrovicës
11. Për Gjykatën Themelore të Mitrovicës do të jenë në shfrytëzim disa godina
12. Janë katër degë ekzistuese për Gjykatën Themelore të Mitrovicës në rajonin e Mitrovicës (Zubin Potok, Leposaviq, Skënderaj, Vushtrri)
13. Shumica e rasteve që vijnë nga komunitat ku ndodhen degët do të gjykohen në ato degë, në përputhje me ligjin
14. Në Kosovë, Kryetari i Gjykatës Themelore është ai që cakton vend-gjykimet
15. Caktimi i rasteve për në prokurori bazohet në ekspertizë, specializim, në formimin personal dhe njohjen e zonës lokale, në përputhje me ligjet në Kosovë
16. Për shumicën e rasteve në Gjykatën Themelore, vendimi merret nga një gjyqtar i vetëm, në përputhje me ligjin
17. Të dyja palët do të përfaqësohen në të gjitha objektet e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, Zyrës së Prokurorisë Themelore dhe njësisë së Gjykatës së Apelit në Mitrovicë
18. Shumica e punëtorëve në objektin e Gjykatës Themelore në Mitrovicën e veriut do të jenë serbë të Kosovës
19. Objekti i Gjykatës Themelore në Mitrovicën e veriut do të përbëhet nga:
 - Njësi i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë, i cili do të përbëhet nga 5 gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 2 gjyqtarë shqiptarë
 - Departamenti për krime serioze për tërë rajonin e Mitrovicës, i cili do të përbëhet nga 4 gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 4 gjyqtarë shqiptarë
 - Pjesa e departamentit të përgjithshëm që gjykon/trajton të gjitha veprat penale për Mitrovicën e veriut, Mitrovicën e jugut dhe Zveçanin
20. Objekti i dytë i Gjykatës Themelore të Mitrovicës do të përbëhet nga:
 - Departamenti për të mitur për të gjithë rajonin e Mitrovicës
 - Pjesa e departamentit të përgjithshëm që gjykon/trajton të gjitha çështje civile, deklaratimet e pakontestuar, veprat penale të të miturve për Mitrovicën e veriut, Mitrovicën e jugut dhe Zveçanin.

Objekti i dytë do të jetë në Mitrovicën e jugut, në të ashtuquajturën ndërtesa e 'Jugobankës' ose në një objekt tjetër, për të cilin do të pajtohen të dyja palët.
21. Kryetar i Gjykatës Themelore do të jetë një serb i Kosovës nga Mitrovica
22. Kryeprokurori i Zyrës së Prokurorisë Themelore do të jetë shqiptar i Kosovës. Objekti ndodhet në Zyrën Administrative për Mitrovicën e veriut (MNAO), e cila ndodhet në Mahallën e Boshnjakëve ose në ndonjë objekt tjetër, për të cilin do të pajtohen të dyja palët.

PROCESI I INTEGRIMIT/ MARRËVESHJA PËR SHPËRBËRJEN E TË ASHTUQUAJTURËS 'MBROJTJA CIVILE'

26 mars 2015

I. Integrimi i stafit të Mbrojtjes Civile (MC)

Procesi i integrimit të individëve do të jetë në përputhshmëri me marrëveshjen e Brukselit dhe ligjeve të Kosovës për shërbyesit civil

1. Pala e Beogradit ka dorëzuar një listë prej 751 anëtarëve të MC-së për tu integruar në institucionet e Kosovës.
2. Pala e Prishtinës në total ka ofruar 483 pozita për pjesën veriore, nga të cilat 80 në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave dhe 25 në Shërbimin Korrektues të Kosovës; 50 pozita në fondet kontigjente, ku ata do të marrin paga por vendet e punës do të përcaktohet në sektorin publik brenda 3 viteve.
3. Pranueshmëria: Nga gjithsej 751 persona, vetëm ata që posedojnë dokument identifikimi valid të Kosovës ose vërtetim të aplikim për dokumentin e identifikimi nga Kosova, të cilët nuk janë ende në listën e pagave të ndonjërit nga institucionet e Kosovës dhe ata të cilët do ta kalojnë verifikimin e sigurisë do të jenë të pranueshëm për integrim.
4. Pas vlerësimit të përshtatshmërisë paneli do të bëjë përzgjedhjen e individëve për pozitat specifike duke u bazuar në interesimin e shprehur (më shumë se një opsion), edukimin e tyre dhe përvojës profesionale.
5. Në përgjithësi, paneli do të përbëhet nga 4 anëtarë. Dy anëtar nga institucionet e Kosovës, një përfaqësues nga ish-MC-ja; dhe një përfaqësues i BE-së. Ndërsa për pozitat që kanë të bëjnë me çështjet e trashëgimisë kulturore dhe fetare (20 në total) Kisha Ortodokse Serbe nga Kosova dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës do të konsultohen para përzgjedhjes përfundimtare. Më 8 prill 2015 emrat e anëtarëve të panelit do të përcjellën tek lehtësuesit e BE-së.
6. Paneli i lartpërmendur do të themelohet më 27 prill 2015, kur do të zhvillohet takimi i parë. Takimi i panelit do të mbahet në Prishtinë në lokalet që do të vendos pala e Prishtinës.
7. Paneli duhet ta përmbyll punën e tij jo më vonë se më 14 gusht 2015, dhe të gjitha kontratat e punës duhet të nënshkruhen deri më 15 shtator 2015, kur i gjithë procesi i integrimit duhet të kryhet.
8. Paneli do të vendos për metodën e përzgjedhjes, duke përfshirë intervistat e mundshme me kandidatët e caktuar, nëse dhe kur është e nevojshme. Është obligim i kandidatëve dhe punëdhënësit të tyre aktual që të sigurojnë të gjitha informatat shtesë siç kërkohet nga paneli.
9. Paneli fillimisht do të vendosë në përzgjedhjen e kandidatëve në fushën e menaxhimit të emergjencave (80 pozita) dhe si punonjës të shërbimit korrektues (25 pozita). Përzgjedhja për këtyre pozitave duhet të kryhet më 15 qershor 2015 dhe nënshkrimi i kontratave më 1 korrik 2015.
10. Pas përzgjedhjes së kandidatëve dhe njoftimit me shkrim nga paneli, kandidatët do të kenë afat prej 15 ditëve që të nënshkruajnë kontratën e punës dhe deklaratën (drafti në aneks). Pala e Prishtinës do të bëjë çdo gjë që është e nevojshme për të përshpejtuar pajisjen me dokumente. Në rast se kandidati i përzgjedhur nuk e nënshkruan kontratën e punës dhe deklaratën 15 ditë pas marrjes së njoftimit nga paneli, ajo pozitë do t'i ofrohet personit tjetër dhe ky person do të largohet nga lista e të përgjegjshmëve për integrim. Në rastet kur kandidatët e përzgjedhur në periudhën mes 15 korrikut dhe 14 gushtit 2015 dështojnë në nënshkrimin e kontratës së punës dhe deklaratës, 30 ditë shtesë (deri më 15 shtator 2015) do t'i jepen panelit për përzgjedhjen e re dhe ofrimin të pozitave të paplotësuara tek kandidatët tjerë të pranueshëm.
11. **Të gjitha pozitat e ofruara**, do të përmbushen nga kandidatët e pranueshëm me ish-anëtarë të MC-së.

II. Trajtimi i lokacioneve dhe pajisjeve të MC

12. Pala e Beogradit ka dorëzuar tek ndërmjetësit e BE-së një listë të vendndodhjes së lokacioneve dhe <<pikave të vëzhgimit>> aktualisht nën udhëheqjen e anëtarëve të MC-së.
13. Tri pikat e vëzhgimit në mes rrugës Mitrovicë - Jarinjë do të largohen nga rruga më 20 prill 2015, dhe pika vëzhguese e vendosur në pjesën veriore në Urën kryesore në Mitrovicë do t'i dorëzohet PK-së poashtu më 20 prill 2015. Procesi do të monitorohet dhe verifikohet nga PK-ja dhe EULEX.
14. Bazuar në listën e dorëzuar të lokacioneve, pala e Prishtinës do të bëjë vlerësimin se cila nga lokacionet mund të vazhdojnë të përdoren me qëllim të hapjes së institucioneve relevante të Kosovës, ku do të punojnë stafi i integruar. Është në përgjegjësinë e palës së Prishtinës që të ofrojnë, pajisin, dhe rinovojnë këto lokacione dhe të tjera të nevojshme më së voni deri më 1 Shtator 2015. Dorëzimi i këtyre lokacioneve do të fillojë kur paneli do të verifikojë tek ndërmjetësit e BE-së integrimin e plotë të 105 anëtarëve të MC-së. Procesi do të jetë gradual, do të përmbillet jo më vonë se më 20 korrik 2015.
15. Secila pikë vëzhgimi, duke përfshirë pajisjet teknike dhe qendrën e situatave, do të largohen apo dorëzohen tek PK-ja më 20 prill 2015.

16. Pala e Beogradit ka njoftuar se MC-ja i posedon rreth 500 xhaketa zyrtare. Pala e Beogradit në formë të shkruar do të informoje ndërmjetësit e BE-së për ndërprerjen e përdorimit të këtyre xhaketave zyrtare në ditën e integritit të 105 kandidatëve të përzgjedhur. Gjatë dhe pas integritit ish anëtarëve të MC-së nuk do të lejohen të mbahen të veshura me asnjë lloj uniformash apo veshje civile të ngjashme me simbolet e MC-së. Pas integritit, punëdhënësi do të vendos për kodin e veshjes, duke përfshirë edhe uniformat nëse dhe kur janë të përdorshme, varësisht nga institucioni ku individit do të integrohet.
17. Pala e Beogradit do të ofrojë një inventar të të gjitha pajisjeve që aktualisht janë në përdorim dhe zotim të MC-së tek ndërmjetësit e BE-së më 24 prill 2015. Pala e Prishtinës do të vendos nëse këto pajisje do të vazhdojnë të përdoren nga institucionet e Kosovës në komunat veriore, pajisjet e mbetura do të transferohen tek pala e Beogradit, të cilat do të verifikohen nga PK dhe EULEX.
18. Pala e Beogradit ka ofruar konfirmim me shkrim se MC-ja dhe anëtarët e saj nuk posedojnë asnjë armë zyrtare. Në rast se pala e Prishtinës do të ofrojë prova të besueshme se MC-ja posedon armë zyrtare do të njoftojë ndërmjetësit e BE-së, dhe EULEX-i dhe PK-ja së bashku do të fillojnë operacionet e kërkimit pa paralajmërim.

III. Notifikimet:

19. Pala e Beogradit në formë të shkruar do të njoftojë ndërmjetësit e BE-së për ndërprerjen e pagave dhe ofrimit të ndonjë ndihme financiare për MC-në në Kosovë më 1 shtator 2015, përveç personave që përfshihen në pikën 10 deri më 15 shtator 2015, dhe do të miratoj rregulloret e brendshme të nevojshme për ta zbatuar këtë vendim. Një kopje e kësaj rregulloreje do të dorëzohet tek ndërmjetësit e BE-së më 1 shtator 2015.
20. Pala e Beogradit më 24 prill 2015 në formë të shkruar do të njoftojë ndërmjetësit e BE-së se MCja në Kosovë më nuk do të ekzistoj përbrenda sistemit të Serbisë nga 1 shtatori 2015.

MEMORANDUM I MIRËKËPTIMIT/ Marrëveshja për njohjen reciproke të policave (sigurimeve) të automjeteve

23 qershor 2015

Në frymën e marrëveshjes së Brukselit nga data **19 prill 2013**

Ndërmjet Shoqatës së Siguruesve Serbë (SHSS) dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), si entitete të autorizuara përgjegjëse për çështjet e sigurimit të automjeteve në juridiksionin e secilës palë, me facilitimin e Këshillit të Byrosë (KB)

Për Njohjen Reciproke të Sigurimit nga Autopërgjegjësia për Palët e Treta (TPL)

marrëveshje për procesimin dhe pagesën e kërkesave.

DUKE PASUR PARASYSH QË:

SHSS dhe BKS dëshirojnë të ofrojnë marrëveshje për:

- njohjen reciproke dhe pranimin e TPL valide, dhe
- procesimin dhe pagesën e dëmeve si pasojë e aksidenteve të shkaktuara nga automjetet me mbulim të vlefshëm sigurues në juridiksionin e secilës palë.
- zbatimin i këtij MM nën juridiksionin e secilës palë;

SHSS dhe BKS janë pajtuar si në vijim:

I. Definicionet

II. Mbulimi Reciprok – TPL

III. Trajtimi dhe kompenzimi i kërkesave

IV. Trajtimi i kërkesave

V. Korrespondenti

VI. Këshilli i byrosë – KIB

VII. Garancia

VIII. Komiteti për zbatim

IX. Hyrja në fuqi dhe shkëputja e MM-së

X. Monitorimi dhe Mbikëqyrja

XI. Gjuha

E nënshkruar në Bruksel më 23 qershor 2013, me tri (3) kopje origjinale në gjuhën Angleze.

Në emër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS)

Z. Faton Abazi

Drejtor [nënshkruar] [vulosur]

Si dëshmitarë:

[nënshkruar]

Znj. Greet Floré
Sekretare e Përgjithshme
e Këshillit të Byrove

[nënshkruar]

Znj. Edita Tahiri
Ministrja për Dialog,
Kosovë

[nënshkruar]

Z. Rrahim Pacolli
Shef i Kuvendit të
Siguruesve të Kosovës

Shtojcat:

I. TPL+ dhe TPL

II. Limitet e kompenzimit të sigurimit

III. Lista e emrave dhe adresave të kompanive të sigurimit që janë anëtare të BKS dhe SHSS.

Dokumenti i plotë është i qasshëm këtu: <https://www.bks-ks.org/static/uploads/documents/MOU/MoU%20Serbia%20Shq.pdf>

**ASOCIACIONI/BASHKËSIA I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË KOSOVË -
PARIMET E PËRGJITHSHME/ELEMENTET KRYESORE**

25 gusht 2015

Korniza ligjore

- 1) Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë themelohet si një Asociacion/Bashkësi i komunave siç parashihet me Marrëveshjen e Parë, Ligjin mbi Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë dhe ligjet e Kosovës.
- 2) Në bazë të Marrëveshjes së Parë, e cila njih karakterin e tij të veçantë, Qeveria e Kosovës do të miratojë një dekret të aplikueshëm drejtpërdrejtë, i cili do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese. Bashkësia/Asociacioni do të jetë entitet juridik, i definuar me Statutin e tij, që do të përmbajë së paku elementet e mëposhtme:
- 3) Statuti do të aprovohet nga kuvendi themelues të cilin e përbëjnë anëtarët e zgjedhur me vota nga radhët e kuvendeve të komunave pjesëmarrëse.

Objektivat

- 4) Në përputhje me Marrëveshjen e Parë, objektivat kryesore të Asociacionit/Bashkësisë do të jenë ofrimi i funksioneve dhe shërbimeve publike për:
 - a) fuqizimin e demokracisë lokale;
 - b) ushtrimin e vështrimit të plotë për zhvillimin e ekonomisë lokale;
 - c) ushtrimin e vështrimit të plotë në fushën e arsimit;
 - d) ushtrimin e vështrimit të plotë për përmirësimin e shëndetësisë lokale primare e sekondare dhe përkujdesjes sociale;
 - e) ushtrimin e vështrimit të plotë për koordinimin e planifikimit urban dhe rural;
 - g) aprovimin e masave për përmirësimin e kushteve lokale të jetesës për të kthyerit në Kosovë;
 - h) zhvillimin, koordinimin, dhe lehtësimin e veprimtarive kërkimore dhe zhvillimore;
 - i) promovimin, afirmimin, dhe avokimin e çështjeve me interes të përbashkët për anëtarët e tij dhe përfaqësimin e tyre, përfshirë tek autoritetet qendrore;
 - j) ofrimin e shërbimeve për anëtarët e tij në përputhje me ligjet e Kosovës;
 - k) vlerësimin e ofrimit të shërbimeve publike për anëtarët e tij dhe për banorët e tyre me qëllim të përkrahjes së Bashkësisë/Asociacionit për formësimin e qëndrimeve me interes të përbashkët lidhur me pjesëmarrjen në punën e autoriteteve qendrore;
 - l) monitorimin sipas nevojës të zbatimit të objektivave të tij;
 - m) vendosjen marrëdhënies dhe hyrjen në aranzhime bashkëpunimi me asociacionet tjera të komunave, vendore dhe ndërkombëtare.
- 5) Bashkësia/Asociacioni do të ushtrojë edhe kompetenca tjera shtesë, të cilat mund t'i delegohen nga autoritetet qendrore.

Struktura organizative

- 6) Asociacioni/Bashkësia do t'i ketë këto organe:
 - a) Kuvendin, si trup më të lartë, të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e emëruar nga kuvendet e komunave pjesëmarrëse, nga anëtarët e tyre të zgjedhur. Kuvendi do të ketë të drejtë të miratojë amendamentet e Statutit, rregulloren e punës dhe të gjitha rregulloret dhe udhëzimet tjera administrative në pajtim me Statutin dhe ndërlidhur me objektivat e tij.
Të gjitha amendamentet e Statutit, rregullorja e punës dhe të gjitha rregulloret e nevojshme si edhe vendimet të cilat i miraton Kuvendi do të jenë të zbatueshme për anëtarët e tij, përveç në rast se ndonjëri nga anëtarët paraqet formalisht vendim tjetër.
 - b) Kryetari, i cili do ta përfaqësojë Bashkësinë/Asociacionin, përfshirë tek autoritetet qendrore dhe jashtë Kosovës. Kryetarin do ta ndihmojë nën-kryetari. Kryetarin dhe nën-kryetarin do t'i zgjedhë Kuvendi, nga radhët e anëtarëve të Kuvendeve Komunale pjesëmarrëse, dhe të kryetarëve të komunave.
 - c) Këshilli i përbërë nga më së shumti 30 anëtarë, banorë të komunave pjesëmarrëse, përfshirë të gjithë kryetarët e këtyre komunave; Këshilli është trup këshillëdhënës, i cili jep udhëzime për punën e Asociacionit/Bashkësisë.
 - d) Bordi, i përbërë nga 7 anëtarë, të zgjedhur me votë nga Kuvendi, nga radhët e kryetarëve dhe banorëve të komunave pjesëmarrëse, përbërja e saktë e të cilit do të definohet në Statut, do të ketë të drejtë të marrë vendime të nevojshme për menaxhimin ditor të Bashkësisë/Asociacionit. Anëtarët e Bordit, gjatë punës së tyre, do të përkrahen nga kolegji i profesionalëve të përbërë nga ekspertë të fushave përkatëse që përkojnë me objektivat dhe detyrat e Asociacionit/Bashkësisë. Statuti do të definojë numrin e kolegji i profesionalëve dhe përgjegjësitë e tyre ndaj anëtarëve të Bordit.
 - e) Administrata, e udhëhequr nga Shefi i Administratës, i cili emërohet nga Bordi dhe i raporton Bordit, për të ndihmuar punën e Bashkësisë/Asociacionit, në veçanti Bordit dhe Kryetarit. Staf i administratës do të përfitojë nga statusi i të punësuarve, në përputhje me ligjet e Kosovës, duke përfshirë Ligjin e Punës dhe Ligjin mbi Shërbimin Civil, të cilat ua mundësojnë të ushtrojnë detyrat e tyre administrative. Anëtarët e Asociacionit/Bashkësisë mund të vendosin të përdorin një numër të të punësuarve për të përkrahur Bashkësinë/Asociacionin në përmbushjen e objektivave të tij.
 - f) Zyra e ankesave, me mandat që të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me objektivat e tij.

7) Selia e Bashkësisë/Asociacionit do të përcaktohet me Statut.

Marrëdhëniet me autoritetet qendrore

8) Asociacioni/Bashkësia do të punojë me autoritetet qendrore sipas parimit të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe shkëmbimit të informatave.

9) Asociacioni/Bashkësia do të promovojë interesat e komunitetit serb të Kosovës në raport me autoritetet qendrore.

10) Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë të propozojë, në përputhje me ligjet e Kosovës, amendamentet e legjislacionit dhe rregulloreve tjera relevante për përmbushjen e objektivave të tij.

11) Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë të iniciojë apo të marrë pjesë në procedurat gjyqësore në gjykatat kompetente, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, kundër çfarëdo akti apo vendimi të cilitdo institucion që ndikon në ushtrimin e kompetencave të Asociacionit/Bashkësisë, në përputhje me Statutin e tij.

12) Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë të nominojë përfaqësues në organet/trupat kompetente të qeverisë qendrore, përfshirë Këshillin Konsultativ për Komunitete. Me qëllim të përmbushjes së funksionit monitorues, të paraparë me Marrëveshjen e Parë, përfaqësuesi i Asociacionit/Bashkësisë do të ketë të drejtë të ketë qasje në informatat e autoritetet qendrore, në përputhje me ligjet e Kosovës.

13) Në emër të Asociacionit/Bashkësisë, katër kryetarët e komunave veriore do t'i ofrojnë Ministrisë së Brendshme një listë të kandidatëve për emërim si komandant I policisë rajonale, siç përcaktohet në Nenin 9 të Marrëveshjes së Parë.

Kapaciteti ligjorë

14) Asociacionit/Bashkësisë do ti ofrohet hapësira e nevojshme ligjore, sipas ligjeve të Kosovës, në mënyrë që të përmbushë objektivat e tij, përfshirë të drejtën e posedimit të pronës së luajtshme dhe të paluajtshme, të bashkëpronësisë së kompanive që ofrojnë shërbime lokale në kuadër të fushëveprimit të Asociacionit/Bashkësisë dhe të lidhë kontrata, përfshirë kontrata pune.

15) Në bazë të Marrëveshjes së Parë, Asociacioni/Bashkësia konsiderohet i themeluar, pas miratimit të dekretit, për përmbushjen e objektivave të tij.

Buxheti dhe përkrahja

16) Asociacioni/Bashkësia do ta ketë buxhetin e tij, i cili do të administrohet në përputhje me parimet e transparencës dhe llogaridhënies si dhe me dispozitat e Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Këto parime posaçërisht do të vlejnjë për dedikimin e fondeve, përfshirë ato të përshkuara në pikën 17d.

Do të ketë auditim të shpenzimeve nga autoritetet kompetente, përfshirë Auditorin e Përgjithshëm.

17) Asociacioni/Bashkësia do të financohet nga:

a) kontributet e anëtarëve të tij;

b) të hyrat dhe të ardhurat nga shërbimet që i ofron Asociacioni/Bashkësia, kompanitë e tij, apo që do të burojnë nga asetet e tij të luajtshme dhe të paluajtshme;

c) transferet nga autoritetet qendrore;

d) kontributet, grantet, donacionet si dhe përkrahja financiare e asociacioneve dhe organizatave tjera, vendore dhe ndërkombëtare, si edhe nga Republika e Serbisë;

Bashkësia/Asociacioni do të lirohet nga detyrimet dhe taksat për përmbushjen e objektivave të tij, sipas të njëjtit model me komunat pjesëmarrëse.

Dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare

18) Asociacioni/Bashkësia do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër, me kusht që të pajtohen anëtarët e tij.

19) Asociacioni/Bashkësia mund të shpërbëhet vetëm me vendim të Kuvendit të tij, të miratuar me shumicë prej 2/3 e anëtarëve të tij.

20) Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë t'i ketë simbolet zyrtare të tij (stemën dhe flamurin), në përputhje me ligjet e Kosovës.

21) Statuti i Asociacionit/Bashkësisë do të hartohet nga Ekipi Menaxhues dhe do të prezantohet në Dialogun e Nivelit të Lartë, brenda 4 muajve nga data e arritjes së marrëveshjes për këto parime/elemente, sipas nevojës, me lehtësimin e Ministrisë së Qeverisjes Lokale. Statuti do të konfirmohet me dekret, pas marrëveshjes në Dialog.

Secili amendament do të prezantohet nga Asociacioni/Bashkësia, do të konfirmohet me dekret dhe do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

22) Brenda një viti nga aprovimi i Statutit të Asociacionit/Bashkësisë do të bëhet shqyrtimi i implementimit të tij, përfshirë çështjet që burojnë nga Neni 5 I Marrëveshjes së Parë.

GRUPI PUNUES, LIRIA E LËVIZJES, <i>Konkluzionet për Urën</i>	25 gusht 2015
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të dyja palët kanë kërkuar nga BE që të revitalizohet ura e Mitrovicës dhe hapësira rreth sajë, sipas rekomandimeve të vlerësimit teknik dhe bazuar në dizajnin arkitekturor të 29 Qershor 2015 të dakorduar mes palëve. 2. Me 15 tetor 2015 kontraktuesi do të mbyll të dyja anët e urës me pengesa të palëvizshme dhe rrethojë të punimeve. Punimet në urë do të bëhen duke ju qasur vend punimit nga ana jugore e rrugës. Ura do të hapet për qarkullim të përgjithshëm në verë / jo më vonë se fundi i Qershorit 2016. 3. Në përputhje këto afate kohore, komuna do të revitalizoj rrugën e saj kryesore (rruga Mbreti Peter) në zonë për këmbësorë. Rruga do të hapet për këmbësorë në verë / jo më vonë se fundi i Qershorit 2016. 4. GP do të mbikëqyr dhe rishikoj rregullisht së bashku me të dy kryetarët e komunave kushtet mbizotëruese politike dhe të sigurisë në komuna gjatë procesit të revitalizimit. 5. Me 10 tetor 2015 hartat e linjave administrative të zonave kadastrale në Suhodoll/Suvi Do dhe Kroi i Vitakut/Brdjani do të zgjidhen përmes Memorandumit të Mirëkuptimit për Planet Zhvillimore Komunale, Hartës së Zonimit Komunal dhe Planit Rregullues të Detajuar nga ministritë relevante dhe dy komunat. 	

PLANI VIZUEL PËR REVITALIZIMIN E URËS NË MITROVICË	25 gusht 2015
	

PLANI I BE-SË PËR IMPLEMENTIMIN E MARRËVESHJES PËR URËN NË MITROVICË

5 gusht 2016

Bruksel, 05/08/2016

Pas diskutimeve të gjata të zhvilluara më 2 gusht, Ministria për Dialog Edita Tahiri dhe Kryenegociatori Marko Gjuriq u pajtuan sot për detajet e fundit të mbetura lidhur me implementimin e marrëveshjes së 25 gushtit 2015 për Urën në Mitrovicë të arritur në Dialogun Beograd - Prishtinë. BE-ja e ka lehtësuar atë.

Tani që implementimi i plotë është në horizont, Ura e Mitrovicës do të bëhet simbol i normalizimit të marrëdhënieve mes serbëve, shqiptarëve dhe komuniteteve tjera të Kosovës. Revitalizimi i urës, si dhe i Rrugës Mbreti Petar, do të kontribuojnë në masë të madhe në lehtësimin e kontakteve në mes të gjithë qytetarëve të Mitrovicës së Veriut dhe Jugut dhe në këtë mënyrë do të kontribuojnë në shkëmbime dhe mirëkuptim.

U dakordua që leja e rëndësishme e ndërtimit të lëshohet dhe revitalizimi i Urës së Mitrovicës dhe hapësirës përreth të fillojë më 14 gusht 2016. Ura e Mitrovicës do të hapet për këmbësorë dhe automjete në të dy drejtimet në përputhje me rekomandimet e vlerësimit teknik dhe dizajnit

arkitektonik për të cilat të dy palët u pajtuan në qershor të vitit 2015.

Punimet në urë do të kryhen duke iu qasur vendpunimit nga rruga në anën jugore. Ura do të jetë e hapur për qarkullim të plotë më 20 janar 2017.

Në përputhje me të njëjtin afat kohor, komuna e Mitrovicës së Veriut do ta revitalizojë rrugën e saj kryesore – Rruga Mbreti Petar – në zonë për këmbësorë. Rruga do të jetë e hapur për këmbësorë më 20 janar 2017. Punimet do të fillojnë dhe do të përfundojnë në të njëjtën ditë si me ato në urë dhe përreth saj.

Një grup punues së bashku me dy kryetarët e komunave do të monitorojë dhe shqyrtojë rregullisht kushtet politike dhe të sigurisë në të dy komunat gjatë dhe pas procesit të revitalizimit. Takimi i parë i këtij grupi do të mbahet më 9 shtator 2016. Policia e Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i do të sigurojnë një mjedis të sigurt në përputhje me mandatet e tyre përkatëse. Ata do të konsultohen për masat e duhura të sigurisë, duke përfshirë edhe konsultat me dy kryetarët e komunave.

Në lidhje me çështjen e implementimit të nenit 5 të marrëveshjes mbi Urën e Mitrovicës, ministrinë përkatëse dhe dy komunat do të gjejnë një zgjidhje deri më 14 tetor 2016.

BE-ja mirëpret rezultatin e diskutimeve të sotme dhe nxit të dyja palët që të vazhdojnë të arrijnë progres në të gjitha çështjet tjera të hapura që presin të implementohen, në veçanti në Telekom, Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë dhe Energji.

MARRËVESHJA E BRUKSELIT PËR NJOHJEN RECIPROKE TË CERTIFIKATAVE ADR/
Konkluzionet e kryesuesit të BE të datës 19 prill 2016

19 prill 2016

1. Palët zotohen për lëvizjen e lirë të mallrave, duke përfshirë mallrat e rrezikshme, pa pengesa dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare / Evropiane.
2. Palët pajtohen që reciprokisht ti pranojnë të gjitha standardet ndërkombëtare / Evropiane për transportin / bartjen e mallrave të rrezikshme, përfshirë të gjithë dokumentacionin në përputhje me konventën e ADR-së (çertifikatat e shoferëve dhe automjeteve).
3. Me këtë marrëveshje nuk preken detyrimet ndërkombëtare të secilës palë.
4. Kjo marrëveshje hynë në fuqi më 25 prill 2016.
5. Një grup për zbatim do të formohet nga BE që të monitorojë implementimin.

Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është një organizatë pavarur rajonale, me qendër në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza dhe rekomandime të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlydhura me shtet-ndërtim; konsolidim institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integrimin Evropian dhe reformave politike. Ne kemi përvojë në hartimin, raportimin dhe zhvillimin e politikave, qasje strategjike dhe avokim me qeverinë, institucione ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportet tona rigoroze, të detajuar dhe të paanshme, të bazuara gjithmonë në hulumtimet në terren. Ne shkojmë përtej qëndrimeve kryesore dhe kërkojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika të cilat janë krijuese, të realizueshme dhe të matshme, për të ndihmuar në zhvillimin e demokracive të forta dhe shoqërive të bazuara në sundimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor.

Ne angazhohemi në avokim të nivelit të lartë, si në rajon ashtu edhe ndërkombëtarisht, duke ndikuar njëkohësisht në diskutime mbi politikat, punët e brendshme dhe politika evropiane për Ballkanin Perëndimor.

Për të arritur këtë, Grupi për Ballkan ka dizajnuar instrumente dhe platforma të reja:

Dialogu Politik promovon dialogun e brendshëm të Kosovës, dhe agjendën e krijimit të reformave.

Forumi i Politikave (një Forum i Avokimit të Nivelit të Lartë-Mendimtar) u angazhua për të përmirësuar dialogun midis shoqërisë civile dhe institucioneve.

Grupi për Avokim dhe Politika Kosovë-Serbi (një forum për bashkëpunimin ndërkufitar të shoqërisë civile) synon të komunikojë, promovojë dhe forcojë dialogun drejt normalizimit të plotë midis Kosovës dhe Serbisë, dhe shoqërive të tyre.

Gratë në politikë promovon fuqizimin e grave dhe vajzave; sigurinë dhe gjithë-përfshirjen e tyre; dhe angazhohet të forcoj ndikimin e Grupit të Grave në tërë Kosovën.

Platforma për Dialogun promovon procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke informuar publikun më të gjerë dhe duke nxitur debat për marrëveshjet, përfitimet dhe sfidat e Dialogut.



Norwegian Embassy